



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

- 1.Shqyrtimi i projektligjit “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.
- 2.Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Elona Hoxha, Paulin Sterkaj, Xhemal Qefalia, Vullnet Sinaj, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Aqif Rakipi, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Spartak Braho dhe Milva Ekonomi.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslim Murrizi, Isuf Çelaj, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Braimllari dhe Xhemal Gjunksi.

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Ismail Shehu -Drejtore i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore

Behar Salillari - Përgjegjës i stafit teknik të Komisionit Qendror “Dëshmor i Atdheut”

Gjergj Velo - Kryetar i organizatës “Për Dëshmorët e Atdheut”

Dalan Buxheli – anëtar

Shaqir Vukaj - anëtar

Sandër Lleshaj – Ministër i Brendshëm

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Përshëndetje!

Fillojmë diskutimin e 2-3 neneve të para, ndërkohë që po mbërrin edhe një kolege. Pastaj do të votojmë secilin prej tyre, sepse pa kuorumin e nevojshëm nuk i votojmë dot. Pra, të bëjmë diskutimin paraprak, meqenëse kemi bërë diskutimin në parim. Jemi njohur me komentet që ka sjellë Komisioni i Ligjeve, i cili është komision për dhënie mendimi. Që më herët jemi njohur me propozimet e organizatës “Për Dëshmorët e Atdheut”, si edhe me qëndrimin e Ministrisë së Mbrojtjes ndaj secilit prej propozimeve tuaja. Të gjitha këto dokumente i kemi në tavolinë. Jemi përpjekur të ndërtojmë një dokument që i integron të tria këto qëndrime. Sidoqoftë do t’i diskutojmë pikë për pikë, me qëllim që të arrijmë formulimin më të mirë të duhur, i cili të reflektojë sugjerimet tuaja, po ashtu qëndrimin e ministrisë, edhe atë të Komisionit të Ligjeve, natyrisht, edhe qëndrimet që do të kenë kolegët.

Ndërhyrjet, ju lutem, të jenë vetëm për të përmirësuar nenet, sepse ne e kemi kaluar fazën e diskutimit dhe të pyetjeve. Pra, për të mos humbur kohë të dyja palët, të vijojmë më tutje.

Neni 1 “Objekti”.

“Objekt i këtij ligji është përcaktimi i kriterëve dhe procedurës për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, si dhe të drejtave dhe përfitimeve që rrjedhin nga ky status”. Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Kolegët, a e kanë të gjithë përpara ligjin për statusin?

Neni 2 “Qëllimi”.

Unë si relatore, kam një ndërhyrje dhe këtë e kam pasur në përgjithësi për të gjithë tekstin e ligjit, se duhet të korrigjohet nga pikëpamja e shkrimit, nga ana gjuhësore, sepse ka gabime, presje të vendosura vend e pa vend, lidhëza. Kjo u takon redaktorëve që ne kemi në parlament, por meqenëse nganjëherë këto kalojnë edhe pa u korrigjuar, jemi përpjekur që në tekst të reflektojmë edhe këto ndryshime, të cilat, për të mos humbur kohë nuk do t’i citoj se ku nuk duhet një presje apo një lidhëz.

Këtu kemi vetëm një propozim, që vjen nga Komisioni i Ligjeve dhe për mua ka kuptim, si relatore e këtij projektligji që është heqja e mbiemrit “të jashtëzakonshëm”. Qëllimi i ligjit është shpallja ose njohja e statusit “Dëshmor i Atdheut” për persona, të cilët

në akte të rralla patriotizmi, vetëmohimi dhe heroizmi kontribuan në luftën për liri, pavarësi dhe si vijon, si edhe personat, të cilët kanë dhënë dhe japin jetën.

Besoj se është me vend sugjerimi që vjen nga Komisioni i Ligjeve për faktin se “i jashtëzakonshëm” është kategori subjektive, pra nuk ka pse të përfshihet në tekstin e këtij neni. Besoj, se jemi dakord të gjithë.

Miratohet.

Në nenin 3, pika 3 thuhet se subjektet e këtij ligji janë të ndjerët, dëshmorët e atdheut, familjarët e tyre, si dhe organet e pushtetit qendror dhe të njësive të qeverisjes vendore që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Komenti që na ka ardhur nga organizata e “Dëshmorëve të Atdheut” dhe nga Komisioni i Ligjeve, natyrisht ka kuptim, është se në çdo nen të këtij projekti aty ku përmendet fjala “të ndjerët” të zëvendësohet me “të rënë”. Gjuha i përshtatet gjuhës ligjore, në këtë rast. Në rastin konkret, do të thosha se nuk do të ishte nevoja që ne ta thoshim këtë këtu, mund ta thoshim në mënyrë më koncize. Ta shprehnim këtë nen, duke thënë: “Subjektet e këtij ligji janë dëshmorët e Atdheut, familjarët e tyre, organet e pushtetit qendror dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj”. “Të rënë” janë dëshmorët, dhe jo çdo i rënë është dëshmor.

Ka një ndërhyrje.

Shaqir Vukaj - Për nenin 3 ne kemi 2 vërejtje. Fjala “të ndjerët” të zëvendësohet me “të rënë dhe të zhdukurit gjatë luftërave për liri”, sepse kemi edhe një kategori tjetër që janë zhdukur, nuk dihet si janë vrarë. Kjo kategori na del herë pas here, po flasim për Luftën Nacionalçlirimtare, por edhe në luftërat e mëparshme kemi të tillë të zhdukur. Kjo kategori duhet të përfshihet në ligj, duhet të merret dikush me këta.

Ermonela Felaj - Dakord. Unë nuk e kam në propozimet që ju keni sjellë zyrtarisht.

Shaqir Vukaj - Më falni! E kemi bërë tani shtesën.

Ermonela Felaj - Pavarësisht kësaj më duhet t’ju them se futja e fjalës “të zhdukur” e rëndon ligjin, sepse është një nocion tjetër, shpallja “i zhdukur” dhe “i vdekur” bëhet me vendim gjykatë, është nocion i Kodit Civil dhe nuk e fusim këtë gjë këtu. Ligji ka qëllim të njohë statusin e dëshmorëve, të rënëve, kemi thënë. Kjo bëhet nëpërmjet një procedure vendimmarrëse, e cila fillon që nga pushteti vendor, nga degët që duhet të

veprojnë në pushtetin vendor e deri në Komisionin Qendror për dhënien e statusit. Këto janë subjektet e ligjit.: të rënë për të cilët kërkohet shpallja ose njohja “dëshmor i atdheut”.

Shaqir Vukaj- Po për të zhdukurit? Ka qenë partizan, duke shkuar nga një çetë në një tjetër është zhdukur, nuk dihet se si. Si duhet të vlerësohet kjo kategori? Ka qenë i internuar në kampet e nazizmit, nuk është kthyer më në Shqipëri, si duhet të konsiderohet kjo kategori, të cilët kanë qenë partizanë, luftëtarë? Janë zhdukur, kemi disa raste, jo vetëm një. Unë mund të përmend shembuj konkretë, por nuk dua të hyj në hollësi. Si duhet të veprohet me këtë kategori?

Ermonela Felaj - Më lejoni që të marr mendimin e zëvendësministrit të Mbrojtjes.

Petro Koçi - Nuk është e nevojshme për ta shtuar këtë kategori, në rastin kur themi “të rënë, dëshmorët e atdheut” e kemi ezauruar. Komisioni Qendror i Statusit ”Dëshmorët e Atdheut” ka mundësinë për të shpallur edhe një të zhdukur dëshmor të atdheut. Në momentin që vendosim presjen, si të thuash i kemi vënë si kategori të veçuara ose do ta heqësh fjalën “ të rënë” dhe të thuhet: janë “dëshmorët të atdheut, familjarët e tyre” dhe e liberalizon edhe më tej.

Ermonela Felaj - Unë ashtu e propozove, për të qenë më koncizë të bëhet: “ Subjekte të këtij ligji janë, dëshmorë të atdheut, familjarët e tyre, organet e pushtetit qendror dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore që nga ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj”. Më duket se “i zhdukur” apo “i rënë” që është shpallur dëshmor është subjekt i këtij ligji. Nëse ai nuk është njohur ose nuk është shpallur dëshmor, nuk ka sesi të jetë subjekt i këtij ligji. Nuk përfiton asnjë të drejtë nga ky ligj.

Shaqir Vukaj - Po kur është në studim? Kemi raste konkrete. Si duhet të veprohet me këtë të zhdukur?

Ermonela Felaj - Po, pra ne po themi që fjalët “dëshmorët e atdheut” i përmbledhin të dyja shqetësimet që keni ju: edhe të rënë, të cilëve u dihet fati nga fillimi në fund, edhe atyre që janë zhdukur. Por kjo është një kategori që do të ndjekë një procedurë tjetër paraprakisht, do të shpallet si i zhdukur me vendim gjykate. Pastaj do të ndiqet procedura për njohjen ose për shpalljen, se nëse nuk ka vendim për njohjen si i zhdukur, nuk mundet që komisioni për shpalljen si “i zhdukur” ose si “i vdekur”, sepse kanë kaluar edhe afatet që parashikon ligji për shpalljen si i zhdukur, nuk mundet që ligji ta njohë si subjekt, çdo lloj ligji.

Shaqir Vukaj - Para se të vijë në Komisionin Qendror për t'i dhënë statusin plotësohen një mori dokumentesh, të cilat kalojnë ose në këshillin e qarkut ose te prefekti, e përfshijnë këtë që thoni ju. Nëse është dashur për të marrë një certifikatë ajo është marrë, nëse është dashur për të marrë një vendim gjykate është marrë e të tjera. Këto bëhen paraprakisht, para se të shkojnë në Komisionin Qendror.

Petro Koçi - Zonja kryetare, që të mos e zgjasim kot, i gjithë ligji, gjuha e tij thotë: “kanë humbur jetën”, pra edhe një i zhdukur, ka humbur jetën. Nuk ka asnjë pengesë që një i zhdukur në kampet e përqendrimit apo në rrethana të veçanta gjatë luftës të shpallet dëshmorë i atdheut. Nëse do të kishte pengesa, atëherë shqetësimi do të ishte me vend.

Ermonela Felaj - Dakord. A ka ndonjë mendim tjetër nga kolegët?

Vullnet Sinaj – Jam dakord me mendimin e zotit Koçi.

Ermonela Felaj - Atëherë, që të gjejmë një konsensus dhe të mos mbetemi këtu, ligji ka subjekt dëshmorët. Ligji nuk merret me të vdekurit, të zhdukurit e të tjerë, ligji merret me dëshmorët. Se si shpallen dëshmorët, është në pikat e tjera të nenit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sadi Vorpsi - Unë mendoj që të shënojmë: “Subjekte të këtij ligji janë të rënë, dëshmorët e atdheut, familjarët e tyre. Organet e pushtetit qendror dhe njësitë e qeverisjes vendore ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e...” Nuk janë subjekt organet e qeverisjes vendore.

Ermonela Felaj - Subjekte nuk janë vetëm ata që kanë të drejta, por edhe ata që marrin detyrime. Organet vendore dhe qendrore kanë detyrimin, që ne do t'i shikojmë në pjesë të tjera të ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kanë detyrime. Mirëmbajtjen e lapidarëve, të varrezave, kush do ta bëjë? Ka detyrim që t'i ia ngarkon, prandaj të referon ligji dhe bëhesh subjekt i ligjit në momentin që unë të njoh këtë të drejtë apo të ngarkoj një detyrim. Unë besoj se jemi të qartë për qëndrimet, subjektet do të jenë ato që relatuam në mënyrë koncize.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Për procedurë, ju e dini shumë mirë që grupet e interesit dëgjohen vetëm në momentin e parë. Nuk kam asnjë detyrim që t'ju dëgjoj nen për nen, sepse i kam të depozituara dhe e di qëndrimin tuaj. Tani është komisioni që merr vendimin.

Unë po ju dëgjoj, por e dëgjuara ka edhe një limit dhe shkon deri këtu. Kjo do të jetë kështu. Ju lutem, a ta mbaroj nenin 3?

Shaqir Vukaj – Për nenin 3 e kam fjalën.

Ermonela Felaj – Çfarë shtese keni tjetër?

Shaqir Vukaj- Të shtohet: “Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Atdheut”. Këtë kemi kërkuar ne në këtë nen. Këtë nuk e thatë ju.

Ermonela Felaj - Ndërhyrja është e drejtë, por ne nuk do ta vëmë “Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Atdheut”, por do ta vëmë “Organizatat e Dëshmorëve të Atdheut”, sepse mund të krijohen disa organizata që kanë të njëjtin objekt veprimtarie dhe këtë nuk mund ta ndalojmë. Do t’i referohemi në mënyrë të përgjithshme. Përfundimisht ky nen do të riformulohet në këtë mënyrë: “ Subjektet e këtij ligji janë dëshmorët e atdheut, familjarët e tyre, organizatat e dëshmorëve të atdheut, organet e pushtetit qendror dhe të njësisve të vetëqeverisjes vendore që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj”.

Kush është dakord me nenin 3? Në rregull.

Meqenëse nuk kishim kuorumin në momentin e parë, tani jemi dhjetë anëtarë, kush është dakord me nenin 1?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3?

Miratohet.

Neni 4 “ Përkufizimet”. Përkufizimi që lidhet me fjalën “person” ka një riformulim të sugjeruar nga Komisioni i Ligjeve. Sipas këtij riformulimi duhet ta shprehim në këtë mënyrë këtë përkufizim: “Person” është shtetasi shqiptar, shtetasi i huaj ose pa shtetësi që ka jetuar dhe vepruar përpara datës së krijimit të shtetit shqiptar (28 nëntor 1912)”.

Petro Koçi - Për të qenë më të saktë, do të quhet personi, individi me shtetësi shqiptare, shtetasi i huaj.... pra u përdor termi “individ”.

Ermonela Felaj – Nëse shprehemi personi është individi, nuk shkon. Sugjerojmë këtë gjë: “Person është shtetasi shqiptar”. Të hiqet fare dhe e bëjmë direkt.

Petro Koçi - Po, e drejtë.

Ermonela Felaj – Në kuptimin e këtij ligji, cilin do të kuptojmë me “person”? Do të kuptojmë shtetasin shqiptar, shtetasin e huaj, atë pa shtetësi që ka jetuar dhe vepruar përpara datës së krijimit” dhe jemi në rregull. Jemi dakord?

Shpallje. Vendimet e Komisionit Qendror për statusin “Dëshmor i Atdheut...

Petro Koçi - Më falni? Mos duhet një rregullim këtu: “si edhe ai/ajo që ka jetuar dhe vepruar para datës së krijimit”.

Ermonela Felaj- Pse do të themi edhe personi fizik?

Petro Koçi – Jo personi fizik. Nuk kemi pasur shtet, nuk e quan dot shtetas.

Ermonela Felaj – Po e ke edhe atë pa shtetësi.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Shaqir Vukaj - Ka qenë nocion komplet tjetër para vitit 1912 për shtetësinë. Është specifikuar që të mos mbeten jashtë.

Petro Koçi- Prandaj të thuhet: “si edhe ai ose ajo”. Për person është fjala. Ky është mendimi im.

Ermonela Felaj- Nuk ka kuptim, e di si i bie kështu që i gjithë globi që ka jetuar para 28 nëntorit. Ne e miratuar tani. Kështu i bie, çdo person që ka jetuar në globin tonë para se të krijohet... Edhe atëherë njerëzit regjistroheshin, lindjet, vdekjet, kishte dokumente. Nuk mund ta themi me siguri që nuk kishte.

Me përkufizimin e termit “shpallje”, ka vetëm një sugjerim, që të korrektojmë termat dhe t'i njehsojmë, sepse diku është përdorur fjala “jep”, diku tjetër fjalët “dhënë statusi”, kur në fakt që në titullin e ligjit kemi thënë: “shpalljen ose njohjen”. Këto do të përdoren bashkë: shpallje ose njohje. Dakord?

Miratohet edhe kjo pikë me këtë korrektim.

Nuk kam asnjë vërejtje për përkufizimin “njohje”, kalon edhe kjo. “Familje dëshmor i atdheut”, po ashtu. Organet shtetërore të mëparshme, gjithashtu.

Kalojmë te përkufizimi “subjektet kërkuese”. Sipas të gjitha sugjerimeve që kemi në tavolinë, kjo pikë do të riformulohet në këtë mënyrë: “subjektet kërkuese, përfaqësues të familjeve të të rënëve (ose mund të themi “përfaqësues i familjes së të rënit) për të cilin kërkohet shpallja ose njohja dëshmor i atdheut. Hiqet lidhëza “apo” se është pa vend aty, dhe vazhdojmë: “Përfaqësues të familjes së dëshmorit, drejtues të organeve shtetërore, organizatave të dëshmorëve të atdheut, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile”. Këto janë subjektet kërkuese, me radhë që nga njerëzit e familjes së të rënit. Jemi dakord me këtë?

Shaqir Vukaj - Që të vihet Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Atdheut”.

Ermonela Felaj - E thamë arsyen, nuk mund ta njohim, pavarësisht se ju jeni organizatë kombëtare, por ligji civil nuk ndalon dot krijimin e organizatave të tjera me të njëjtin funksion dhe me të njëjtin qëllim. Pra, jemi të detyruar që për këtë shkak të themi: “Organizatat e mbrojtjes së dëshmorëve të atdheut”. Për sa kohë jeni një, juve do t’ju referohen, sepse nuk ka organizatë tjetër kujt t’i referohen.

Shaqir Vukaj – Njëlloj si partitë që janë 150, por në fakt janë 5-6.

Ermonela Felaj- Ligji “partitë” thotë, nuk i thotë me emra.

Kalojmë në pikën tjetër që lidhet me organet publike. Unë kam bërë vetëm një korrigjim të vogël, aty ku thuhet “pushtetet kushtetuese”, nuk është term që përdoret, por thuhet “organet kushtetuese”. Organet publike janë organet përfaqësuese të pushtetit qendror dhe vendor, institucionet e administratës qendrore dhe vendore, organet kushtetuese, personat fizikë dhe juridikë në masën që ata përmbushin dhe vazhdon fjalë. Jemi dakord edhe me këtë pikë? Dakord.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 “ Dëshmorë të atdheut shpallet ose u njihet statusi si të tillë”. Kemi disa germa dhe duke parë edhe propozimet që vijnë nga Organizata e Dëshmorëve, edhe qëndrimin e Ministrisë së Mbrojtjes shikoj se ka dakordësi me qëndrimin e Organizatës së Dëshmorëve që germat ”dh” dhe “f” të ndryshohen, siç i ka propozuar Organizata Kombëtare e Dëshmorëve. Si relatore jam dakord paraprakisht. Kolegë, jeni dakord? Është bërë një saktësim që lidhet me afatin dyvjeçar, pra kjo kohë përcaktohet më mirë. Ndërkohë Organizata Kombëtare e Dëshmorëve ka bërë edhe një propozim që pas germës “ p”, të shtohet një germë tjetër” q”, që njeh si dëshmorë edhe shtetasit shqiptarë që kanë rënë për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit serbë në vitin 1998-1999. Kam paraprakisht mendimin e Ministrisë së Mbrojtjes, që sugjeron se këtë pikë e kemi të ezauruar në germën “f”. Mund ta shikojmë germën “f”, e cila thotë: “ Shtetasit shqiptarë, të cilët kanë rënë duke luftuar për pavarësinë e Kosovës, si dhe shtetasit shqiptarë të rënë për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan”. Jemi dakord? Po.

Nga Ministria e Mbrojtjes kam një tjetër propozim në këtë pikë.

Petro Koçi - Është një sugjerim individual, i cili kërkon që dikush nga deputetët ta ndërmerre si amendament.

Ermonela Felaj - Po jua lexoj kolegëve, me qëllim që ta amendojmë në këtë pikë.

Propozimi është ky, që ne të njohim edhe një kategori tjetër si dëshmorë, bëhet fjalë për kategorinë e shtetasve shqiptarë, pjesëmarrës në formacionet e ushtrisë Nacionalçlirimtare që janë pushkatuar me vendim të gjyqeve partizane për shkelje të moralit partizan dhe që më vonë ka rezultuar se gjykimi ka qenë i pambështetur në prova. Ka disa raste që janë bërë publike, rasti i Ramize Gjebresë, është një rast pothuajse simbolik i gjithë kësaj. A mendoni se është e drejtë që ta shtojmë këtë pikë për t'i njohur? Meqenëse kemi dakordësi të gjithë në këtë komision...

Petro Koçi - Dikush është pushkatuar vetëm për një defter, letër, sepse e akuzoi partizanin ai që e priste në shpi të nesërmen. Më vonë rezultoi se kjo familje që mikëpriste partizanin nuk ishte dashamirëse e luftës dhe e kishte bërë këtë gjë për qëllime diskreditimi. Është vrarë për një defter, letër. Më vonë është rishikuar, por ligji nuk e ka lejuar.

Vullnet Sinaj - Unë kam në familjen time, është vrarë burri i hallës, kaloi nga një betejë në Dukat do të shkonte për betejën tjetër, por u kthye në shtëpi në darkë dhe vetëm për këtë u pushkatua.

Ermonela Felaj - Kemi dakordësinë të gjithë dhe në nenin 5, një nga gerrat e reja që do të reflektohet, do të jetë germa “q”.

Urdhëroni!

Shaqir Vukaj – Me qenë se na kanë dalë raste të tilla, për nenin 5, germën “dh” të ngelet siç është, por pas “shtetasit shqiptarë që janë ekzekutuar apo kanë vdekur në burgjet dhe kampet nazifashiste të përqendrimit”, të shtohet “apo në kampet e tjera të aleatëve”. Sepse ka ndodhur, ta zëmë, të hyjnë amerikanët, e kanë marrë komplet kampin, kanë krijuar kampin e vet (kemi miliona njerëz në atë periudhë të luftës ku ka pasur edhe shqiptarë të cilët kanë vdekur në kampin amerikan, anglez apo sovjetik). Prandaj e kërkojmë ta shtojmë këtë frazë.

(Diskutime pa mikrofon)

Petro Koçi – Më falni, e mbulon pika “dh”, sipas së cilës, nëse dikush ka vdekur brenda dy vjetëve pasi ka dalë nga kampi nazist, nuk ka rëndësi ku ka vdekur ai, ka vdekur në një kamp amerikan, ka vdekur në Shqipëri apo ka vdekur rrugës, rëndësi ka që ka vdekur për shkak të plagëve të marra dhe torturave në kampin nazist. Kjo ka rëndësi, jo vendvdekja.

Ermonela Felaj – Dakord.

Atëherë jemi dakord me nenin 5.

Neni 6. Ka një sugjerim që na vjen nga Organizata Kombëtare e Dëshmorëve, që pika 4 e këtij neni e cila bën fjalë për rastin kur nuk duhet njohur statusi “Dëshmor i atdheut” personave të cilët, pas majit të vitit ’45, janë dënuar për vrasje me dashje.

Organizata Kombëtare e Dëshmorëve mendon se kjo pikë duhet hequr nga ligji.

Ministria e Mbrojtjes është kundër. Mund ta dëgjojmë argumentin tuaj?

Shaqir Vukaj – Dakord të mbetet siç është.

Ermonela Felaj – Atëherë u tërhoqët. Dakord.

A ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët?

Miratohet neni 6.

Neni 7. Nuk ka vërejtje për këtë nen.

Miratohet.

Neni 8. Ka vetëm një sugjerim që vjen nga Komisioni i Ligjeve, i cili thotë se pika 3 e këtij nenit, që bën fjalë për llojet e dokumenteve që duhen paraqitur për të njohur statusin e dëshmorit, të mos reflektohet në këtë nen, por të reflektohet në nenet më poshtë, në nenin 9/2 dhe 24/3.

Si relatore jam kujdesuar që kjo të relatohet, kështu që besoj se heqja nga këtu bën sens, sepse te ky nen shpallet vetëm në mënyrë të përgjithshme se cilat janë dokumentet që vlejnë. Pra, nuk flitet për procedurë ose për përmbajtje, por flitet në përgjithësi. Meqenëse e reflektojmë në pikat më poshtë nuk kemi pse të mos biem dakord për ndërrimin e vendit.

Kush është dakord me këtë sugjerim për miratimin e nenit 8?

Miratohet.

Shaqir Vukaj – Te neni 7 ne kemi një vërejtje shumë të bazuar dhe kërkojmë që të shtohet dhe do t’ua argumentoj pse.

Po citoj nenin 7...

Ermonela Felaj – Më falni, ka edhe një pjesë më poshtë ku flitet për këtë moment. Aty fiksohet parimi që ky ligj nuk ka fuqi prapavepruese, sepse ligjet civile nuk kanë fuqi prapavepruese, me përjashtim të ligjit penal. Për rastin që ju keni ngritur e kemi parashikimin më poshtë. Unë e kam pasur parasysh ndërhyrjen tuaj dhe jam munduar që t’ua mbështes ndërhyrjen, sepse është e drejtë.

Prandaj nenin 7 po e lëmë ashtu.

Petro Koçi – Ka edhe një argument, se nëse ne do të rishikojmë dhe do të anulojmë të gjitha vendimet që janë marrë para këtij ligji, i bie që e gjithë lista e dëshmorëve të shfuqizohet, se ato ligje nuk janë më në fuqi.

Ermonela Felaj – Është siguri juridike, është parim kushtetues siguria juridike dhe për këtë arsye ligjet nuk kanë fuqi prapavepruese.

Shaqir Vukaj – E kam thënë dhe po e përsëris, te supermarketi VEFA u vranë 5 vetë, kur u vu ajo bomba, nëse e mbani mend. Të pestë janë shpallur dëshmorë me një vendim. Në periudhën '92-'94 kemi shpallje dëshmorësh nga rrethet duke mos u bazuar në ligj, aq sa Aleksandër Meksi, në atë periudhë kur ishte kryeministër, u bëri shkresë të gjitha rretheve që të anulonin vendimet e marra, sepse në atë periudhë janë shpallur dëshmorë pa qenë fare, sepse ligji ishte shfuqizuar në '88-n dhe këtë të drejtë e kishte vetëm KM-ja.

Kuptojeni pra, ka disa të shpallur dëshmorë që nuk janë në fakt dëshmorë.

Ermonela Felaj – E kuptova merakun tuaj.

Urdhëroni, zoti Sina!

Vullnet Sinaj – Te pika 1 kam një merak, sepse kam një rast të një personi që do ta shpallë gjyshin e vet dëshmor, por nuk e shpall dot, sepse nuk ka burime parësore (dokumente të organeve publike), por ka vetëm burimet dytësore (botime me karakter historik apo folklorik).

Atëherë, do të doja të shprehej më qartë në këtë nen, ku të thuhet “për shpalljen “Dëshmor të atdheut” vlejnë si burime parësore dokumente të organeve publike, të krijuara në kohën e ngjarjes dhe, si burime dytësore, burimet me karakter historik, folklorik, publicistik, manuale e biografike, të cilat shprehen për ngjarjen”.

Tani, duket sikur duhet të plotësohen të katërta këto, në fakt, e merr titullin edhe kur janë këto të parat, por janë të dytat.

A mund ta bëjmë dallimin këtu?

Ermonela Felaj – Po bëj një shpjegim. Këtu ka një lidhëz, që është lidhëz bashkërenditëse dhe që u jep dyja pjesëve të njëjtën vlerë.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë nuk e referova heqjen e presjes, sepse m'u duk pak e tepruar që në çdo rast të thosha “hiqet presja”, “hiqet lidhëza”, por këtë e kam bërë në material. Materiali do të kërkojë të kalojë edhe te redaktorët parapara se të vijë në seancë.

(Diskutime pa mikrofon)

Këtë problem do ta zgjidhin redaktorët. Do të vëmë shënimin që redaktorët ta shprehin si duhet.

Pra, vlejnë njësoj burimet parësore dhe burimet dytësore.

Kalojmë te neni 9.

Për nenin 9 ka një riformulim që na vjen nga Komisioni i Ligjeve për dy pikat e para. Po citoj: “Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” mund të paraqitet nga përfaqësues të familjes së të rënit për të cilin kërkohet të shpallet ose të njihet “Dëshmor i atdheut” ose përfaqësues të autorizuar të organeve shtetërore, organizatave të dëshmorëve të atdheut dhe shoqërisë civile ose nga çdo deputet.

Për germën “b” propozohet kjo përmbajtje: “Formati i kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre përcaktohen me udhëzim të kryetarit të Komisioni Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.

Ju e keni diskutuar edhe në Komisionin e Ligjeve këtë pikë, përderisa mua më ka ardhur me raport nga Komisioni i Ligjeve. Personalisht, e ka gjetur me vend që ne t’i reflektojmë këto dy pika, ashtu si i kanë riformuluar kolegët e Komisionit të Ligjeve.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea - Faleminderit!

Unë kam vetëm një koment në lidhje me pjesën e shoqërisë civile dhe shoqatat e veteranëve apo të dëshmorëve të atdheut, sido që t’ua vëmë emrin. Në qaftë se ua kemi lënë për detyrë këtyre, nuk ka pse të futet edhe shoqëria civile. Shoqëria civile le të bëjë një konsultë me këto organizata që merren me këtë punë dhe të llojë aty, që këta ta propozojnë si emër, se ndryshe do të krijohet një ngatërresë shume e madhe.

Ermonela Felaj – Elona, paraprakisht mund të ketë shoqata të ndryshme, për shembull “Nderi i Tiranës”, që përfshin dëshmorë, emra të njohur e të tjerë, atëherë, pse ta ndalosh, se ai e ka objekt. Njerëzit me vullnetarizëm bashkohen dhe sa më e madhe të jetë mundësia për të bërë një kërkesë të tillë, unë mendoj se ne vetëm ndihmojmë, nuk është se kemi zvogëluar mundësitë.

(Diskutime pa mikrofon)

Elona Gjebrea – Ideja ishte që kanë një ekspertizë më të madhe dhe një informacion më të plotë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Unë nuk besoj që kjo është thelbësore për ligjin.

(Diskutime pa mikrofon)

Shaqir Vukaj – Në këtë pikë, meqenëse ne e kemi propozuar ngritjen e një instituti të dëshmorëve, që për mendimin tonë është bërë i domosdoshëm, të vihet “dhe Instituti Dëshmorët e Atdheut”.

Ermonela Felaj – Jo, nuk mund ta vëmë që këtu. Atë do ta diskutojmë në fund dhe do ta themi edhe arsyen pse.

Kundër dhe abstenime nuk ka. Atëherë, neni 9 miratohet.

Kalojmë te neni 10, Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit.

Për pikën 1 të këtij neni kam dy propozime te formulimi.

E para: “Pranë Ministrisë së Mbrojtjes krijohet Komisioni Qendror i Statusit Dëshmor i Atdheut, i cili është autoriteti që shpall ose njeh”, pra jo “jep ose njeh”.

Sipas propozimit të bërë nga këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, prefekti ose ministri përkatës për subjektet, jo “nën”, por “në fushën e përgjegjësisë së tij”.

Jemi dakord?

Dakord.

Kalojmë te pika 2.

Edhe të pika 2 ka vetëm korrigjime të vogla. Komisioni Qendror i Statusit Dëshmor i Atdheut është organ kolegjal dhe i përhershëm, i cili përbëhet nga 7 anëtarë. Komisioni kryesohet nga ministri i Mbrojtjes dhe në përbërjeje ka 4 anëtarë në rang zëvendësministrash dhe 2 anëtarë nga organizatat e mbrojtjes së dëshmorëve.

Ky është ndryshimi që ne bëmë këtu, që jo çdo lloj organizate që vjen nga shoqëria civile të arrijë te komisioni, por organizata që kanë këtë dhe vetëm këtë fokus, mbrojtjen e dëshmorëve.

Jemi dakord?

Dakord.

Urdhëroni, zoti Koçi!

Petro Koçi – Çështja e dëshmorëve duhet kuptuar që është një çështje e lidhur fort me LANÇ-in, pra ne nuk mund të japim ekskluzivitet. Këtu është thënë “shoqërisë civile” në mënyrë që edhe Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës të ketë mundësinë të përfaqësohet në këtë komision, ashtu siç edhe sot, pra është edhe Komiteti i Veteranëve, edhe Organizata Kombëtare Dëshmorët e Luftës dhe dëshmorët e tjerë të atdheut.

Ermonela Felaj – A mund ta bëjmë Organizata e Mbrojtjes së Dëshmorëve dhe Organizata e Veteranëve të Shqipërisë?

(Diskutime pa mikrofon)

Shaqir Vukaj – Ne jemi Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Atdheut të të gjitha kohrave, jo vetëm të LANÇ-it. Pra, ne përfshijmë gjithçka që lidhet me dëshmorët që nga 1870, ta zëmë, kurse fjala “veteranë” është vetëm për një periudhë të caktuar. Pra, ky ligj

nuk është vetëm për statusin e dëshmorëve të LANÇ-it, por dëshmorëve të atdheut të të gjitha kohërave.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

A mund t'u bëj një sugjerim kolegëve?

Është mbledhja e dytë që bëjmë për statusin e dëshmorëve dhe, në fakt, unë nuk kam parë asnjë organizatë tjetër të interesuar për përmbajtjen e këtij ligji, kështu që vetëm për kaq, për faktin që janë interesuar, kanë punuar në vazhdimësi, kanë ardhur këtu t'i mbrojnë, unë besoj se ne duhet t'ua njohim këtë gjë, edhe për respekt.

Do ta vëmë “organizata e dëshmorëve” dhe do ta lëmë këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Jemi dakord me këtë pikë?

Urdhëroni!

Luan Harusha - Faleminderit!

Po sikur të çohet një organizatë tjetër e veteranëve dhe të kërkojë të njëjtën gjë?

Ermonela Felaj – Atëherë, ne nuk jemi këtu me Organizatën e Veteranëve, se jua kemi bërë njohjen e të drejtave të veteranëve, por jemi për njohjen e të drejtave të dëshmorëve dhe nuk kemi thënë “organizata kombëtare”, emrin që ka kjo organizatë, por kemi thënë në përgjithësi “organizatat e mbrojtjes së dëshmorëve”. Pra, çdo organizatë që është sot dhe ato që mund të ngrihen nesër me këtë fokus, ka të drejtë që në atë komisionin qendror të bëjë pjesë. Nuk do të jenë vetëm këto përjetë.

Shaqir Vukaj – Si duket nuk e keni të qartë. Organizata e Veteranëve është e veçantë, ka status të veçantë, ka ligj të veçantë për të.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ata janë të gjallët e luftës, ne po flasim për të rënë.

Petro Koçi – Lufta dhe dëshmorët janë të lidhur si mishi me thoin. Këta kanë qenë në një organizatë, më vonë janë ndarë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Më falni, çfarë pune prish shprehja “organizata e mbrojtjes së dëshmorëve”, kur është një shprehje e përgjithshme dhe nuk identifikon asnjë organ në tërësi, por identifikon thjesht fokusin e veprimtarisë së organizatës, e cila, nëse e ka këtë fokus, do të jetë pjesë e komisionit, nëse nuk e ka, nuk bën pjesë. Kaq e thjeshtë është.

(Diskutime pa mikrofon)

T'i rrimë ligjit korrektë!

Ne i bëmë subjektet e ligjit dhe nuk thamë që subjekte të këtij ligji janë edhe organizatat e veteranëve, por thamë se subjekte të këtij ligji janë subjektet e mbrojtjes së dëshmorëve.

Tani, ose do të mbajmë një linjë, ose ...

Petro Koçi – Po kemi thënë “shoqëri civile”.

Ermonela Felaj – Po ne thamë se nuk do ta fusim shoqërinë civile vend e pa vend, sepse në fund të fundit ne po bëjmë një projekt, ku besoj se edhe ju, edhe ne, të paktën, të kemi shprehur mbështetje për Organizatën e Dëshmorëve.

Atëherë, miratohet kjo pikë.

Kalojmë në pikën 3.

Ka vetëm një riformulim për pikën 3: “Rregullat për organizimin dhe funksionimin e komisionit qendror përcaktohen me vendim të KM-së, me propozim të ministrit të Mbrojtjes”, sepse përbërjen e kemi përcaktuar më lart...

Petro Koçi – Po, është përbërja sipas dikastereve. Prapë do të thuhet zëvendësministri i kësaj ministrie.

Ermonela Felaj – Dakord. Atëherë, ngelemi te varianti siç është.

Dakord me këtë pikë.

Kalojmë në pikën 4.

Për këtë pikë unë nuk kam asnjë vërejtje.

Miratohet kjo pikë.

Kalojmë në pikën 5.

Kam vetëm një ndërhyrje të vogël, që këtu të përdoret shumësi te fjala “mbledhje”, pra “për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisionit”, se duke thënë “mbledhje” duket sikur vetëm një mbledhje do të bëjë ky komision.

Dakord.

Te pika 6 ka vetëm një korrigjim te presjet dhe nuk kam asnjë vërejtje tjetër.

Për pikën 7 kemi shtuar vetëm një gjë që ne e thamë edhe në mbledhjen që bëmë më herët.

Pra, komisioni qendror të raportojë një herë në vit para KM-së, por të raportojë edhe në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

A jemi dakord?

Dakord.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea - Faleminderit!

Meqenëse këtu futen në detaje dhe sqarohen se si duhet të raportojë komisioni qendror, nuk e shoh se sa mbledhje, minimumi, duhet të bëjnë anëtarët e komisionit qendror, se e përcaktojmë se do të marrin shpërblim apo pagesë për mbledhjen, por nuk thuhet se sa mbledhje.

Ermonela Felaj – Jo, nuk e përcaktojmë dot, sepse ato do të mblidhen sa herë që ka kërkesa për shpalljen “dëshmor” dhe kanë afat brenda të cilit do të japin vendime, kështu që, kur të raportojnë, do të llogarisin totalin e punës që u është dashur të bëjnë.

Më pas do të shohim se ka disa përcaktime që i takojnë kësaj pjese, kështu që unë sugjeroj të ngelemi në këto ndërhyrje të vogla që përmenda.

Atëherë, jeni dakord me nenin 10, me vërejtjet që diskutuam?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenime? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë te komisionet vendore.

Pranë këshillave të qarqeve, bashkive dhe pranë prefekturave ngrihen dhe funksionojnë komisione për shqyrtimin e kërkesave “për shpalljen ose njohjen” e statusit të dëshmorit.

Pra, është i vetmi korrigjim, në vend të fjalës “dhënien” kemi “shpalljen”.

Miratohet.

Pika 2. Kërkesa për “shpalljen ose njohjen” e statusit të dëshmorit shoqërohet me dokumente, dhe si vazhdon fjalia deri në fund.

Nuk ka asnjë vërejtje të depozituar në lidhje me këtë pikë.

Po kështu, nuk kam asnjë vërejtje as edhe për pikën 3, që i detyron komisionet që brenda një muaji nga depozitimi i kërkesës t’i shqyrtojnë dokumentet, për të vendosur në lidhje me kërkesën e bërë. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për pikën 4 dhe pikën 5, për të cilat nuk ka vërejtje as nga ligjet, as nga organizata e dëshmorëve, ndaj unë si relatore jam dakord, përveç reflektimeve gjuhësore.

Atëherë, kolegë, ta kalojmë nenin 11?

Faleminderit! Votohet edhe ky nen.

Kalojmë te neni 12.

Shaqir Vukaj – Në lidhje me pikën 1, se na kaloi. Në këto mbledhje pranë këshillave e të tjera, të marrin pjesë edhe përfaqësues të organizatave të dëshmorëve, meqë e bëmë në shumës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Po, atë do të thosha. Mbledhjet e këshillit bashkiak të qarkut janë të hapura. Rendi njoftohet paraprakisht, kështu që kushdo mund të vejë. E kemi të ezauruar me ligj tjetër. Mbledhjet janë të hapura me ligj, ashtu siç janë të hapura mbledhjet e parlamentit, të komisioneve, kështu që mund të njoftoheni paraprakisht për agjendën e tyre të punës dhe të vendoset të merrni pjesë.

Kalojmë te pika 12, e cila bën fjalë për detyrimet që ka ministri. Këtu kemi vetëm një korrigjim. Në rastet e të rënëve, sipas shkronjave që përmenden në këtë nen, ministri, brenda fushës së përgjegjësisë së të cilit është i rëni. Mos e bëni shprehni në këtë mënyrë, por: me fushën e përgjegjësisë së të cilit lidhet aktiviteti i të rënit. Mund t'i propozohet drejtpërsëdrejti komisionit qendror të statusit “Dëshmor i atdheut” shpalljen e të rënit “Dëshmor i atdheut”. Pra, “i ndjeri” bëhet “i rëni”.

Jemi dakord me këtë?

Kush është dakord me nenin 12?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund ta përdorim fjalën “i ndjeri” në tekstin e një ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I rëni është në fushën e përgjegjësisë së një ministri? Më mirë të themi: “Aktiviteti i tij shoqëror lidhet me fushën e këtij ministri”.

Kalojmë te vendprehja e dëshmorëve të atdheut.

Ne e thamë edhe gjatë diskutimit në parim, që është një kre krejt i ri, i cili është bërë enkas për të respektuar të gjitha vendet që shërbejnë si përkujtimore të akteve vetëmohuese të të gjithë dëshmorëve të atdheut. Për mua bën e gjitha sens, dhe realisht tregon edhe vëmendjen që ka pasur Ministria e Mbrojtjes në momentin që ka punuar ose ka filluar punën për ndërtimin e këtij projekti.

Në këtë nen, nga Komisioni i Ligjeve ka një ndërhyrje vetëm për pikën 8. Pastaj do të flas edhe për ndërhyrjet që janë propozuar nga ju. Riformulimi është për pikën 8 të këtij neni.

“Varrezat e dëshmorëve të atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe trajtohen si objekte të trashëgimisë kulturore.”

Ky është një formulim i bërë nga Komisioni i Ligjeve.

Po, Elona!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e thashë, ky është formulimi që kanë bërë ata. para se të pyes nëse jeni dakord, dua të dëgjoje dhe mendimin tuaj.

Elona Gjebrea – Unë kam një sugjerim për pikën 1 të nenit 13. Kjo më duket e tepërt këtu, mund të jetë në relacion, fakti se janë ndërtuar dhe do të ndërtohen varreza ku prehen dëshmorët e atdheut. Kjo nuk thotë asnjë gjë, që të mund të jetë një nen, i cili duhet pasur në konsideratë. Është thjesht vetëm një informacion, i cili si fjali shkon te relacioni.

Ermonela Felaj – Në fakt, për këtë pikë nuk ka pasur asnjë vërejtje nga askush, as nga ministria, as nga Komisioni i Ligjeve e as nga organizata vetë. Meqenëse do të vazhdohet të shpallen dëshmorë të tjerë, si dhe të njihen dëshmorë edhe ata që nuk i kemi njohur deri më sot, patjetër që do të kërkohet të ndërtohen edhe objektet që i përkujtojnë këto akte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sepse më pas ka një pikë, ku thuhet e kujt i jepet e drejta për të kërkuar ndërtimin e objekteve përkujtimore.

Ka ndonjë opinion tjetër, përveç këtij opinioni, ose që është pro a kundër këtij opinioni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Kolegët e tjerë? Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si, je dakord? Ta heqim?

Ministria?

Ismail Shehu – Duke qenë një ligj i natyrës së veçantë, sepse po flasim për familjet e dëshmorëve të atdheut, ka brenda edhe elementë deklarativë, të një natyre pak më ndryshe nga si mund të shkruhej një ligj normal. Ka edhe elemente si ato që diskutuam te neni i parë: akte patriotizmi, heroizmi, sakrificash. Domethënë, këto elemente janë pjesë përbërëse. Edhe në modelet që kemi parë te ligji amerikan, mënyra se si e trajtojnë dhe formulimi i fjalive i ka brenda këto elemente. Kjo pika e parë duket vërtet deklarative, por realisht është një angazhim që Ministria e Mbrojtjes dhe shteti shqiptar marrin karshi familjeve të dëshmorëve, për të thënë se ne jemi të angazhuar edhe në të ardhmen për të ndërtuar varreza të tilla. Nuk mendoj se prish ndonjë punë.

Ermonela Felaj – Atëherë, kolegë, kush është dakord që të rrijë? Unë për vete jam dakord që të rrijë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë do të ngelet kjo pikë e nenit 1.

Ndërkohë, e gjeta edhe formulimin korrekt, siç e kanë bërë ligjet, për pikën 8. Shprehimisht, thuhet: “Varrezat e dëshmorëve të atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe trajtohen si monumente kulture, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, për shërbimin publik të varrimit dhe për trashëgiminë kulturore.”.

Më duket se është korrekt si formulim.

Kush është dakord me nenin 13, me të gjitha vërejtjet që u diskutuan?

Po, faleminderit!

Shaqir Vukaj – Më falni! Ne kemi bërë disa shtesa. Ju lutem, a mund t’i diskutoni?

Ermonela Felaj – Një sekondë, të lutem! Më fal! Kështu është kur fillojnë mbledhjet me vonesë, pason mbledhja tjetër.

Shaqir Vukaj – Ne s’kemi faj këtu, që filloni ju me vonesë.

Ermonela Felaj – Ndjesë! Fajet i kemi vetë.

Më falni, se në fakt duhej të referoja edhe ndryshimet që ka propozuar organizata e dëshmorëve. Organizata Kombëtare e Mbrojtjes së Dëshmorëve, në lidhje me këtë kapitull ka propozuar edhe mundësinë e zhvarrimit të atyre personave, që e kanë marrë statusin e dëshmorit në mënyrë të padrejtë ose të paligjshme, ose mundësinë e rivarrimit të personave të njohur rishtas dëshmorë, rivarrimit të eshtrave të tyre ose të mbetjeve të tyre mortore.

Si relatore, unë kam sugjeruar... Do t’ju mbështesja jo për të gjitha sugjerimet, po vetëm për pikat 10, 12 e 13.

Po i lexoj. Në pikën 10 ju thoni: “Në varrezat e dëshmorëve të atdheut nuk lejohet të varrosen persona të tjerë apo mbetjet e tyre mortore, që nuk kanë statusin e “Dëshmor i atdheut”.

Kolegë, më dëgjoni, ju lutem! Jeni dakord me këtë? Është normale që në varrezat e dëshmorëve të mos prehen edhe eshtrat e të ndjerëve të tjerë.

Për pikën 12 thuhet: “Shpenzimet...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por ka ndodhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, opinionin tim për pikën 11 u mundova ta ndaja edhe më parë. Mua më duket e ka një problem etik, moral, por që deri diku lidhet edhe me besimin se nuk do të ishte e udhës të zhvarrosim njerëz të cilët tashmë prehen në varrezat e dëshmorëve. Veç kësaj, nuk është një procedurë aq e thjeshtë sa ç’mund të merret me mend, sepse në çdo rast ka implikimet e saj. kësisoj, unë do të isha e idesë që të hiqnim dorë nga neni 11. Pra, të mos

fillonim me një akt, i cili s' më duket normal. Mjaft që ne të kemi të gjitha objektet ku prehen dëshmorët, të kemi të gjitha objektet që përkujtojnë veprën e tyre, të tregohet përkujdesje nga shteti dhe të krijohen mundësitë që edhe të tjerët që mund të shpallen dëshmorë, të prehen në po këto varreza. Prandaj nuk isha dakord me nenin 11.

Në lidhje me pikën 12, që propozohet nga organizata e dëshmorëve, ku thuhet: “Shpenzimet e varrimit të dëshmorëve të atdheut ose rivarrimit të mbetjeve të tyre të përballohen e të parashikohen nga shteti” jam plotësisht dakord që duhet bërë nga shteti.

Po kështu jam dakord edhe me pikën 13, që “Organizata e dëshmorëve të atdheut ka të drejtë të kërkojë nga organet kompetente, që në varrezat e dëshmorëve të atdheut të varrosen persona, të cilëve u është njohur statusi i dëshmorit apo të bëjë rivarrimin e mbetjeve mortore të të rënëve, që u është njohur statusi i dëshmorit, si dhe të kërkojë largimin nga varrezat e dëshmorëve eshtrat e atyre që s'u është njohur statusi i dëshmorit të atdheut.

Me këtë fjalinë e fundit nuk jam dakord për të njëjtat arsye që dhashë edhe për pikën 11.

Dua të dëgjoj kolegët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Propozimet tuaja i kam të shkruara, dhe këto janë gjërat që keni thënë. A mund të dëgjoj kolegët, të dëgjoj zotin Koçi, e pastaj t'u lë fjalën edhe juve?

Petro Koçi – Tani ajo puna e zhvarrimit do të ishte katastrofike për ne, nëse do ta miratonim një nen të tillë. Komentet do të ishin skandaloze. Do të dukej si një ligj makabër, jo një ligj që nderon, pavarësisht se mund të ketë raste kur nuk është respektuar siç duhet kriteri, kur është bërë varrimi në varrezat e dëshmorëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dyta, për sa i përket kërkesës për të bërë varrimin e eshtrave, kjo është një kërkesë normale, të cilën mund ta bëjë kushdo. Pra, nëse një dëshmor e ka fituar statusin, është në një varrezë publike, s'është te varrezat e dëshmorëve, kushdo mund ta bëjë këtë gjë, duke filluar që nga familja, organizata e dëshmorëve, bashkia që e merr përsipër e të tjera.

Ermonela Felaj – Atëherë, jemi dakord me pikën 10, sugjerimin e organizatës së dëshmorëve, që në varrezat e dëshmorëve të varrosen vetëm dëshmorët?

Jemi dakord me pikën 12, që shpenzimet të përballohen nga shteti? Po. Nuk ka kundërshtim.

Me pikën 13, që organizatat e dëshmorëve të kërkojnë varrimin në të njëjtat varreza, jemi dakord? Pra, me pjesën që të m'u ndodhin zhvarrime, por të ketë vetëm rivarrime ose varrime.

Petro Koçi – Është një gjë që mund ta kërkojë kushdo.

Ermonela Felaj – Mirë, dakord, por ata e kanë bërë këtë propozim. Unë s'e kuptoj pse duhet të jemi kështu...

Petro Koçi – Si të jemi?

Ermonela Felaj – Të kemi pak më shumë mbështetje për një gjë që ai e kërkon...

Petro Koçi – Po është normale. Edhe ata studentët mund të kërkojnë ndonjë punë aty sot.

Ermonela Felaj – Nuk ka lidhje me studentët.

Petro Koçi – Një kërkesë të ngjashme. Të bëjnë protestë.

Ermonela Felaj – Edhe studentët të lirë i kemi lënë. Bënë katër kërkesa, bënë tetë.

Petro Koçi – Fjala kërkesë nuk shkon këtu. Kërkesa bëhet për statusin e dëshmorit, ndërsa këto janë propozime nga më të ndryshmet. Se ka raste që familjarët nuk duan t'i zhvarrosin nga varrezat publike dhe t'i çojnë atje. Kjo mund të jetë, por nuk pengon askënd tjetër, që të bëjë një kërkesë të ngjashme. Pra, mund të vihet një nen, i cili mund të jetë më gjithëpërfshirës, nëse duhet, por s' më duket produktiv.

Ermonela Felaj – Në fakt, nuk është se neni i ndalon të tjerët. Ka vetëm një specifikim për organizatën.

Ismail Shehu – Problemi është se, të paktën në aspektin e teknikës legislative, në qoftë se themi se "Organizata e dëshmorëve të atdheut" bën kërkesë për rivarrim, në një farë kuptimi duket sikur kufizohet, sikur vetëm kjo organizatë ka tagrin për të bërë kërkesa për varrim dhe rivarrim të varrezat e dëshmorëve, ndërkohë që kjo është e hapur. Vetë ODA-ja, "Organizata e dëshmorëve të atdheut" ka një nen ku thotë se mund të bëjë çdo lloj kërkesë të ligjshme, t'ia adresojë komisionit qendror ose vendor. Pra, e ka një tagër të tillë. Po e shkruam se edhe organizata bën kërkesë për varrim e rivarrim, në njëfarë kuptimi del sikur kufizon qytetarët, familjarët, shoqërinë civile e të tjera. Del sikur kompetenca ekskluzive është e organizatës. Ne duam ta shmangim këtë gjë.

Ermonela Felaj – A ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët në lidhje me këtë pikë? Nuk ka ndërhyrje për këtë pikë.

Atëherë, dakordësinë e kishim për pikat 10 e 12, ndërkohë që për pikën 13 drejtori juridik i Ministrisë së Mbrojtjes na thotë se është e reflektuar. Do ta shohim në vijim. Në qoftë se e kemi atë fjali, e miratojmë këtu siç është.

Po, zoti Velo.

Gjergj Velo – Problemi është se si mund të gjejmë një mënyrë për ta shprehur. Në Lushnjë, siç dihet, gjatë luftës ka ndodhur një pushkatim masiv. Këtu ka diskutime nga më të ndryshmet, por e vërteta është se ata nuk janë shpallur dëshmorë, dhe të gjithë ata janë vendosur në parcelën e varrezave të dëshmorëve. Çfarë do të bëhet me këta?

Ne kemi një mendim, sipas të cilit mund të largohen, mund të zhvarrosen, por vendin atje nuk e kanë. Do t'ju lutesha shumë, që të gjejmë një mënyrë në lidhje me këtë. Për sa i përket...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht për këtë e kisha fjalën. këtu, por edhe në vende të tjera, mund të gjesh të tillë.

Ermonela Felaj – Zoti Velo, besoj se do të mbeten në minorancë, sepse edhe ministria, edhe ne, edhe Komisioni i Ligjeve, nuk jemi dakord që të fillohet me zhvarrime. Kështu, ky nen do të miratohet sipas diskutimeve që u bënë. Unë i ftoj kolegët t'i votojnë.

Kush është dakord me nenin 13, me diskutimet që u bënë. Po, faleminderit!

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 14, “Ceremonia e varrimit të dëshmorit të atdheut”.

Nuk kam asnjë vërejtje, përveç pjesës gjuhësore që mund të ketë nevojë të shikohet.

Kush është dakord me nenin 14?

Miratohet neni 14.

Kalojmë në nenin 15, “Objektet në nderim të dëshmorëve të atdheut”.

Për pikën e parë të këtij neni, ka një sugjerim nga Komisioni i Ligjeve. Në pikën 3, komisionit përgjegjës i sugjerohet të vlerësojë heqjen e shprehjes “dhe kur bashkëshortja/bashkëshorti i dëshmorit të atdheut martohet përsëri”. Kjo pasi ky parashikim i vendos...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, se bëra unë një ngatërresë!

Komisioni i Ligjeve ka propozuar ndërhyrjen në dy pika, në pikat 1 dhe 2. Në pikën 1, pas fjalëve “dhe ruhen”, sugjerohet të shtohet shprehja “sipas përgjegjësisë përkatëse”, pra “Në shenjë nderimi për dëshmorët e atdheut, në vendim të këshillit të qarkut, këshillit

bashkiak, prefektit ose me urdhër të ministrit, brenda territorit në juridiksionin e tyre, ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen lapidare, pllaka, përkujtimore, përmendore, sipas përgjegjësisë përkatëse si dhe emërtohen mjedise dhe institucione publike”. Kjo është, jo ndonjë vërejtje thelbësore.

Ndërkohë, që për pikën 2, komisioni ka thënë që shprehja “interesa të larta shtetërore” të zëvendësohet me “interes publik”. Kjo është shprehja që ka hyrë rëndom në terminologjinë e ligjit.

Për nenin 15 nuk ka ndërhyrje të tjera, kështu që unë...

(Diskutim pa mikrofon)

Fjala që ka shtuar Komisioni i Ligjeve besoj se zgjidh merakun tuaj, sepse është thënë “sipas përgjegjësisë”. Në qoftë se ti ndërton një lapidar vet, nuk mund t’i paguaj unë shpenzimet e tua.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe po e zhvendose, po ashtu, por, në qoftë se është një lapidar që e ka bërë bashkia, prefekti, ministri, që nëse do të duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj po bëjmë një ligj të ri dhe ndaj kemi dhënë këtë detyrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj, por shpresoj që koha e flagrancave të tilla të ketë kaluar një herë e përgjithmonë, se rasti më epik ishte zhvendosja e 5 heronjve në Shkodër, që i çuan te plehrat e qytetit. Ai ishte një turp i vërtetë!

Shaqir Vukaj – Zhvendosja e 5 heronjve që i çuat te plehrat, siç thoni ju, është bërë me shpenzimet personale të prefektit të Shkodrës, sepse nuk i dilte zot as bashkia dhe as qeveria. Ndaj duhet t’i vënë taksative këto punë, sepse nesër del tjetri dhe thotë: “ Unë nuk kam lekë. Kush do të m’i japë ato?”, kjo duhet të përballohet nga shteti.

Ermonela Felaj - Zoti Braho, që ka qenë relator i këtij ligji, te Komisioni i Ligjeve e ka pasur parasysh këtë ndjesi tuajën kur ka sugjeruar që të vihen fjalët “sipas përgjegjësisë përkatëse”, sepse përgjegjësitë e çdo institucioni vendor nuk përshkruhen në këtë ligj, por në ligjet e tyre organike. Ky ligj lidhet me ligjet e tyre organike dhe i bën ata përgjegjës në këtë rast, e shprehur në këtë mënyrë. Dakord?

Megjithatë, mbarojmë në tërësi dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Miratohet edhe neni 15.

Neni 16 kërkon vetëm një ndërhyrje nga ana gjyqësore, “Kudo ku flitet për data të veçanta, të shkruhen me shkronjë të madhe”. Jemi dakord me nenin 16?

Miratohet.

Neni 17, “Organizimi i ceremonive përkujtimore”. Jeni dakord?

Shaqir Vukaj – Nuk kemi vërejtje, por duam të bëhet një shtesë, “dhe në raste të tjera të veçanta”, sepse mund të ndodhë ndonjë rast i veçantë. Kjo nuk i prish punë ligjit, veçse krijon hapësirën.

Ermonela Felaj - Të mos e zgjerojmë kaq shumë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë organe me karakter politik, e ligji është me natyrë kombëtare.

Miratohet neni 17.

Kalojmë te neni 18 “Familja e dëshmorëve”.

Këtu kishte një vërejtje, ku kuptova që organizata e dëshmorëve dhe Ministria e Mbrojtjes nuk është dakord. Komisioni i Ligjeve ka propozuar që të mos ndërpritet shpërblimi për bashkëshortin apo bashkëshorten e dëshmorit të atdheut kur ai rimartohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komisioni i Ligjeve thotë “të mos ndërpritet”, ndërsa organizata dhe ju, jeni për t’i qëndruar ligjit kështu siç është propozuar, pra “t’i ndërpritet në rast se krijon një marrëdhënie të re martesore”. Unë si relatore jam pro tekstit siç është shkruar ligji, por sidoqoftë, për tolerancë, do të doja t’i dëgjoja kolegët nëse kanë ndonjë mendim kundër, të ngelemi siç është në ligj, apo të marrim parasysh vërejtjen e ligjeve. Pra, t’ia heqim shpërblimin bashkëshortit që martohet, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të gjithë njerëz të traditës! Do t’ia heqim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka mbaruar. Kjo ishte pika e parë, ndërkohë për pikën 5, ku keni përmendur se cilët janë familjarët e bashkëshortit, të cilët do të nderohen dhe ndaj të cilëve do të shprehet mirënjohje, se një kategori e vogël do të jetë për shpërblim, thjesht për të qenë korrekt me gjuhën e ligjit fjalët “njerku” dhe “njerka” bëhen “emti” dhe “emta”.

Ka edhe dy propozime që vijnë nga Organizata e Dëshmorëve, e cila kërkon që shpërblimi të mos u njihet rrethit të ngushtë, ose familjes së ngushtë të dëshmorit të atdheut, ku hyn bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç kur këta kanë mbaruar shkollën, ose 25 vjeç kur vazhdojnë shkollën e lartë, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, pra

gjithmonë do t'i referohemi certifikatës familjare në momentin që ka vdekur dëshmori i atdheut. Ministria është që t'u njihet shpërblimi vetëm rrethit të ngushtë dhe gjithë pjesës tjetër, pastaj ata të nderohen dhe t'u shprehet mirënjohje.

Sugjerimi tjetër është: “Familjarët e dëshmorëve të trajtohen me prioritet në rastet kur ka iniciativa nga qeveria që lidhen me mbrojtjen sociale ose me të drejta të tjera që janë në këtë fushë”.

Unë do të shpreh mendimin tim dhe pastaj do t'ju dëgjoj edhe ju, edhe kolegët. Si relatore e mbështes propozimin siç ka ardhur nga qeveria në këto pika, ndërkohë mbështes edhe propozimin e Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve: “Familjarët e dëshmorëve të atdheut, sikundër përcaktohen në pikën 2, të përfshihen në të gjitha programet e mbrojtjes sociale”, se qeveria ka ndërtuar një pjesë, që nuk ndërtohen thjesht për veteranët, por nisen nga kritere të ndryshme. Kuptohet që do të vijojë të ndërtojë edhe programe të tjera me këtë karakter dhe të ketë vëmendjen te dëshmorët ose më saktë te familjarët e tyre, por unë jam për familjarët që janë në certifikatën familjare të të rënit. Ky është sugjerimi im.

Petro Koçi – Problemi është se ç'do të thotë program social, në qoftë se kjo do të ketë efekte financiare, i bie që i gjithë projektligji të rishikohet.

Ermonela Felaj - Në programet që do të bëjë qeveria, duhet të ketë parasysh këtë kategori. Këto programe ne nuk mund t'i shterojmë, se mund të jenë nga më të ndryshmet, por këta të kenë një zë në kapitull. Ky është detyrimi që u japim.

Petro Koçi – Është çështje definicioni, bie fjala “përkrahje sociale” këto janë të gjitha kritere të përcaktuara me ligj. Ky ligj mbulon vetëm këtë pjesë: “Për shkak të të qenit familjar i ngushtë i dëshmorit të atdheut merr shpërblimin 70 mijë lekë në muaj”, përveç nderimit, etj., etj.

Ligji ka karakter moral, se nuk është për biznes.

Ermonela Felaj – Organizata e Dëshmorëve kërkon: tarifa të lira dhe të reduktuara të energjisë elektrike, dhe ne kemi bërë përkrahje për moshën e tretë, se u paguajmë kompesimin e energjisë elektrike të gjithëve pa përjashtim; përparësi për t'u regjistruar dhe pranuar në institucionet arsimore publike; lirim nga pagesat administrative për shkollim, për kujdesje primare, sekondare, shërbime falas në institucionet shëndetësore publike etj. Përkujdesja shëndetësore përfitohet nga programet që ka Ministria e Shëndetësisë, check up-in, sterilizimin, dializën, heqjen e TVSH-së nga të gjitha vizitat shëndetësore dhe nga ilaçet, domethënë, ne nuk mund t'i numërojmë këto gjëra në ligj. Ndaj mendova që në programet sociale që do të monitorojë qeveria t'u japë vëmendje familjarëve sipas pikës 2 që keni

referuar ju. Ky është mendimi im në qoftë se ne duam të merremi vesh me Organizatën e Dëshmorëve dhe t'i mbështesim ata. Nuk na krijon asnjë efekt financiar, se janë programe që do të ndërtohen në të ardhmen.

Kam afër Milvën, e cila mendoj se me ekspertizën e saj do të na ndihmonte më shumë si mund ta shprehim këtë gjë.

Milva Ekonomi – Në çdo rast që ne fusim një paketë të re të ndihmës sociale, merret në konsideratë statusi i dëshmorit. Kjo është gjëja që kërkohet në paketa dhe nuk është vendi për të qenë këtu.

Ermonela Felaj – E ka ligji?

Milva Ekonomi – Do ta shikojmë këtë.

Ermonela Felaj – Ne këtë po shohim, që sa herë bëhen programe të mbrojtjes sociale, dhe kjo nuk është fjalë e re, se e përdor ministria përkatëse, të kenë parasysh edhe këtë gjë. Nuk e di si mund ta gjejmë një formulim!

Petro Koçi - Kjo është një çështje politike, një qeveri që politikisht e mbështet këtë kategori. E ka vet parasysh, në momentin e caktuar, siç është rasti i deputetes Ekonomi, që është edhe këtu, edhe në komisionin përkatës. Pra është një gjë që funksionon për shkak të natyrës politike. Në qoftë se e shprehim këtu, kam frikë se merr efektin e kostos së ndryshuar financiare dhe mund të na bllokojë procesin. Kemi 3 vjet që merremi me këtë ligj.

Ermonela Felaj – Mund t'ia jap fjalën drejtorit?

Ismail Shehu – Për analogji, edhe me rastin e veteranëve apo të shtresave të tjera në nevojë apo që gëzojnë një përkrahje të veçantë nga shteti, nuk ka parashikim të drejtpërdrejtë të ligjit specifik të tyre, për arsye se këto janë pjesë e programeve sociale dhe parashikohen aty, kur futen kategoritë apo shtresat që kanë nevojë të përfitojnë ulje tarifash etj., aty listohen, pra, nuk bëhet në ligjin specifik. As veteranët nuk janë në ligjin specifik, as dëshmorët dhe as kategoritë e tjera të ngjashme me kategoritë e mëparshme. Pra, këto listohen, por në programe sociale të veçanta dhe jo në ligjet organike të tyre. Edhe te ligji i veteranëve nuk ka ulje tarifash...

Gjergj Velo – Në kategoritë e tjera përfshihen dhe referohen drejtpërdrejtë. Të marrim si shembull Komitetin e Veteranëve: ai ka të shprehura në ligj trajtimet financiare që u bëhen atyre dhe familjes së tyre.

Kategoria e të persekutuarve politikë: në ligj shprehet kujdesi i drejtpërdrejt për atë shtresë.

Ndërsa ne, Organizata e Dëshmorëve, përveç kësaj kërkojmë dy gjëra, që shteti duhet t'i konceptojë: së pari, duhet të merret me të drejtat themelore të njeriut, që është pensioni. Familjes së dëshmorëve nuk duhet t'u japim shpërblim 7 mijë lekë të reja, por duhet t'u japim pension. Pensioni është shkalla më e lartë e vlerësimit që mund t'i bëjmë dëshmorit të rënë.

Ju lutem shumë ta kuptoni këtë çështje, sepse jam konsultuar edhe me juristë, edhe me njerëz, edhe me Haxhi Gjozën, që e keni në atë revistën aty, në këtë drejtim Organizata e Dëshmorëve është katandisur sa nuk ka as 5 lekë të vjetër për të vendosur një kurorë në datën 5 maj, as pushteti lokal dhe as pushteti qendror.

Përveç kësaj, në këto programe, siç e shpjegoi zonja Milva, jam dakord, ata përfitojnë, por ka raste të tilla dhe varet edhe nga individit që nuk e respektojnë këtë kategori. Ndaj, ju lutem shumë, shikojini me dashamirësi të madhe ata që i takojnë kësaj shtrese, sepse kjo shtresë është ajo që nuk ka vuajtur baltrave të Lushnjës apo kromit, por ka dhënë gjakun që nga Vishengradi, në histori e deri në ditët e sotme.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se qëndrimet janë të qarta, më duhet që t'ua përmbledh kolegëve që më pas ta votojmë atë.

Propozimi është: pas pikës 5 të nenit 18 të shtohet një pikë 6, ku të thuhet: “Familjarët e dëshmorëve të atdheut, sipas pikës 2 të këtij neni, përfshihen në programet e mbrojtjes sociale”. Jeni dakord me këtë formulim?

Ky formulim kalon në këtë komision dhe është në mbështetjen tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund ta ndërpres votimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne votuam që t'i ndërpritet! Kështu që do të mbajmë shënim që kishte një votë kundër në këtë rast. Të gjithë të tjerët ishin dakord.

Kush është dakord në tërësi me nenin 18, sipas vërejtjeve dhe diskutimeve që bëmë deri tani?

Shaqir Vukaj - Mund t'i kthehem unë për një moment, ju lutem, se është harruar një kategori, fëmijët e lindur pas vdekjes së dëshmorit. Në nenin 2 thuhet: “Sipas certifikatës së gjendjes familjare në çastin e vdekjes”. Fëmija ka lindur më vonë dhe nuk është i përfshirë.

Ermonela Felaj – Ju lutem, se po e ndërlikojmë historinë me kazuse që i zgjidh praktika gjyqësore. Kodi Civil ka një parim shumë të qartë, “Kur vdes trashëgimlënësi,

trashëgimtarë të tij janë ata që janë në certifikatën e tij të lindjes në momentin e vdekjes”, edhe juristin e kam aty, po ashtu edhe unë jam juriste nga *backgroundi*. Ajo është çështje tjetër të provuari, ka vendim gjykate se si do të njihet ai si trashëgimtar. Ne po flasim për trashëgimtarët. Nuk mund t’i hyjmë tani!

Kalojmë te neni 19, që bën fjalë për simbolet dhe statusin e dëshmorit.

Në fakt, për nenin 19 nuk kam asnjë vërejtje të depozituar. Nuk shoh të ketë reagime për këtë nen.

Miratohet edhe ky nen.

Neni 20, “Organizatave të dëshmorëve të atdheut”.

Kush është dakord me këtë nen kështu siç është propozuar nga qeveria?

Miratohet.

Kalojmë te neni 21, “Organizimi i familjeve të dëshmorëve”, ku thuhet se “Familjet e dëshmorëve mund të organizohen në organizatat e tyre”; “Familja e dëshmorëve të atdheut dhe organizata e tyre kanë të drejtë të kërkojnë nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe qendrore marrjen e masave për mirëmbajtjen e Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut, si dhe çdo kërkesë tjetër të ligjshme në lidhje me dëshmorët”, pra, reflektohet merak juaj kur bëtë pyetjes nëse do të mundeshit të kërkonit varrosjen në Varrezat e Dëshmorëve? Neni 21 ua ka njohur këtë të drejtë bashkë me të drejtën tjetër, që për çdo objekt që përkujton veprën e dëshmorëve, të mund të depozitoni kërkesat tuaja.

Kush është dakord me nenin 21?

Miratohet.

Neni 22 “Marrëdhëniet e organizatave me organet shtetërore”.

Nuk ka asnjë vërejtje për këtë projekt nga asnjë prej propozuesve.

Shaqir Vukaj - Ne kemi kërkuar një nen të veçantë, “Organizata e Dëshmorëve të Atdheut është e pavarur, simbolet, të drejtat ligjore të tyre dhe familjarëve, si dhe në rast nevojë, i përfaqëson ato në organet shtetërore dhe gjyqësore. Ajo gëzon përkrahje sociale dhe materiale nga shteti dhe financohet nga buxheti i shtetit”.

Ermonela Felaj – Dakord, po ky është statusi i organizatës suaj, ndërkohë që ligji nuk ia njeh ekskluzivitetin e mbrojtjes së dëshmorëve vetëm organizatës suaj, me gjithë respektin, por krijon mundësinë që të krijohen edhe organizata të tjera me këtë natyrë. Kjo është thënë, pastaj karakteristikat e tjera që do të ketë organizata, do ta vendosin ata që shprehin vullnetin për të ndërtuar një organizatë të tillë. E thamë që në fillim që nuk mundemi për shkak se ekziston liria civile e të krijuarit të organizatave të ngjashme që ne të

njohim vetëm një organizatë. Nuk mundemi me ligj. Në momentin kur do të jeni vetëm ju, kuptohet që vetëm juve do t'ju referohen. Nëse do të krijohen të tjera në të ardhmen, nuk mund të përjashtohen nga kjo e drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjergj Velo -...Si do të veprojmë ne me këtë Organizatën e Dëshmorëve që nuk ka kujdesin e shtetit?

Ermonela Felaj - Ju e keni të drejtën këtu, si çdo organizatë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjergj Velo -...që organizata kombëtare apo organizatat kombëtare të dëshmorëve të atdheut të të gjitha kohërave, ashtu siç jemi ne, të gëzojnë respektin dhe financim nga shteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku mbështeten? Nuk i ke...

Ermonela Felaj – Më fal!

Organizatat janë jofitimprurëse. Për një pjesë të aktivitetit që kanë, natyrisht që shteti i mbështet edhe financiarisht, sepse gjithë objektet përkujtimore... Në fakt, shteti i mbështet.

Gjergj Velo – Kurorën jo.

Ermonela Felaj - Për varrimin të mbështet.

Megjithatë, na lejoni, sepse kemi edhe pika të tjera të nenit. Në qoftë se do të jetë mundësia ta bëjmë këtë, në rregull, por besoj se nuk është mungesë vullneti dhe dëshire. E gjithë kjo ka një kufi dhe ne nuk mundemi të dalim përtej këtij kufiri.

Kalojmë te neni 23, i cili bën fjalë për ankimin.

Këtu bëhet fjalë për subjektet që kanë të drejtë të ankohen ndaj një vendimi, që refuzon njohjen ose shpalljen e statusit të dëshmorit dhe afatet brenda të cilit bëhet kjo kërkesë.

Ka ndonjë vërejtje për këtë nen, në variantin që e ka sjellë qeveria?

Përpara se ta votojmë, a ka ndonjë mendim për këtë nen?

Ka vetëm një ndërhyrje...

Petro Koçi – Komisioni i Ligjeve...

Ermonela Felaj – Atë do të thosha.

Petro Koçi- ...ka vendosur që ky propozim të ndryshojë dhe ankimimi të mos bëhet në gjykatë, por te Komisioni Qendror i Statusit. Kjo do të çonte automatikisht në një realitet tjetër, sipas të cilit çdo kërkesë që bëhet për të marrë këtë status, automatikisht kalon te

Komisioni Qendror i Statusit. Pra, praktikisht filtri bie, prandaj është vendosur të krijohet një komision vendor, i cili bën një lloj filtrimi paraprak dhe pastaj e sjell propozimin te Komisioni Qendror i Statusit.

Ermonela Felaj – Zoti Koçi, në parashtrimin që bëmë gjatë mbledhjes së parë, ngritëm problemin që në rastet e ankimeve administrative duhet respektuar parimi që shkohet tek organi më i lartë administrativ, ezaurohet rruga administrative dhe pastaj shkohet në gjykatë. Në qoftë se këshillat bashkiakë, këshillat e qarqeve dhe prefekturat, refuzojnë shpalljen ose njohjen e statusit të dëshmorit, unë mendoj se ne duhet t'u japim të drejtën kërkuësve që këtë vendim ta ankimojnë në Komisionin Qendror të Statusit. Në rast se edhe Komisioni Qendror i Statusit refuzon, atëherë të shkojnë në gjykatë.

Petro Koçi – *De facto* kjo do të thotë shqyrtim në themel i propozimit.

Ermonela Felaj- Patjetër, prandaj është Komision Qendror.

Petro Koçi – Pra, e drejta e propozimit nga komisioni ose këshilli i bashkisë i kalon familjarit.

Ermonela Felaj – Nuk mund të ushtrojnë të drejta komisionet vendore, në mënyrë definitive kur ka një Komision Qendror, se i humbisni thelbin dhe kuptimin Komisionit Qendror.

Petro Koçi – Ai e çon në gjykatë. Pra, në rast se është vendim i padrejtë...

Ermonela Felaj – Atëherë, Komisioni Qendror për çfarë është, kur komisionet vendore qenkan me të njëjtën fuqi?!

Petro Koçi – Komisioni Qendror shqyrton propozimet që vijnë për shpalljen e statusit të dëshmorit dhe kthehet nga një gjë serioze në një gjë joserioze.

Ermonela Felaj - Dakord, ju dëgjova.

Komisioni i Ligjeve, që ka më shumë juristë në përbërje të tij, ka propozuar pikërisht këtë që ju referova.

Unë si relatore do të sugjeroja t'i qëndronim propozimit të Komisionit të Ligjeve, edhe për faktin që në këtë komision ne e thamë këtë gjë.

Kush është dakord me nenin 3, sipas propozimit të Komisionit të Ligjeve?

Faleminderit!

Miratohet neni 23, sipas propozimeve të Komisionit të Ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Për numërtimet dhe vendosjen e shkronjave në mënyrë korrekte, do t'i lutesha stafit të komisionit të kujdeset, që në çdo rast që nuk i kemi përmendur, pavarësisht kësaj, ata t'i reflektojnë në zbardhjen përfundimtare të dokumentit.

Kalojmë në dispozitën e fundit dhe kalimtare, për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Duhet t'u referoj kolegëve që nga Komisioni i Ligjeve ka ardhur një sugjerim, sepse koha e nxjerrjes së akteve nënligjore është e gjatë (një vit) dhe komisioni propozon që koha të bëhet 6 muaj.

Unë kam një propozim më të fortë: koha të jetë 3 muaj, sepse kjo nuk është një punë e panjohur. Ka kaq vite që dihet se cili është dokumentacioni që duhet të përcillet për t'u njohur statusin e dëshmorit. Pra, nuk është një gjë që do të fillojë nga a-ja, por është një punë e njohur dhe e bërë deri më sot, që me ligjin duhet të përmirësohet, me qëllim që askujt të mos i mohohet e drejta për t'u shpallur ose njohur si dëshmor i atdheut. Kështu që propozoj që koha të jetë tre muaj.

Për pikën e fundit, ku ju thoni se aktet nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen deri sa të dalin aktet e reja nënligjore, sugjeroj që kjo pikë të mos jetë, sepse ju ligjin po e shfuqizoni dhe kur shfuqizohet ligji, kanë rënë të gjitha, edhe aktet nënligjore, teorikisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që ta korrigjojmë këtë dhe të mos ketë vakuum ligjor, hyrjen në fuqi të mos e bëjmë 15 ditë, se nuk ka asnjë kuptim të nxitojmë kaq shumë, por ta bëjmë 3 muaj dhe deri kur ligji të hyjë në fuqi, ju i keni përgatitur aktet nënligjore dhe të gjitha strukturat.

Nuk ka arsye të hyjë në fuqi për 15 ditë, kur ti vetë propozon një vit që ta bësh ligjin efektiv dhe do të vazhdosh me aktet e vjetar. Një vit është kohë shumë e gjatë për të ndërmarrë akte nënligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë rëndësie ka?! Atë e dini ju. Ju keni propozuar një vit. Komisioni i Ligjeve thotë se një vit është shumë. Për ne është shumë edhe 6 muaj, 3 muaj duket më optimale. E kemi bërë këtë diskutim shumë herë në komisionet parlamentare.

Petro Koçi– Them për hyrjen në fuqi të ligjit.

Ermonela Felaj- Qeveria nuk duhet të marrë kaq kohë për të përgatitur aktet nënligjore, sepse duhet ta ketë të qartë që në momentin kur propozon ligjin se cila do të jetë përmbajtja e tij. Kur ne i lëmë shumë të gjata kohët e nxjerrjes së akteve nënligjore, ato e dështojnë zbatimin e ligjit.

Ne jemi që të bëhet 3 muaj, me arsyetimin që puna njihet, akët i keni dhe thjesht duhet t'i riadaptoni aty ku ka nevojë.

Petro Koçi – Këtu është fjala për hyrjen në fuqi të ligjit, se ju thatë...

Ermonela Felaj – Për hyrjen në fuqi... E bëra këtë, sepse nuk ka sens ta shfuqizosh ligjin tani dhe të thuash se do të veprosh me aktet nënligjore për një vit. Po u shfuqizua ligji, shfuqizohen edhe aktet në bazë të të cilit nxirren. Prandaj...

Petro Koçi – Bëhet fjalë për aktet nënligjore që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj. Unë ju përmenda rastin e kriterëve të shpalljes “Dëshmor i atdheut”. Pra, duke hyrë në fuqi ligji 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, automatikisht Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut zbaton këto kritere dhe nuk ka nevojë për këto aktet nënligjore. Fjala është për fashën e kriterëve që duhet të respektohet, sepse ka shumë raste kur me ligjin e fuqi nuk shpallen dot dëshmorë, por me ligjin e ri shpallen, pavarësisht akteve nënligjore që nuk kanë dalë akoma.

Ismail Shehu – Kam një koment. Nëse ne e shfuqizojmë ligjin menjëherë dhe lëmë 3 muaj kohë, që në thelb është një vakuum, pa vendime qeverie, i bie që për 3 muaj asnjë familje dëshmorit të mos marrë shpërblimin financiar që i takon, sepse e quajmë sikur ka rënë vendimi që përcakton kriteret dhe masat e shpërblimit. Po thamë se bie bashkë me aktet nënligjore, ata do të ngelen pa u paguar 3 muaj. Prandaj është bërë dispozita e tillë, që për sa kohë aktet nënligjore nuk bien në kundërshtim me ligjin e ri që do të miratojmë, le të zbatohen deri sa të dalin të rejtat. I bie të rrezojmë te kriteret edhe masën e pagesës.

Ermonela Felaj - Më duket se nuk po kuptohemi. Pikërisht, për të evituar këtë, unë thashë që ligji të hyjë në fuqi mbas 3 muajve. Ti ndërkohë je me ligjin e vjetër dhe përgatit të gjitha aktet nënligjore dhe në krye të 3 muajve hyn me ligjin dhe aktet nënligjore dhe nuk krijon asnjë pengesë.

Nëse ju nuk merrni përsipër ta bëni këtë gjë, dakord, na thoni se nuk e bëjmë dot për 3 muaj. Ne jemi këtu për t'ju dhënë edhe detyrime, jo vetëm për t'ju thënë: po, mirë e keni.

Spartak Braho – Unë mund të flisja edhe më mbrapa për të shpjeguar votën kundër, por po flas tani. Duke qenë në shqyrtim në Komisionin e Ligjeve, isha unë që propozova që nga 1 vit të bëhej 6 muaj. Kështu që nuk mund të votoj për 3 muaj.

Ermonela Felaj - Spartak, aktet nënligjore dhe hyrjen në fuqi, mundemi t'i sitemojmë në këtë mënyrë?

Spartak Braho –Do të hapim një praktikë që nuk është normale.

Ermonela Felaj - 6 muaj apo 3 muaj, kolegë?

(Diskutime pa mikrofon)

Nga fjalët tuaja unë kuptoj se 3 muaj janë mjaftueshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

I kemi aktet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, që të mos e bëjmë si loja e kungulleshës 3 apo 6...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjergj Velo- ...Ne kemi 1 vit pa u mbledhur...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem shumë, a ka afat kjo ...? Mirë që shumë gjëra nuk po na merren parasysht, por të mos... Ju lutem, gjykojeni këtë!

Ermonela Felaj - Ju jeni për 3 muaj?

Gjergj Velo – Për tre muaj dhe më shpejt madje.

Ermonela Felaj- Më shpejt se 3 muaj...

Do t'ju mbështesim që të jetë për 3 muaj.

Kush është dakord? 3 muaj.

Neni i fundit është hyrja në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare, që është rregull i zakonshëm. Besoj se jemi dakord me këtë.

Përpara se ta miratojmë në tërësi, na kaloi te neni 7 një propozim që ne i thamë Organizatës së Dëshmorëve se do ta reflektonim. Ka të bëjë me përjashtimin nga statusi i dëshmorit të atdheut të personave (unë jam munduar ta riformuloj propozimin tuaj) për të cilët vërtetohet gjyqësisht se vendimi për njohjen e statusit është bazuar në dokumente të falsifikuara. Pra, si relatore jam dakord që në rast se provohet gjyqësisht që statusi është përfituar mbi bazën e dokumenteve false, atëherë personi të përjashtohet nga shpallja ose njohja si dëshmor i atdheut.

Petro Koçi – Ka raste kur për shkak të kontesteve, që ndonjëherë janë edhe krahinore, është bërë animimi gjyqësor, është vërtetuar falsifikimi i dokumenteve dhe i është hequr automatikisht po nga gjykata statusi i dëshmorit.

Ermonela Felaj – Atëherë është me vend që kjo pikë të vihet.

Jeni dakord ta reflektojmë edhe këtë moment? Dakord.

Duke besuar se jemi treguar të kujdesshëm...

Shaqir Vukaj – Më fal!

Ne kemi bërë edhe një propozim për ngritjen e një instituti shtetëror, sepse në Shqipëri shteti nuk merret me problemet e dëshmorëve. Kur them shteti, kam parasysh një institucion të mirëfilltë, në ndryshim me shumë vende të tjera të Europës të paktën. Kush merret me këto probleme? Ne jemi thjesht dashamirës të kësaj çështjeje, por kush merret zyrtarisht?

Ermonela Felaj – Zoti Vukaj, t’jua jap një përgjigje për këtë?

Shaqir Vukaj – Po.

Ermonela Felaj – Nuk është një moment që ne nuk e menduam dhe nuk u përpoqëm ta diskutojmë edhe me kolegët e grupit tonë parlamentar. Të them të drejtën, deri më sot, edhe për shkak se duhet bërë me ligj të veçantë, nëse do të bëhet, e kemi pasur të vështirë. Edhe ju vetë nuk keni sjellë një formulim konkret se si mund ta adaptonim në këtë ligj.

24 orë para seancës plenare ne kemi të drejtë të bëjmë amendamente. Ju jap fjalën që do të bëjmë një amendament për këtë, që t’ia çojmë seancës plenare. Ndërkohë, ligjin do ta miratojmë kështu siç është. Amendamentin do ta çojmë në seancë, sepse duam të gjejmë një gjuhë të përbashkët me kolegët, si dhe të jetë në përputhje me tekstin që po miratojmë.

Ju lutem, kalojmë në votimin në tërësi të këtij projektligji!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjergj Velo -... Kur Gjykata Kushtetuese na anuluar vendimin për shpërblimin, thoshte se nuk është pension që ka të bëjë me të drejtat themelore të njeriut dhe ne e filluam tani. Duam një pension për familjen e dëshmorëve.

Ermonela Felaj – Ishte shpërblimi financiar.

Gjergj Velo – Ndryshon shpërblimi nga e drejta e pensionit. Ne duam që aty të shënohet “e drejta e pensionit” dhe të shpallet me ligj.

Ermonela Felaj – Aty ku flitej për shpërblimin financiar, për familjen e ngushtë të dëshmorëve, thuhej se kriteret do të përcaktohen me aktin nënligjor që do të nxjerrë ministri përkatës, pra ministri i Mbrojtjes. Në atë rast, ju dhe ne, edhe për shkakun që e vendosëm në ligj se do të raportohet përpara këtij komisioni, do të jemi të vëmendshëm në formulimin e atij akti. Po të futemi këtu dhe të merremi me koncepte, si: shpërblim, pension, që nuk janë koncepte të këtij ligji, sepse janë koncepte me natyrë tjetër, natyrisht që do të dalim nga konteksti i ligjit. Është një moment që ne duhet ta reflektojmë.

Kalojmë te votimi në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për statusin e dëshmorit të atdheut”?

Kolegë, zoti Qefalia... Patjetër që jeni dakord me këtë ligj.

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit për durimin, prezencën dhe angazhimin tuaj gjatë këtyre ditëve!

Petro Koçi – Edhe unë ju falënderoj në emër të qeverisë, që pothuajse konsensualisht e kaluat këtë projektligj. Çështja e dëshmoreve të atdheut, është një çështje shumë e rëndësishme, sidomos të atyre që kanë rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore, pra gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe ka një sërë përcaktimesh, që lidhen me statusin e familjarëve, me organizatat e dëshmorëve, me detyrimet e organeve qendrore dhe vendore, në respekt të nderimit të dëshmorëve të atdheut, që janë risi absolute në krahasim me ligjin që është në fuqi deri tani.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Koçi!

Ju urojmë një ditë të mbarë, juve dhe përfaqësuesve të organizatës së dëshmorëve!

Komisioni i Sigurisë është i lutur të qëndrojë.

Do të bëjmë disa minuta pushim dhe në orën 12:45 do të fillojmë me ligjin që sjell ndryshime në Policinë e Shtetit.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.12.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Paulin Sterkaj, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Elona Hoxha, Spartak Braho, Xhemal Qefalia, Milva Ekonomi.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj

Të ftuar:

Sandër Lleshaj – Ministër i Brendshëm

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Ismail Shehu – Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore

Ardit Hysa – Këshilltar i Ministrit të Brendshëm

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës së mbledhjes së sotme, në të cilën kemi parashikuar shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Për të prezantuar këtë projektligj kemi të ftuar ministrin e Brendshëm zotin Sandër Lleshaj.

Faleminderit, zoti Lleshaj, dhe mirë se keni ardhur në Komisionin e Sigurisë! Është hera e parë që ju vini këtë komision, kështu që më lejoni që në emrin tim personal dhe të gjithë kolegëve të këtij komisioni t’ju uroj punë të mbarë dhe suksese!

Të ftuar, gjithashtu, kemi zonjën Rovenë Voda, zëvendësministre e Brendshme! Faleminderit, zonja Voda! Kemi të ftuar edhe zotin Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, si dhe zotin Ardit Hysa, këshilltar i ministrit të Brendshëm.

Faleminderit! Siç është bërë e njohur për të gjithë kolegët, Ministria e Brendshme ka propozuar disa ndryshime në ligjin për Policinë e Shtetit.

Për të prezantuar ndryshimet në këtë ligj, do t’ia kaloj fjalën ministrit të Brendshëm, zotit Lleshaj.

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari gjej rastin t’ju falënderoj për urimet që bëtë tani, qoftë edhe për përkrahjen që keni dhënë për emërimin tim në funksionin e ministrit të Brendshëm, të cilin besoj se do ta justifikoj me punën e angazhimin tim në të gjitha strukturat që drejtoj.

Sigurisht, sidomos në vitin e ardhshëm përpara Ministrisë së Brendshme shtrohen sfida dhe detyra shumë të mëdha, që lidhen me dy sektorë të rëndësishëm: I pari, me luftën kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimit në ekonomi në veçanti; së dyti, në përmbushjen e një axhende shumë intensive detyrash dhe përgjegjësish në kuadër të hapjes së negociatave që priten në vitin e ardhshëm. Ky proces e ngarkon Ministrinë e Brendshme me një barrë jashtëzakonisht të madhe përgjegjësish, të cilat duhen kryer në përmbushje të kërkesave që parashtrihen në kapitullin 24.

Megjithatë, në këtë prezantim sot do të fokusohem vetëm në një çështje, që ka të bëjë me disa ndryshime të vogla në ligjin për Policinë e Shtetit, prej të cilave ne shpresojmë disa ndryshime të rëndësishme në performancën dhe efektivitetin e punës së strukturave të Policisë së Shtetit.

Së pari, duhet të ndalemi në çështjen përse bëhet ndryshimi. Arsyeja e parë ka të bëjë me mosfunksionimin e Akademisë së Sigurisë ose Akademisë së Policisë për një periudhë shumë të gjatë.

Të gjithë jemi në dijeni se Akademia e Sigurisë u hap në vitin 2015 pas një periudhe 10-vjeçare të mosfunksionimit. Si pasojë e kësaj, Policisë së Shtetit i mungojnë sot një numër i konsiderueshëm oficerësh, kryesisht në nivelin “Nënkomisar”, që nënkupton nivelin bazë të oficerëve të Policisë së Shtetit, por edhe në të gjithë hierarkinë e gradave të kësaj organizate.

Thjesht për të dhënë disa shifra, në nivelin e drejtuesit të lartë janë mangët 46% e gradave; në nivelin drejtues janë mangët 30% e gradave, në nivelin “Kryekomisar” janë mangët 36%; në nivelin “Komisar” janë mangët 38%, në nivelin “Nënkomisar” janë mangët 28%. Pra, ju e shihni që në të gjitha kategoritë e gradave ka një mangësi, e cila shkon te një mesatare rreth 30%, pra kjo gjë paraqet një problem shumë serioz.

Për t’u fokusuar vetëm te niveli bazë, te nënkomisarët: nga 1482 nënkomisarë që duhet të ketë Policia e Shtetit sot, ajo ka vetëm 1167 ose 25% më pak. Gjatë vizitave të mia në drejtoritë vendore të policisë në qarqet e vendit kam konstatuar se mungesa e nënkomisarëve, pra mungesa e vijës së parë të ballafaqimit me problematikën dhe me publikun, përbën shqetësimin e përbashkët numër një, i cili pengon seriozisht plotësimin e misionit të strukturave të Policisë së Shtetit.

Nëse do të ndiqen procedurat aktuale, do të duhen të paktën katër vjet që të mund të fillojnë të plotësohen boshllëqet e sistemit. Pra, do të duhet që të përzgjidhen kandidatë të rinj për Akademinë e Sigurisë, të cilët, pasi të kalojnë me sukses programin e arsimimit, të emërohen si nënkomisarë në Policinë e Shtetit. Por katër vjet pritje, me një mangësi të ndjeshme në nivelin bazë të strukturës, janë jashtëzakonisht shumë.

Nevoja për një intensitet të shtuar në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe në veçanti kundër atij të organizuar kërkon kapacitete të plota të Policisë së Shtetit.

Nga ana tjetër, ne kemi një strukturë dhe një forcë policore të vogël, ndër më të voglat, krahasuar me vendet e rajonit dhe të Europës. Shqipëria është një vend që ka shumë probleme, por dhe pak policë. Sipas të dhënave të Eurostatit, Shqipëria ka vetëm 334 policë për 100 mijë banorë.

Ndërkohë, po jap disa shifra: Kroacia ka 489 policë për 100 mijë banorë, Serbia ka 596; Mali i Zi 645; Sllovakia 409 e të tjera me radhë. Janë shumë shifra, por duhet të them që jemi një ndër vendet me numrin më të vogël të policëve për frymë të popullsisë, ndërkohë që kemi një numër relativisht të lartë të problemeve për frymë të popullsisë.

Në të vërtetë vendit tonë i duhen më shumë punonjës policie nga sa mundëson struktura aktuale, por paradoksisht ne kemi mangësi edhe në vetë strukturën minimaliste të Policisë së Shtetit, të cilat synohen të vihen në rrugën e zgjidhjes me miratimin e ndryshimeve që ju propozojmë sot në këtë projektligj, i cili është në vëmendjen tuaj.

Çfarë parashikojnë ndryshimet e propozuara?! Janë katër gjëra themelore që propozohen.

Së pari, plotësimin e boshllëqeve ekzistuese në nivelin bazë të piramidës së gradave të Policisë së Shtetit, pra në nivelin “Nënkomisar”.

Së dyti, pasurimin e nivelit të ekspertizës së Policisë së Shtetit me specialitete të munguara, të cilat Akademia e Sigurisë nuk i prodhon.

Së treti, specializimin e kategorive të policisë, pra të Policisë Kriminale, të Policisë së Rendit, të Policisë së Kufirit dhe të Emigracionit.

Një element i fundit është edhe hapja e një mundësie për pranimin e disa specialiteteve të veçanta nga ushtarakët në radhët e policisë. Gjithnjë bëhet fjalë për specialitete, të cilat Policia e Shtetit, me kapacitetet e saj nuk i krijon dot.

Lidhur me plotësimin e boshllëqeve të shumta në nivelin “Nënkomisar”, policia e ka nevojë urgjente një prurje të rëndësishme, me qëllim që të mbushë boshllëqet e shumta në nivelin e strukturës së gradave të saj. Për këtë qëllim në projektligj është parashikuar: “Për nevoja të Policisë së Shtetit pranohen në Akademinë e Sigurisë shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni (që janë kriteret e përgjithshme për t’u pranuar në Policinë e Shtetit). Kandidati që përfundon me sukses kualifikimin përkatës pranohet në Policinë e Shtetit dhe i jepet grada policore ‘Nënkomisar’.”

Me këtë ndryshim hapet një mundësi e re që Policia e Shtetit të mund të përthithë në radhët e saj studentë që janë diplomuar në universitete, të cilët, pas një periudhe të formimit bazë policor në Akademinë e Sigurisë, do të integrohen në strukturat e saj me gradën “Nënkomisar”.

Në këtë mënyrë do të jemi në gjendje që jo vetëm të plotësojmë boshllëqet kritike në nivelin e nënkomisarëve, por, në të njëjtën kohë, do të mund të pasurojmë në mënyrë të ndjeshme kapacitetet e Policisë së Shtetit me specialitete të munguara, por të nevojshme në mënyrë urgjente nga fusha e ekonomisë, e financave, e informatikës, e elektronikës dhe e jurisprudencës.

Hapja e kësaj rruge do të mundësojë që procesi i gradimeve në Policinë e Shtetit të mund të futet në shina normaliteti, pasi rreth 30% e posteve në Policinë e Shtetit janë të zëna me një gradë më të ulët nga ajo që kërkohet nga funksioni organik. Pra, 1/3 e oficerëve të policisë kryejnë një detyrë më të lartë se grada që mbajnë dhe mosgradimi është i kushtëzuar pikërisht nga këto probleme që janë akumuluar ndër vite. Nëse sot do të kishim filluar t'i zhvillonim proceset e gradimit, ashtu siç kërkon ligji, pra duke i dhënë mundësinë secilit të marrë gradë më të lartë, do të ndodhte që një lëvizje nga lart, sepse shumë kanë arritur në një nivel për të marrë gradën tjetër, kjo do të çonte në një zbrapsje pothuajse të pariparueshme të nivelit bazë, të nënkomisarëve.

Çështja e dytë është pasurimi i ekspertizës së policisë me specialitete të munguara.

Hapja e dyerve të Akademisë së Sigurisë për disa kategori të përzgjedhura të të diplomuarve në universitetet e vendit dhe të botës do të krijojë kushte për një cilësi të re të trupës së oficerëve të kësaj policie dhe do të ndikojë në mënyrë të ndjeshme, sidomos në fushat deficitare, si lufta kundër krimit ekonomik e financiar, lufta kundër krimit kibernetik, modernizimi i Policisë së Shtetit etj. Pikërisht në këto fusha janë edhe problemet kryesore sot. Aktualisht, në fushën e krimit ekonomik dhe financiar, të pastrimit të parave, krimit kibernetik etj., niveli i ekspertizës lë shumë për të dëshiruar.

Me miratimin e ndryshimeve të propozuara, situata në këta sektorë shumë të rëndësishëm të luftës kundër krimit do të njohë një nivel të ri profesionalizmi dhe një intensitet të ri.

Së treti, do të ketë specializim të kategorive të Policisë Kriminale, të Rendit dhe Kufirit.

Në projektin, që ju propozohet për shqyrtim, është parashikuar një nen, i cili përcakton se Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor. Ajo organizohet mbi bazë shërbimi, e profilizuar në Policinë Kriminale, në Policinë për Sigurinë Publike dhe Policinë për Kufirin dhe Migracionin.

Kategoritë e profilizuara të Policisë së Shtetit dallojnë midis tyre nga arsimimi, kualifikimi, simbolet, detyrat dhe përgjegjësitë që ushtrojnë.

Të nderuar deputetë,

Policia jonë trashëgon një problem të rëndësishëm që ka të bëjë me profilizimin e saj. Ndërmjet Policisë Kriminale, asaj të Rendit apo Kufirit sot ka ndryshime shumë të vogla për sa i përket arsimimit, kualifikimit apo karrierës.

Të gjitha kategoritë e punonjësve të policisë marrin sot të njëjtin arsimim dhe gjatë jetës profesionale kanë mundësi shumë të reduktuara për të marrë kualifikim dhe specializim sipas natyrës së veçantë të shërbimit që kryejnë.

Për shkak të profilit shumë të ngjashëm profesional, gjatë zhvillimit të karrierës punonjësit e policisë lëvizin rëndom nga njëra kategori në tjetrën. Një punonjës i rendit mund të kalojë në fushën kriminale, ai i kriminaleve të kufiri, të qarkullimi rrugor etj. Këto transferime kanë krijuar rrezikun e humbjes së qëndrueshmërisë, të humbjes së ekspertizës, të humbjes së specializimit dhe të humbjes së kujtesës institucionale.

Me ndryshimin e propozuar synohet që të tria kategoritë e Policisë së Shtetit të kthehen në institucione të mirëfillta, që do të thotë se, përveç arsimimit të përgjithshëm, punonjësit e Policisë së Shtetit do të marrin edhe arsimim special sipas fushës, do të diplomohen sipas fushës dhe do të bëjnë karrierë brenda fushës.

Kështu, një oficer i diplomuar në fushën e policisë kriminale do ta zhvillojë pjesën më të madhe të karrierës së tij, pas diplomimit si i tillë, brenda kësaj fushe dhe vetëm pas një arsimimi tjetër në një periudhë të vonshme të karrierës, arsimimi në fushën e menaxhimit policor, do të mund të shërbejë në funksionet e larta të drejtimit, të cilat do të jenë të përgjithshme dhe jo të lidhura domosdoshmërisht me kategorinë apo fushën speciale policore.

Një çështje tjetër është ajo që ka të bëjë me hapjen e mundësie për pranim nga radhët e ushtarakëve në Policinë e Shtetit. Është parashikuar një nen, si më poshtë: “Për plotësimin e nevojave të veçanta mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 (që janë kriteret e përgjithshme për pranim në Policinë e Shtetit)”.

Për ushtarakët e shërbimit aktiv pranimi realizohet mbi bazën e një marrëveshjeje dypalëshe midis ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Brendshëm, ku përcaktohen kuotat dhe strukturat nga ku do të pranohen ushtarakët. Në çdo rast pranimi bëhet me vullnetin e lirë të ushtarakëve, pas nxjerrjes së tyre në lirim nga Forcat e Armatosura, pra pas shndërrimit të tyre në civilë.

Sipas përcaktimeve përkatëse të ligjit, pranimet do të realizohen në bazë konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm. Kalimi nga strukturat e Forcave të Armatosura në Policinë e Shtetit do të bëhet duke njohur vjetërsinë e tyre të shërbimit në këtë forcë.

Një çështje tjetër ka të bëjë me faktin që, krahas njohjes së vjetërsisë së shërbimit, do të njihet edhe grada, e cila do të ekuivalentohet me një gradë korresponduese policore me

vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, Këshilli i Ministrave do të bëjë një ekuivalentim. Pra, nëse një nëntoger i ushtrisë do të vijë dhe të bëhet nënkomisar i policisë, ky ekuivalentim do të bëhet nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave.

Qëllimi i kësaj dispozite lidhet me nevojën e përhershme që Policia e Shtetit ka për specialitete të veçanta, të cilat nuk mund të përgatiten as nga universitetet e vendit dhe as nga Akademia e Policisë. Specialitete të tilla, të rralla, si ato të fushave kanë të bëjnë me lëndët plasëse dhe eksplozive, me lëndët kimike, me operacionet speciale, etj., mund të ofrohen vetëm nga pjesëtarë të Forcave të Armatosura qofshin aktiv apo në rezervë, për arsye se vetëm Forcat e Armatosura i prodhojnë këto kategori profesionale, për cilat Policia e Shtetit ka nevojë.

Hapja e kësaj mundësie, në të vërtetë do të thosha rihapja e kësaj mundësie, e cila ka ekzistuar historikisht për Policinë e Shtetit, krijon kushtet që të krijohet një kapacitet shumë i çmuar, ndonëse shumë i limituar në numra, ekspertizë nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilët kanë krijuar një nivel shumë të lartë në këto fusha, që çmohet gjerësisht edhe në kuadër të operacioneve që ata kryejnë në NATO apo në BE.

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që ligji ka edhe disa përmirësime të karakterit teknik ligjor, në të cilat nuk besoj se ka nevojë të ndalem. Duke përfunduar, ju falënderojë për vëmendjen dhe kërkoj mbështetjen tuaj për këto ndryshime, të cilat, ndonëse janë shumë të vogla, shpresoj të sjellin impakt të shpejtë dhe të rëndësishëm për funksionimin e strukturave të Policisë së Shtetit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër i Brendshëm, për prezantimin tuaj!

Relator për propozimet e bëra në ligjin e Policisë së Shtetit është zoti Pjerin Ndreu dhe, sipas Rregullores, do t'ia kaloj fjalën.

Pjerin Ndreu – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër, për ekspozitën që bëtë për ndryshimet!

Së pari, vlerësoj se ndryshimet në Policinë e Shtetit, vetë ligji kur është bërë, por edhe ndryshimet që janë bërë disa herë, janë çështje sensitive që kanë shkaktuar debat, kundërshti, mosmarrëveshje dhe dakordësi për shumë gjëra. Në fakt, është e ligjshme, sepse kemi të bëjmë me një ndër institucionet më të rëndësishme të sigurisë kombëtare, me ato institucione, të cilat nga ana vizive janë më të dukshmet, më të lexueshme dhe janë në fokus të opinionit publik lidhur me atë që bëjnë gjatë ditës dhe kanë të bëjnë me një nga çështjet, që realisht kanë sensibilitet të madh, që lidhet me kriminalitetin, me ruajtjen e jetës së personit

dhe ruajtjen e pasurisë. Për shkak edhe të zhvillimeve të shumta politike që kanë ndodhur nga tranzicioni i vitit 1992, Policia e Shtetit ka kaluar në turbulenca të jashtëzakonshme, ku politika ka eksperimentuar keq me Policinë e Shtetit. Fatkeqësisht, në Policinë e Shtetit eksperimentet kanë shkuar deri te kaldajistët dhe zooteknikët, që janë profesione të nderuara në fushën e tyre, por jo në Policinë e Shtetit. Duke filluar nga profesioni i muratorit, të gjithë kanë eksperimentuar në role, si: drejtues, drejtor qarku dhe deri te roli bazë. Nuk ka shembull të një institucioni në Shqipëri që ka kaluar në një tip të tillë keqtrajtimi, pa e banalizuar, duke e bërë si parcelë eksperimentale, ku është bërë gjithçka me policinë.

Në fakt, unë si oficer policie prej 12 vjetësh e kam ndjerë peshën e një farë divergjence që kanë pasur oficerët e karrierës së Policisë së Shtetit të kualifikuar në Akademinë e Rendit Publik, dikur një akademi 4-vjeçare, që në bazë të saj kishte fakultetin juridik dhe mbi fakultetin juridik kishte të gjitha profilizimet që lidheshin me policinë kriminale dhe policinë e rendit. Ka pasur edhe një shkollë, ose një kurs që vinte vitin e fundit nga forcat e ushtrisë, i cili kishte të bënte me kufirin dhe vitin e fundit profilizohej në Akademinë e Rendit. Ka pasur edhe funksione që ishin në Akademinë e Mbrojtjes, por për llogari të Akademisë së Rendit. Sipas mendimit tim, kjo ishte zgjidhja më ideale në një arsim. Të gjithë ata që u profilizuan në këtë sistem ishin më të mirë. Pastaj akademia kaloi në një eksperiment të çuditshëm dhe duhet ta marrim ne medaljen, forca jonë politike, që diku rreth viteve 2004-2005 u mor modeli emergjent i Kosovës dhe u implementua në Shqipëri, i cili nuk përkonte me realitetin shqiptar, pra ishin dy zhvillime komplet të kundërta. Çfarë ndodhi?! Duke hyrë të gjithë në sistemin e gradës, në atë kohë kishte gradë edhe shoferi i prapavijës. Ai hyri në sistemin e konkurrimit dhe sot disa ish-shoferë, punonjës prapavije, janë shefa sektorësh dhe drejtues. Kjo e banalizoi edhe më keq sistemin e karrierës në polici. Unë jam dakord që policia ka nevojë të hapet për disa profesione të tjera. Ky projekt ka qenë që në vitin 1992, ku me një kurs 9-mujor ekonomistë dhe inxhinierë mekanikë janë specializuar për krimin ekonomiko-financiar. Meqenëse është një çështje shumë e diskutueshme, e cila ka lidhje me pastrimin e parave dhe me asetet e ndryshme të krimit, që normalisht realizohen në ekonominë kombëtare, jam dakord që të hapet për profesione dhe për njerëz me integritet, të cilët duhet të kontrollohen duke vendosur disa rregulla rekrutimi. Ata mund të vijnë nga fusha të ndryshme, por edhe nga forcat e ushtrisë. Nuk ka asgjë të keqe që ne të jemi të hapur për këtë problem dhe për këtë ne nuk kemi sensibilitet negativ, sepse është interpretuar sikur ne kemi sensibilitet negativ.

Lidhur me problemin se sa janë nevojat e policisë për disa funksione të ndryshme, duhet një studim. Nëse nevojiten nënkomisarë, që do të vijnë në policinë kriminale, cili është kontingjenti që do të marrim? Nëse ka nënkomisarë, që do të vijnë për policinë e rendit, cili është kontingjenti që do të marrim, duke shkuar edhe në logjikë të asaj që thoni ju, zoti Ministër, të profilizimit të policisë? Nëse do të profilizojmë edhe ata që do të rekrutohen, ata duhet të merren sipas sistemit të profilizimit dhe të kalojnë në një kurs në akademi dhe të kuptojnë policinë, sepse, pavarësisht se ti mund të punosh në qarkullimin rrugor apo në kufi, duhet të kesh njohuri për luftën kundër krimit dhe për mënyrën sesi zhvillohet atje. Nëse flasim për trafike, ato kanë natyrë ndërkombëtare dhe realizohen në kufi. Forcat e kufirit janë barriera e parë për trafiket, ndaj mosnjohja dhe mosrakordimi i tyre me forcat e tjera të policisë kriminale sjell pasoja. Po kështu është edhe për Policinë e Qarkullimit Rrugor, për të gjithë sektorët dhe për forcat speciale. Shpeshherë, në situata destabilizuese ne detyrohemi të fusim forcat speciale në rikuperimin e rendit, të cilët në fokus duhet të kenë elementët kriminelë, mënyrën sesi ata veprojnë dhe sesi neutralizojnë. Ka disa forma bashkëpunimi me Policinë Kriminale, me Policinë e Rendit dhe me Policinë e Qarkullimit Rrugor. Pra, ka disa elementë që duhet të zhvillohen edhe tek ata që vijnë, edhe te forcat speciale, sepse është e kuptueshme që në thelb Policia e Shtetit ka luftën kundër krimit dhe për këtë luftë bashkohen të gjitha forcat, sektorët, drejtoritë, strukturat e policisë dhe sektorët ndihmës, që janë në funksion të saj.

Të kalojmë te ndryshimet. Evidentoj se në nenin 40 nuk ka pasur pengesë që të hyjnë nga profesione të tjera, aty thuhet qartë se për funksione të veçanta mund të vijnë. Unë jam dakord që ta ngremë stekën dhe, nëse e kishim me 1%, ta bëjmë 3 %. Për shkak të nevojave që ka Ministria e Brendshme duhet të futen të gjitha funksionet që mungojnë, por duke i marrë sipas profilizimit për në Akademi. Akademia duhet të mendojë për profilizimin e studentëve që nxjerr, sepse, ç'është e vërteta, edhe profilet brenda policisë kanë probleme me njëra-tjetrën. Nuk jam kundër oficerëve të ushtrisë, por duhet të kemi parasysh që oficerëve duhet t'u përcaktohet fusha se ku, sepse për mua si ish-oficer policie, megjithëse unë kam një karrierë shumë të gjatë në forcat e sigurisë, është e papranueshme që të më çojnë komandat reparti, divizioni, batalioni apo njësie. Oficerët e ushtrisë, që unë i respektoj dhe i kam miq, do të çuditeshin nëse do të më çonin shef Shtabi i Përgjithshëm apo zëvendësshtabi i Përgjithshëm. Kjo është absurde dhe e papranueshme, por ne duhet të përcaktojmë se në cilat funksione duhet të shkojnë. Unë do të isha partizan që të shkojnë te forcat speciale, te funksionet e tjera speciale, që lidhen me xhenierët, pra me demontimin e lëndëve eksplozive,

të cilët nuk i përgatit akademia dhe i përcakton qartësisht neni 40. Të përcaktojmë edhe Policinë Kufitare, pra pas një trajnimit, të shkojnë në akademi dhe të përgatiten për shërbimet e Policisë Kufitare. Meqenëse edhe përgatitja e kësaj strukture difekton, si traditë e kemi përgatitur në Akademinë e Forcave Tokësore, normalisht në respekt të nenit 167 të Kushtetutës, ta bëjmë që të mos jenë ushtarakë aktivë. Kjo bëhet me marrëveshje ndërmjet dy ministrave, të cilët duhet ta kenë këtë hapësirë, sepse ai mund të quhet ushtarak aktiv, pavarësisht se nuk është në funksion, pra duhet të lirohet. Kjo gjë duhet të bëhet me firmë të ministrit. Mendoj se duhet të bëhet unifikimi i gradave për funksionet deri në nënkomisar, jo më lart. Në momentin kur hyn në konkurrim për grada të larta, ai duhet të ketë karrierën e vet policore dhe duhet të përgjigjet për kohë pune në strukturat e policisë. Kështu ka qenë dikur, por nuk e di pse u hoq. Për shembull, kemi rastin e Bilbil Memës, një ndër drejtuesit më të mirë të Policisë së Shtetit, sipas meje, i cili vinte nga radhët e ushtrisë, por periudha e punës në strukturat e Policisë së Shtetit e bëri atë që jo vetëm të jetë i integruar, por të ketë të gjithë parametrat e duhur profesionalë që të kryejë funksionet e drejtorit të Përgjithshëm. Pra, koha e punës në strukturat e policisë do ta bëjë oficerin të hyjë në sistemin e kërkesës së karrierës të gradave të tjera.

Mendoj se ne e kemi ezauruar edhe në diskutime të gjithë pjesën e paqartësisë dhe tashmë jemi në momentin e konkludimit për parametrat deri në 3%.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Është e qartë edhe nga prezantimi që bëri zoti ministër i Brendshëm, edhe nga prezantimi i relatorit, që ligji aktual për Policinë e Shtetit e krijon qartësisht premisën për të pranuar në funksione të veçanta në polici persona, të cilët nuk vijnë nga radhët e Policisë së Shtetit. Pra, kur kërkon njohuri të veçanta në Policinë e Shtetit ka një mënyrë që mund të rekrutohen edhe persona të tjerë nga jashtë, sipas kushteve që përcakton ligji. Kështu që, aktualisht, baza ligjore, që të jep mundësinë e këtij propozimi, gjen mbështetje në ligjin aktual.

Për sa kohë bëhet fjalë për përfshirje të ushtarakëve të forcave të armatosura, gjithmonë kur këta lirohen nga Forcat e Armatosura në radhët e Policisë së Shtetit, do të thotë që ne duhet të bëjmë kujdes, të ruajmë edhe parashikimet kushtetuese. Unë besoj se me parashikimet, ashtu sikur janë propozuar, por edhe me vërejtjet dhe diskutimet e tjera, që do të kenë kolegët, ne do të mund të realizojmë një projekt ashtu siç duhet dhe të kalojmë barrierën kushtetuese për të mos krijuar asnjë përplasje me Kushtetutën, me nenin 167/1 të

saj, i cili ndalon që ushtarakët aktivë të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera të ndryshme nga ato që lidhen me Forcat e Armatosura.

Sipas Rregullores, kolegët kanë të drejtë të bëjnë pyetje, drejtuar ministrit të Brendshëm dhe personave që shoqërojnë atë, si dhe relatorit.

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia- Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, zoti Ministër, ju uroj suksese në detyrën tuaj, një detyrë shumë e rëndësishme në kabinetin qeveritar.

Së dyti, që të jemi korrektë dhe bashkëpunues për draftin që ju keni sjellë, dua të sqarojmë dy-tri gjëra, që kolegu im Ndreu, nisur edhe nga përvoja e gjatë që ka në Policinë e Shtetit, i përmbodhi.

Zoti Ministër, është krijuar përshtypja se ardhja juaj nga ushtria do të sjellë vështirësi dhe që ju do të vini me pjesën militare, me pjesën armatë nga ushtria. A mund të përcaktoni në mënyrë të detajuar dhe ekzaktësisht se për cilat kategori bëhet fjalë, në mënyrë që të qetësohen edhe punonjësit e policisë, të cilët janë ndjerë të frikësuar se po vijnë ushtarakët nga Ministria e Mbrojtjes dhe po u zunë vendet? Ajo është një kategori që ju e përmendët, por do të ishte me interes edhe për atë kategori që janë të interesuar, por edhe për qytetarët, sepse bëhet fjalë për kategori që policia vetë nuk i ka, siç janë xhenierët, kimistët e të tjerë. Do të ishte me interes përgjigjja juaj.

Së dyti, zoti Ministër, ju përmendet një fakt shumë të saktë, që Policia e Shtetit duhet të jetë e unifikuar edhe në veprimet e saj, madje duke e ndarë edhe në veprimet dhe punët konkrete që bëjnë në Policinë Kriminale, në Policinë e Rendit apo në ndarjet e tjera. A keni menduar ju që kjo të implementohet edhe në akademi, të hartohen programe dhe kurrikula, të cilat përshtaten drejtpërdrejt dhe këto mangësi që konstatohen tani të mos i kemi edhe në vitet e ardhshme?

Së treti, zoti Ministër, ju kemi ndjekur dhe ju kemi dëgjuar në daljet tuaja publike dhe në urdhrat që keni lëshuar, ku gjej rastin t'ju përgëzoj për nismën, e cila ka pasur një fleksibilitet dhe një ndjeshmëri në opinionin e gjerë publik, që ka të bëjë me heqjen e policëve, patrullës dhe postblloqeve. Zonja kryetare, ju kërkoj ndjesë që po dal jashtë diskutimit të ligjit, por do të ishte me interes për ta bërë prezent këtë fakt. A keni menduar se kjo nismë do të shërbejë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë rrugore? Ne jemi në kontakt me shumë qytetarë dhe, në pamje të parë ata e kanë mirëpritur këtë nismë, sepse dalja e patrullave të policisë dhe e policëve vend e pa vend, marrja e dokumenteve, komunikimi me

qytetarët në disa raste ka sjellë bezdi dhe jo në pak raste edhe veprime korruptive nga ana e punonjësve të policisë. A do të realizohet kjo nismë, apo do të mbetet një slogan si përherë?

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Zoti Lleshaj fjala për ju.

Sandër Lleshaj—Faleminderit, zoti Qefalia!

Unë e ndiej veten shumë krenar që vij nga ushtria, megjithëse në këtë funksion nuk vij nga ushtria, por nga një funksion civil që kam ushtruar vitet e fundit, por, gjithsesi, origjina ime ushtarake më bën të ndjem krenar dhe nuk besoj se ardhja e ushtarakëve të shkëputur në forcat e Policisë së Shtetit do ta cenojnë atë, por do ta pasurojnë me një element që i mungon.

Për të hequr merakun e disa të shqetësuarve për këtë, iniciativa ligjore nuk synon dhe nuk parashikon të bëjë plotësime të strukturës së policisë me ushtarakë në katet e larta të hierarkisë. Pra, nuk bëhet fjalë që do të vijnë ushtarakë dhe të bëhen drejtorë. Kjo është e përjashtuar dhe shfrytëzoj rastin që të them se nuk është ky qëllimi. Qëllimi i kësaj iniciative është të marrim specialistë dhe jo drejtues, që do të thotë se specialistët janë në katet e para ose të dyta të hierarkisë, atje ku na mungojnë realisht dhe nuk kemi mundësi t'i kompensojmë në asnjë mënyrë tjetër. Ky është i gjithë qëllimi i kësaj iniciative.

Fushat ku do të integrohen disa ushtarakë të Forcave të Armatosura janë kryesisht fusha e forcave speciale, fusha e kufirit, në segmente të caktuara të kufirit shtetëror, dhe specialitete të caktuara, që u përmendën. Pyetjes dhe shqetësimit tuaj se mos po synohet të atakohen drejtues të caktuar të Policisë së Shtetit nëpërmjet kësaj mënyre, i përgjigjem me jo. Drejtuesit e Policisë së Shtetit nuk janë të atakuar, por e gëzojnë përkrahjen time të plotë, janë të inkurajuar dhe do ta kenë mbështetjen time ta kryejnë detyrën. I vetmi kërcënim që mund t'u vijë atyre është nga mosbërja e detyrës dhe jo nga ushtarakët e Forcave të Armatosura. Ushtarakët e Forcave të Armatosura janë për të mbështetur Policinë e Shtetit, për të mbështetur sigurinë kombëtare të këtij vendi, dhe e bëjnë këtë punë shumë mirë, ashtu sikundër policia e bën shumë mirë punën e saj për sigurinë publike të këtij vendi. Kjo është përgjigjja dhe nuk mendoj të futem më thellë.

Për sa i përket pyetjes suaj të dytë lidhur me tri kategoritë e policisë dhe a do të reflektohet kjo në Akademinë e Sigurisë, patjetër! Së pari, kjo do të reflektohet në Akademinë e Sigurisë, e cila do të jetë një akademi që prodhon tri kategori oficerësh dhe tri lloje diplomash të ndryshme. Sot akademia prodhon vetëm një diplomë, oficer policie, por që nuk dihet nëse është për rendin, për rrugoren, për kufirin apo për kriminalen. Prandaj këta

oficerë qarkullojnë sa nga njëri vend në tjetrin duke moskrijuar bërthama ekspertizë që duhen. Me ndryshimet që propozojmë Akademia e Sigurisë do të jetë subjekti i parë që do t'i nënshtrohet këtij ndryshimi. Akademia e Sigurisë do të prodhojë oficerë të Policisë Kriminale, oficerë të Policisë së Rendit dhe oficerë të Policisë së Kufirit. Këta do ta kenë të shkruar në diplomë dhe rruga e karrierës së tyre do të jetë brenda këtyre shinave deri kur të ngjiten lart dhe deri kur ata të bëhen drejtues, atëherë, mund të shkëmbehen nga njëra fushë në tjetrën. Për fat të keq, sot na ndodh rëndom që nga policia kriminale mund të gjendesh nesër në policinë e qarkullimit rrugor. Besoj se edhe ju keni të njëjtin mendim si unë, që një oficer, që bën investigime të krimit kibernetik apo të krimit financiar, dhe një oficer që menaxhon qarkullimin rrugor kanë shumë pak gjëra të përbashkëta profesionalisht.

Pikërisht, për të adresuar këtë problem ne kemi propozuar këtë ndryshim.

Për sa i përket pyetjes së fundit, e cila nuk ka lidhje me çështjen, por ka lidhje me interesin publik, ju falënderoj që ma bëni, sepse më jepni mundësinë që t'i jap një sqarim publikut me të cilin kam qenë shumë i kursyer dhe besoj se do të përpiqemi të mbetem i kursyer personalisht. Të gjithë qytetarët e këtij vendi kanë konstatuar se kemi një prani jashtëzakonisht të shtuar të policisë në akset rrugore të vendit. Pra, krijohet ideja që jemi vend shumë policor, kemi polici të madhe. Ashtu siç jua thashë në parashtrimet e mia, ne jemi një vend me policinë më të vogël për frymë jo vetëm në rajon, por edhe në Europë dhe krijojmë imazhin te qytetarët dhe te vizitorët e shumtë të këtij vendi që këtu ka polici gjithandej, në çdo kryqëzim, në çdo rrugë dhe gjitha e cila nuk ka prodhuar siguri të shtuar, por ka prodhuar më shumë problematikë. Shumë prej këtyre postblloqeve kanë luajtur rolin e portave, prej ku është gjeneruar edhe korrupsion. Ky nuk është se vetëm perceptimi i publikut, por ka dalë nga të dhënat e evidencave që kam dhe që di. Për t'i adresuar këto kam kërkuar që të hiqet dorë nga kjo praktikë e pagjendur ndokund në Europë. Mund të bësh me mijëra kilometra rrugë në Europë dhe nuk ndeshesh me asnjë polic. Prandaj kemi thënë se do të aplikojmë të njëjtin standard siç aplikon Europa. Pra, nuk do të thotë se kemi ulur kontrollet, përkundrazi kontrollet do të shtohen, por do të ndërrojë forma e kontrollit nga pritrat nëpër postblloqe, që i ngjajnë një lloj prite, do të ketë patrullim. Oficerët e policisë qoftë me mjete të loguara, qoftë me mjetet të paloguara do të jenë dhe janë vazhdimisht në patrullim në akset rrugore të vendit dhe ndjekin ata që bëhen subjekt i tyre, ata që shkelin rregullat; ata që parakalojnë keq, ata që kanë shpejtësi të shtuar, ata që nuk respektojnë rregullat e qarkullimit e të tjera me radhë. Pra, besoj fort se me këtë ndryshim, i cili është në orët e para të tij, ne do të ndryshojmë qasjen e policisë, do të shtojmë kontrollin, por do ta

bëjmë atë kontroll që të adresohet vetëm tek ata që duhet të kontrollohen dhe të heqim ngarkesën e panevojshme ndaj qytetarëve, të cilët shpeshherë kontrollohen pa asnjë lloj arsyeje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Lleshaj!

Është e qartë se masa që ju propozoni shkon në drejtim të edukimit të përdoruesve të rrugës me rregullat e qarkullimit rrugor dhe më pas të vijë ndëshkimi. Pra, ndëshkimi nuk duhet të jetë qëllim në vetvete i punonjësve të qarkullimit rrugor, sepse është pikërisht ky momenti që shpeshherë shkakton edhe ilaritet, edhe ngjarje të papëlqyeshme. Kështu që, besoj se jemi në kohën e duhur për ta bërë këtë ndërhyrje.

Fjalën e ka zonja Gjebrea dhe më pas zoti Sinaj.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

I uroj suksese zotit Lleshaj në detyrën dhe sfidën që ka përpara dhe si anëtare e Komisionit të Sigurisë u jap mbështetjen të gjitha nismave, duke përmendur atë të fundit, që u tha me të drejtë Policia e shtuar Rrugore krijon një përshtypje jo të mirë. Patjetër që kjo nismë do të jetë në mbështetje të qytetarëve dhe ne të gjithëve.

Kam disa pyetje në lidhje me ndryshimet e propozuara nga ju zoti Ministër, duke theksuar që parimet bazë të pranimi në Policinë e Shtetit janë nëpërmjet shkollimit bazë dhe ecures në karrierë, që është e bazuar në meritat dhe patjetër në aftësitë e tyre për të ecur përpara.

Cila do të jetë rruga e karrierës për punonjësit e policisë, që kanë gradën inspektor, pra rolin bazë, të cilët kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve dhe që kanë dëshirën për të ecur me tej? E bëj këtë pyetje duke u mbështetur te fakti që ju thatë, se ka një boshllëk për sa i përket gradës nënkomisar dhe në njëfarë mënyre inspektorët do të kalojnë në këto grada. Edhe një herë, për të theksuar atë që besoj se ju keni, së bashku me të gjithë drejtuesit e lartë policorë, një strategji për reformimin e akademisë apo të gjithë atyre problematikave që ju hasët. Personalisht kam respekt për trupën policore, për angazhimin e saj, për profesionalizmin dhe në mënyrë të veçantë theksoj pjesën e Policisë Kufitare, me të cilët kam pasur mundësi edhe të bashkëpunoj, sigurisht brenda këtyre patjetër ka nevojë për përmirësime dhe për mbështetje. E mbështes pjesën që ju thatë për sa u përket nevoja për funksione specifike dhe besoj se e ka atë hapësirën ligjore për të bërë të mundur.

Një tjetër pyetje ka të bëjë me praktikën e kësaj gjëje në vendet e tjera, në mos gaboj Franca ka diçka të ngjashme në lidhje me këtë.

Së fundi, mbështetja nga partnerët që asistojnë Policinë e Shtetit, si është në lidhje me këto propozime?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea, për pyetjet dhe për mundësinë për t'i komunikuar publikut faktin se si është punuar për propozimin e këtij projektligji, ku është bazuar, cili mendim është tërhequr! Mendoj se kjo ka vlerë.

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Për sa i përket pyetjes së parë, që ka të bëjë me perspektivën e karrierës së nënkomisarëve, sigurisht unë u shpreha në parashtrimet e mia që boshllëqet në të gjitha gradat kanë çuar në një lloj stanjacioni të procesit të promovimit, sepse, nëse do të bëhej promovimi, pra nëse do të ngjiteshin lart në gradë, praktikisht ne do të na zbrazeshin katet poshtë. Pothuajse një pjesë e madhe e nënkomisarëve do të ishin bërë kryekomisarë, një pjesë e madhe e nënkomisarëve i ka plotësuar ndërkohë kushtet për t'u bërë komisarë. Përmes kësaj ndërhyrjeje që po bëjmë shpejt, sepse kjo që po bëjmë është ndërhyrje e shpejtë, ne synojmë që të hapim kanalën e universitetit, në mënyrë që në harkun e një viti të bëjmë një prurje të re të mirë, e cila do ta mbushë boshllëkun e krijuar në nivelin komisar. Më pas kjo mbushje do të krijojë mundësinë që të tjerët të ngjiten. Thashë, në të gjitha gradat kemi mesatarisht 30% më pak. Imagjinoni kemi 30% më pak nënkomisarë, sikur nga ky të marrim një 30% tjetër, ta bëjmë komisar, boshllëku poshtë shkon në 60%, pra po t'i bëjmë këto lëvizjet sot. Prandaj është shumë e nevojshme prurja e re në sistem, e cila ka dy rrugë: ose do ta bëjmë me mënyrën aktuale, ku na duhen 4 vjet për ta bërë këtë, sepse kaq zgjat arsimimi, ose më mënyrën e re, që zgjat një vit. Prandaj themi të ndjekim rrugën e re. Pra, jo vetëm që plotësojmë, por japim mundësinë që njerëzit të përfitojnë gradën që u takon në bazë të ligjit. Ka shumë që nuk promovohen për arsye të këtij ngërçit të krijuar prej shumë kohësh.

Për sa i përket pyetjes suaj lidhur me reformimin e akademisë, sigurisht akademia do t'i nënshtrohet një procesi të rëndësishëm reformimi, që të reflektojë këto ndryshime.

Së pari, akademia duhet të ndajë kurrikulën në tri fusha të policisë.

Së dyti, akademia duhet të hapë një portë për ata që vijnë nga universiteti, në mënyrë që të marrin trajnimin policor, për shembull, një vit akademik. Këto janë dy ndryshimet e mëdha që duhet të ketë akademia. Sigurisht, për të bërë këtë punë akademia duhet të reformojë përbërjen e saj, sepse do t'i duhet të shtojë ofertën në fushat, ku ajo nuk ka operuar, kryesisht në fushën e krimit ekonomik, të krimit financiar, të krimit kibernetik, pra në fusha të domosdoshme. Më lejoni t'ju them se janë këto fusha, të cilat përfaqësojnë barrën më të

rëndë të krimit në Shqipëri. Pra, krimi ekonomik, krimi financiar, krimit kibernetik është barra më e madhe e krimit. Këtu lëviz një pjesë e madhe e gjithë problematikës sonë dhe në këtë fushë duhet që Akademia e Sigurisë të rrisë ofertën dhe të rrisë ekspertizën e saj. Sigurisht, do të ketë shumë për të bërë për sa i përket Akademisë së Sigurisë.

A ka praktikë të ngjashme ndërkombëtare me këto që propozojmë ne? Unë e di që vetëm praktika të tilla ka. Praktika që universitetet të furnizojnë policinë përmes një trajnimi përkatës është e rëndomtë, pra unë nuk di ndonjë vend që nuk e ka një praktikë të tillë, që të marrë nga universitetet dhe të fusë në polici. A ka praktika që nga ushtria futen në polici? Sigurisht që ka. Madje, po ju them se praktikat janë më të ekzagjeruara se jona. Ka vende ku vetë ushtria, si e tillë, kryen misione policore.

Sot kam pasur takim me dy ambasadorë, partnerë të rëndësishëm të vendit tonë, dhe atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Britanisë së Madhe dhe, po referoj nga takimi i sotëm, Britania e Madhe i përdor kapacitetet e forcave të armatosura për të zgjidhur detyra policore siç janë, gjë që te ne është e pamendueshme, që një trup e ushtrisë të vihet në krye të një mision policor dhe të shkojë përsëri në kazermë. Ndërkohë, kemi vende të tjera, për shembull, Italia ka karabinierët, që janë pjesë e forcave të armatosura, që janë pjesë e aktive e forcave të armatosura. E njëjta gjë është në Francë, e cila ka mbi 100 mijë xhandarë, që janë pjesë organike e strukturës së forcës së armatosur, të cilët janë ata që e menaxhojnë pjesën më të madhe të situatës, apo në vende të tjera të Francës. E njëjta gjë është në Spanjë me rojën civile, e njëjta gjë është Holandë, e njëjta gjë është në Turqi dhe në një pjesë të madhe të botës. Me aq sa unë di, më shumë se gjysma e vendeve të kësaj bote ka një trupë xhardanmarie, karabinerie, e cila kryen funksionet policore, duke qenë pjesë e ushtrisë. Ajo që ne kërkojmë sot, nuk është kaq, sepse ky është nivel tjetër ambicieje. Ne kërkojmë të marrim 10 veta t'i bëjmë civilë dhe t'i fusim në Policinë e Shtetit. Kaq është ajo që kërkohet sot për ta thjeshtuar të gjithë diskutimin.

Sa është mbështetja e partnerëve? Sigurisht, partnerët mbështesin. Unë kam pasur takime personale me partnerët tanë strategjikë, të cilët, në diskutimet që kamë pasur, kanë shprehur simpatinë e tyre për këtë ide. Besoj se do të jenë në përkrahje të mëtejshme të procesit të implementimit të ligjit. Ashtu siç jua thashë kam pasur takime me ambasadorët kryesorë të vendeve tona mike dhe partnere.

Ermonela Felaj – Faleminderit, për përgjigjet dhe për faktin që na sollët në vëmendje se është e vërtetë se shpeshherë forcat që vijnë nga Forcat e Armatosura kryejnë misione policore! Mjafton t'ju kujtojmë se në kryeqytet më në zë të Europës, në sheshet më

të populluara janë të instaluara, edhe tani që flasim, forcat e ushtrisë për luftën kundër terrorizmit. Besoj se ky është një shembull i saktë dhe i plotë, që tregon nevojën që, për funksione të veçanta, mund të adresohemi te Forcat e Armatosura.

Një gjë tjetër, që dua të sjell në vëmendje është se para vitit 2014, kur ne bëmë ligjin “Për Policinë e Shtetit”, në këtë vend ndodhnin çudira, këtu u shkri Akademia e Sigurisë dhe policët po bëheshin me kurse. Pra, u zëvendësua një shkollë me një kurs, një shkollë 3-vjeçare me një kurs disamujor, që ishte një turp i vërtetë për vendin. Kuptohet, ato të këqija janë mbartur ndërkohë dhe kohë dhe nuk është kaq e thjeshtë, që të rikuperohen me një të rënë të lapsit. Pra, ne kemi bërë një ligj, ashtu siç është ligji “Për Policinë e Shtetit”, është një ligj i asistuar dhe realisht ka marrë shumë vëmendje në komisionet parlamentar dhe në Kuvendin e Shqipërisë, por, si çdo ligj, nuk mund të themi se ky ligj është perfekt dhe e ka arritur tërësisht qëllimin e tij. Kështu që, herë pas here është e nevojshme që ne t’u rikthehemi përmbajtjes së ligjeve dhe mund t’i plotësojmë ato në masën dhe nevojën që na kërkohet.

Urdhëroni, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e përgëzoj nismën e ministrisë për ndryshimet në ligjin e policisë! Pas pasqyrës që bëri zoti Ministër, me mungesat që janë në nivele të ndryshme të policisë, që përgjithësisht shkonin 30%, sipas shifrave që ju thatë, është më se e natyrshme që nuk ke se si të kërkosh të zbatosh detyrat, të rrisësh sigurinë në vend dhe t’u shërbesh qytetarëve të Shqipërisë. E kuptoj emergjencën me të cilën keni ardhur sot në komision dhe keni sjellë këto propozime për ndryshimin e këtij ligji. Gjithsesi ju falënderoj dhe ju përgëzoj!

Por nisur nga ajo që tha kolegu më parë, është gjithmonë kontradikta e ushtrisë me policinë dhe merakut që ekziston. Në fakt, tek nenet 2 dhe 3, që ju keni propozuar këtu, keni prekur “eksperiencën në polici” dhe e keni zëvendësuar me “eksperiencën në forcat e sigurisë”. Kjo krijon një kontradiktë, që duhet sqaruar, për të përçuar vërtet idenë që keni ju në këtë ligj. Bashkë me këtë, në propozimet tuaja, vjen edhe marrja e studentëve nga universitetet që kanë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta dhe do të shkojnë në Akademinë e Sigurisë. Akademia e Sigurisë është 3 vjet, apo jo? Këta Akademinë e Sigurisë do ta bëjnë 3 vjet të plota apo 1 vit?

Mundësia për të sjellë ushtarakë nga Forcat e Armatosura për të plotësuar nevojat që ka policia, pasi ata të jenë liruar. Tani, ne e dimë se ushtarakët në polici janë trajnuar nga institucione të ndryshme me të cilat bashkëpunon policia për policizimin e qytetarëve dhe të

vetë policisë. Atëherë mos vallë edhe këta ushtarakë që do të vijnë nga ushtria në polici, kanë nevojë për të bërë më parë një kurs në Akademinë e Sigurisë, për të përfituar edhe ata disa shprehi njësoj si policët e tjerë?

Së fundi, grada me të cilën do të futen në polici ushtarakët e ardhur dhe studentët që kanë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta nënkomisar, a ka ndonjë përplasje me gradat që do të gjejnë këta me kolegët e tyre në polici?

Faleminderit!

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Në lidhje me pyetjen sa vjet do të zgjasë arsimimi për ata që do të rekrutohen nga universitetet, sigurisht ata nuk do të shkojnë të bëjnë ciklin *bachelor*, sepse ato do të vijnë me master. Kështu që ata do të bëjnë maksimalisht një vit akademik në Akademinë e Policisë dhe trajnimi ose pjesa e arsimimit të tyre në Akademinë e Policisë do të jetë i pastër policor, sepse pjesën tjetër e sjellin me vete. Pra, formimin akademik e sjellin me vete. Ata do të jenë me master. Përveç kësaj, kriteret e pranimit do të jenë shumë të rrepta, në kuptimin që të inkurajohen për t'u futur në Policinë e Shtetit kapacitete të larta. Ne nuk kemi nevojë për numër, por ne kemi nevojë për cilësi të re. Meqenëse jemi në diskutimin intensiv me studentët, ndoshta është edhe rasti për të lançuar një lajm të mirë për studentët, sepse së shpejti ata do të ketë mundësi për t'u adresuar tek Akademia e Policisë, ku do të kenë mundësinë që për një kohë të shkurtër të marrin një trajnim modern dhe intensiv policor për të filluar një karrierë në radhët e Policisë së Shtetit, e cila fillon me gradën nënkomisar. Pra, duhet të jetë një numër jo i vogël, për arsye se, siç ju thashë, nevojat janë të mëdha. Aktualisht, na duhen 315 nënkomisarë të rinj, po t'i kemi na duhen sot. Nuk i bëjmë dot sot, nuk i bëjmë dot as nesër, por një orë e më parë ne duhet që këtë boshllëk ta kompensojmë, edhe pse jo, ku ka mirë se studentët e talentuar, nga fakultetet e universiteteve tona apo të botës, të vijnë dhe t'i bashkohen Policisë së Shtetit.

Pyetja juaj e parë kishte të bënte me nenet 2 dhe 3, pra në lidhje me ndryshimet e kriterëve për drejtorin dhe nëndrejtorin e Përgjithshëm të Policisë, ato janë dy nene që kanë shkaktuar pikëpyetjet më të mëdha. Unë kam kënaqësinë t'ju jap një përgjigje të thjeshtë, nuk janë ndryshuar kriteret me këtë qëllim, pra nuk janë propozuar me qëllim që të ndryshojnë, por janë propozuar vetëm me qëllimin që ata që vijnë nga Forcat e Armatosura në Policinë e Shtetit, në qoftë se pas disa vjetësh do t'u krijohet mundësia për të aplikuar për gradën e lartë ose për t'u bërë drejtor apo nëndrejtor i Policisë së Shtetit. Vitet e kaluara Forcat e Armatosura këtu çmohen". Kaq është i gjithë thelbi i kësaj kërkeje. Megjithatë, duke pasur

në konsideratë sensibilitetin e shtuar dhe paqartësitë e krijuara, unë jam i hapur që për këto çështje komisioni të diskutojë dhe të tregohet edhe refuzues për të dyja këto pika.

Për sa i përket pyetjes së tretë: a duhet që ata pak ushtarakë, të cilët vijnë nga Forcat e Armatosura, të marrin edhe një trajnim policor, patjetër që do të duhet. Madje duhet të bëj një parantezë këtu që trajnimi, edukimi dhe kualifikimi janë procese të vazhdueshme në botën e sotme.

Policia e Shtetit në vetvete, por edhe ata që janë brenda Policisë së Shtetit kanë nevoja urgjente për trajnim të përditshëm. Sot, për fat të keq, për shkak të një koncepti shumë intensiv të përdorimit të policisë në shërbime, hapësira për trajnimin e policisë është tejet e reduktuar. Për shembull, një polic qarkullimi, i cili rri gjithë ditën në kryqëzim, pothuajse e kalon gjithë jetën e tij aty në kryqëzim, pa iu nënshtruar një procesi të mirëfilltë trajnimi apo përditësimi të vazhdueshëm njohurish.

Ne do të krijojmë programe trajnimi për të gjithë strukturën e policisë, nga maja deri në fund, që do të trajnohen në fushën profesionale, në fushën e gjuhëve të huaja, në fushën e *skills*-ave të tjera që kërkohen dhe që i duhen një polici të kohës sonë, njohuri kompjuteri e të tjerë. Ne po fusim teknologji masivisht.

Së shpejti do të prezantojmë tabletin e ri të policisë, i cili do t'i heqë policisë letrat nga duart. Por të gjitha këto procese modernizimi kërkojnë që të modernizohen edhe njerëzit. Kështu që, patjetër që duhet kualifikim i vazhdueshëm edhe për ata që vijnë nga ushtria, edhe për këta që janë brenda policisë.

Lidhur me pyetjen e fundit për ekuivalentimin e gradës për studentët dhe ushtarakët që hyjnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, nënkomisar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, këta nuk e ezaurojnë njëri-tjetrin. Pra, prurja nga radhët e policisë sot është shumë e vogël. Po të na e plotësonte nevojën prurja nga policia, ndoshta nuk do të kishim nevojë të merrnim nga jashtë.

Nuk e pengon njeri ngritjen në karrierë të inspektorëve. Sigurisht, në qoftë se vjen një nga universiteti, i cili është më i mirë se një inspektor, për shkak të... Këtu do të jetë pastaj procesi i vlerësimit. Por, përgjithësisht, për sa u përket numrave, nuk ka pengesa që edhe inspektori që është sot të bëhet nënkomisar, edhe ai që vjen nga universiteti të bëhet...

Ne do t'i kemi të dyja kanalet që do të funksionojnë, pra për ata që vijnë si nga universiteti, ashtu edhe nga trupa e inspektorëve, të cilët vijnë nëpërmjet Akademisë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Lleshaj!

Ftoj kolegët të mos ndalemi te pyetjet për nene të veçanta, pasi do të kalojmë për pak në diskutimin nën për nën. Kështu që, të ezaurojmë pjesën e pyetjeve që kanë të bëjnë me parimin e ligjit dhe tashmë u sqarua qartësisht thelbi i ndryshimeve të propozuara.

Fjalën e ka zoti Xhindi. Pastaj do të kalojmë në votimin në parim.

Anduel Xhindi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, do të doja t'i uroja mirëseardhjen zotit ministër në komisionin tonë dhe t'i uroja suksese në detyrën në krye të Ministrisë së Brendshme!

Në fakt, kam një pyetje. Ju thatë se rekrutimi i ushtarakëve në Policinë e Shtetit do të bëhet për nevoja të veçanta. Dua të di, këto nevoja të veçanta janë të përkohshme apo të përhershme?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Ministër.

Sandër Lleshaj – Sigurisht, nevojat e veçanta nuk janë në aspektin kohor, por në aspektin funksional. Kjo do të thotë se nevojat e veçanta mund të krijohen herë pas here. Për të dhënë një shembull, në qoftë se një specialist i xhenios del sot në pension, ai duhet të zëvendësohet nga një i ri dhe do të zëvendësohet. Nëse një funksion xhenio shtohet, sepse për arsye të ngarkesës operationale na duhet ta shtojmë një funksion në këtë fushë, do të duhet të merret një tjetër. Pra, nuk mund të them se kjo çështje bëhet për dy ditë, por është një mundësi e hapur që herë pas here, kurdo që krijohet një *vacancy* në strukturë, të mund të plotësohet duke marrë një special që është i gatshëm.

Kjo është pak a shumë ideja.

E përsëris për të disatën herë, dhe nuk besoj se gaboj se e përsëris, nuk flasim për numra të mëdhenj, por për raste, jo për një sistem rekrutimi që merr njerëz, pra i kalon nga ushtria në polici. Jo, jo dhe jo.

Ermonela Felaj – Mirë.

Faleminderit, kolegë për pyetjet!

Në rast se nuk ka pyetje të tjera, ju ftoj të kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me propozimet për disa ndryshime në ligjin “Për Policinë e Shtetit”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Fillojmë me diskutimin nen për nen të projektligjit.

Besoj se tabela e ndryshimeve si ishte dhe si bëhet ligji, bashkë me propozimet, u është shpërndarë të gjithë kolegëve. Kështu që vazhdojmë.

Atëherë, propozohet që në ligjin “Për Policinë e Shtetit” të bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

Neni 1. Pika 16 e nenit 6 të ndryshohet, duke dhënë një përkufizim më të plotë të punonjësit të policisë, pra se kush quhet punonjës policie. Besoj se nuk ka vërejtje për këtë përkufizim të ri.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet përkufizimi i ri i propozuar nga Ministria e Brendshme: “Punonjës policie është personi i emëruar në strukturat e policisë pas përfundimit të arsimimit, kualifikimit përkatës dhe mban gradë policore”.

Neni 2. Propozohet mundësia për të ndërhyrë në germën “b” të pikës 2 të nenit 13 të ligjit aktual, duke ndryshuar në këtë pjesë kriteret e emërimit të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Unë besoj se doli edhe nga diskutimet e kolegëve këtu, edhe nga ndjeshmëria, pra u kuptua qartësisht se kolegët e këtij komisioni nuk bien dakord për ndryshimin e kriterëve të emërimit të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ndërkohë, nga ana e ministrit na u tha që, gjithsesi, edhe nëse ne do të refuzonim, kjo nuk ka të bëjë aspak me thelbin e ligjit dhe qëllimin për të cilin po ndryshohet ky ligj. Atëherë, kush është dakord që neni 2 i propozuar të rrëzohet?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Rrëzohet.

Edhe neni 3, i cili bën fjalë për një ndryshim në kriteret e emërimit të zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, shkon në të njëjtën logjikë me nenin 2, ndaj ju ftoj të votojmë sipas së njëjtës logjike, pra për rrëzimin e nenit 3 të propozuar në projektligjin në fjalë.

Kush është dakord për rrëzimin e nenit 3, sipas propozimit?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Faleminderit, kolegë!

Kalojmë te neni 4, i cili, pas këtij votimi, duhet të rinumërtohet. Ftoj stafin e komisionit që, edhe për efekt kohe, të jetë i kujdesshëm në ndjekjen e rinumërtimeve, në mënyrë që të mos detyrohem ta theksojmë në çdo rast, meqenëse kjo nuk është as thelbësore, sepse, gjithsesi, në tekstin integral do të ndiqet rendi kronologjik i numrave.

Atëherë, për nenin 4, që do të rinumërtohet, propozohet një përkufizim i ndryshëm nga ai në ligjin aktual “Për Policinë e Shtetit”. Pra, Policia e Shtetit do të vijojë të jetë unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, por përkufizimi që propozon rishtazi Ministria e Brendshme është i tillë, që orienton tri drejtimit kryesore të Policisë së Shtetit, që do të jenë: Policia Kriminale, policia për sigurinë publike dhe Policia e Kufirit dhe Migracionit. Kjo është risia që propozohet.

Kush është dakord me propozimin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vijmë te ndryshimet që propozohen të bëhen në nenin 38 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i cili flet për kriteret e pranimit në Akademinë e Sigurisë. Konkretisht, propozohet një ndryshim i vogël në formulimin e germës “b” të pikës 2 të këtij neni, ku si kriter për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë kërkohet mospërfashtimi nga strukturat e tjera të sigurisë kombëtare. Pra, deri tani ne kërkonim të mos ishte i përjashtuar nga Policia e Shtetit dhe të mos ishte i larguar nga shërbimi civil, ndërkohë që shtohet një rrethanë e re: të mos jetë i përjashtuar as nga strukturat e tjera të sigurisë kombëtare, që, për hir të së vërtetës, janë më shumë se një apo dy të tilla, janë disa struktura që i kanë këto funksione. Besoj se bën sens e gjitha dhe është normale.

Kush është dakord me këtë pikë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, se nuk kam mbaruar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I kam marrë pikat veçmas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni ndërhyrjen për këtë pikë që miratua?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Elona Hoxha – Faleminderit!

Meqenëse përjashtimi nga Policia e Shtetit dihet se si bëhet në procedura, nuk jam e qartë për përjashtimin nga strukturat e tjera të sigurisë kombëtare. Ka të bëjë me një certifikatë sigurie...?

Ermonela Felaj – Jo, nuk është ai rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka këshilltari i ministrit të Mbrojtjes, që të na shtojë një argument lidhur me këtë aspekt.

Ismail Shehu – Do t’ju përgjigjem shumë shpejt.

Ka disa raste të parashikuara me ligj për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura dhe, si rregull, përjashtimi bëhet vetëm për efekt të ndonjë mase disiplinore.

Ka një ligj të veçantë për këtë rast, që është ai nr. 153 i vitit 2014, ku thuhet se për shkelje shumë të rënda disiplinore përcaktohet një listë ezauruese se kur mund të përjashtohesh nga radhët e Forcave të Armatosura. Në këtë rast nuk merr as trajtim financiar mbrapa, pension suplementar e të tjerë. Besoj se edhe projektligji ka këtë frymë. Në qoftë se ti je larguar, je përjashtuar nga Forcat e Armatosura, jo me vullnetin tënd apo me plotësimin e moshës dhe të kriterëve të tjera, por sepse ke kryer një shkelje, në këtë rast nuk mund të jesh pjesë e Policisë së Shtetit.

Ermonela Felaj – Faleminderit për sqarimin, pasi besoj se ishte i nevojshëm, sado ishim dakord me formulimin e kësaj pike!

Ndërkohë, propozohet një ndryshim tjetër i vogël, por që nuk besoj se ka nevojë të bëhet, pasi thelbi ngelet njësoj, që ka të bëjë me germën “d” të pikës 2 të nenit 38 të ligjit. Pra, te kriteret e pranimit në Akademinë e Sigurisë, në germën “d” thuhet se një nga kriteret është që kandidati duhet të ketë mbaruar arsimin e mesëm, ndërkohë që propozimi vjen që kandidati të ketë mbaruar së paku arsimin e mesëm. Unë besoj se nuk ka nevojë ta bëjmë këtë ndryshim, pasi në çdo rast dyshemeja është arsimi i mesëm.

Kalojmë te pika 3 e nenit 38, ku propozohet që pas germës “f” të shtohet një germë e re “g” me këtë përmbajtje: “Të plotësojë standardet dhe kriteret e tjera të veçanta, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga ministri i Brendshëm”. Bëhet fjalë gjithnjë për kriteret e pranimit në Akademinë e Sigurisë.

Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

Pjerin Ndreu – Cilat supozoni se janë standardet e veçanta?

Sandër Lleshaj – Hyrja në Akademi... Ligji ekzistues ka përcaktuar kriteret që ju njihni. Tani themi të shtohet ky, sepse akademia ka standarde të veçanta, për shembull, duhet të kalosh një test pranimi në akademi. Nuk është i shkruar në ligj. Prandaj këtu janë parashikuar ato gjëra që kanë të bëjnë me specifikën e pranimi. Akademia...

(Deputeti Ndreu flet pa mikrofon.)

Po pra, konkurrim i hapur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ligji njeh akademinë. Ky ndryshim i jep akademisë tagrin të shtojë kriteret. Për shembull, testi i pranimi është një kriter dhe ky test përcaktohet nga akademia, por vetëm kaq thotë ky nen.

Pjerin Ndreu – Jo, unë nuk jam dakord me këtë, pasi mendoj se formulimi i propozuar: "...standardet dhe kriteret e tjera të veçanta, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga ministri..." lë shteg për lloj-lloj kriteresh, që mund t'i nxjerrësh vetë, që i shpikni rrugës apo i nxjerr njëri ashtu-kështu. Nuk më duket normale. Kriteret ekzistuese janë të qarta deri tani dhe nuk ka nevojë për kriteret shtesë. Kriteret e tjera pastaj, në zbatim të ligjit, dalin me urdhra...

(Mungesë regjistrimi)

...dalin me akte nënligjore, që i nxirrni ju, dhe rregulloni disa aspekte të tjera të brendshme, jeni të detyruar të respektoni ligjin. Në qoftë se në ligj e themi këtë, unë mendoj se është term evaziv, që nxjerr të veçanta, por nuk dihet se cilat janë ato. Pra, unë nuk e shoh të arsyeshme të shtohet. Ah, të lind e drejta? E thashë, me akte nënligjore mund të rregullosh ndonjë gjë brenda sistemit të rekrutimit që ka të bëjë me testet, me mënyrën se si ashtu e të tjerë...

Sandër Lleshaj – Besoj se këtu flasim për të njëjtën gjë, pasi këtu bëhet fjalë që akademia të miratojë një akt nënligjor, ku përcakton kriteret e veçanta. Po jap një shembull. Akademia mund të vendosë kriteret fizike, bie fjala për...

Ermonela Felaj – Gjatësinë.

Sandër Lleshaj – Jo, them kriteret fizike në përgjithësi, të cilat nganjëherë i harrojmë dhe i kemi parë pastaj se cilat janë pasojat. Këto kriteret nuk mund të parashikohen në ligj, si, për shembull, të thuhet: do të jetë kaq i gjatë apo kaq i shpejtë, këto përcaktohen nga Akademia nëpërmjet kriterëve që miratohen nga ministri. Ky përbën një akt nënligjor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju si ta çmoni, por unë mendoj se është e dobishme që të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Bëjmë një propozim, i cili mund të na bashkojë, me këtë përmbajtje: “Standardet dhe kriteret e tjera të veçanta, që do të përcaktojnë Akademia në një rast eventual të jenë të lidhura gjithmonë me konkurrimin”?

Sandër Lleshaj – Shprehem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Sepse edhe në fjalën tuaj nënkuptohet se i referohen konkurrimin.

Sandër Lleshaj – Vetëm të kuptohet thelbi.

Ermonela Felaj – Pra, të mos dalë nga konkurrimi, por të kenë të bëjnë vetëm me konkurrimin dhe të heqim edhe merakun, me të drejtë, e kolegut Ndreu.

Sandër Lleshaj – Në rregull.

Ermonela Felaj – Atëherë, të zbardhet sipas propozimit që diskutuam.

Kalojmë tani te një propozim tjetër, sado ngelemi përsëri te neni 38, që të kemi një pikë 3, ku të thuhet: “Për nevojat e Policisë së Shtetit pranohen në Akademinë e Sigurisë shtetasit që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. Kandidati që përfundon me sukses kualifikimin përkatës pranohet në Policinë e Shtetit dhe i jepet grada policore “nënkomisar””.

Personalisht, zoti Ministër, unë nuk do të kisha ndonjë vërejtje për përmbajtjen e kësaj pike, por kam një vërejtje për vendin ku është vendosur, sepse për nga përmbajtja kjo pikë nuk më rezulton të përputhet me titullin e nenit “Kriteret për pranimin në Akademinë e Sigurisë”. Kjo në vetvete, kështu siç është formuluar, nuk përbën ndonjë kriter të veçantë, prandaj fare mirë mund ta akomodojmë në nenin 37 të ligjit aktual, i cili bën fjalë për pranimet në Akademinë e Sigurisë. Aty mund ta shtojmë si pikë dhe të bëjmë rinumërtimin e pikave ekzistuese.

Sandër Lleshaj – Për mua është teknike. Nuk kam ndonjë kundërshtim.

Ermonela Felaj – Jam e mendimit ta ruajmë si përmbajtje, por meqenëse nuk është kriter në vetvete, ta vendosim tek Akademia e Sigurisë dhe ta vëmë atje.

Sandër Lleshaj – Ndoshta vendi nuk ka rëndësi, por ky është neni kyç i këtij propozimi. Se ku renditet, është çështje teknike, për të cilën nuk kam asnjë problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Biem dakord?

Pjerin Ndreu – Unë kam diçka lidhur me këtë pikë.

Grada “nënkomisar” për mua është e diskutueshme, sepse mund ta bëjmë inspektor, pse të marrë gradën “nënkomisar”? Për shembull, unë mbaroj shkollën e lartë. E çfarë pastaj? Shkollën e lartë e mbarojnë edhe patrullat e përgjithshme. Nga 70% e kërkesave që ke, patrullat e përgjithshme janë me shkollë të lartë. Pra, i bie që edhe këta të bëhen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Xhemal Qefalia – Nuk mund ta fillojnë si nënoficerë?

Pjerin Ndreu – Jo, mor, është inspektor, nuk është nënoficer!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka koncept nënoficeri në polici.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Ermonela Felaj – Ju lutem!

Pjerin Ndreu – Ka ikur koncepti i ndarjes ndërmjet oficerëve në polici.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Duhet ta kuptojmë ku jemi.

Në polici nuk është më koncepti i ndarjes në oficerë dhe nënoficerë, tani ka punonjës policie. Kjo ndarje nuk është më. Që kur fillon punë, fillon sistemin e karrierës dhe ngjitesh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu është, por mund ta diskutojmë. Në qoftë se doni, në rregull, por mua nuk më duket normale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grada “nënoficer” është e lartë për...

Ermonela Felaj – Fjala është për zotin Qefalia.

Xhemal Qefalia – Mua më vjen keq që kësaj radhe jam kundër kolegut Ndreu, pasi këtu bëhet fjalë për të thithur ata çfarë tha ministri: studentë, individë dhe kapacitete, të cilët aspirojnë të jenë pjesë e Policisë së Shtetit.

Në këtë kontekst, mendoj se është më se e drejtë që ata pas kursit që do të bëhet, natyrisht kështu është thënë, zoti Ministër, e rifitojnë këtë. Është ndryshe për kategori të tjera, që e fillojnë praktikën me kurrikulat fillestare, që do të kenë gradën e inspektorit ose të kryeinspektorit. Jam kundër këtij mendimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Ministër, kemi një prononcim tjetër?

Sandër Lleshaj – Jo, për këtë çështje, siç e theksova, ky është neni kyç, i cili ka për qëllim të plotësojë mangësinë që kemi për nënkomisarët. Në qoftë se ndjekim linjën normale, siç ju thashë, të promovimit, do të na duhen pesë vjet për ta mbushur këtë. Nëse ne duam ta hapim këtë kanal unë po ju them se ka praktika të tjera. Atyre që vijnë nga universitetet dhe që plotësojnë kritere të larta akademike, e të tjera me radhë, mund t'ju jepet një gradë më lartë. Për shembull “Doktor”. Megjithatë analogjia asnjëherë nuk është e duhura.

Në ushtrinë amerikane “doktorët” vijnë nga universiteti, bëjnë një kurs dhe menjëherë marrin gradën kapiten. Ky nuk është argument për diskutimin e sotëm, por po e përmend për analogji.

Ne duhet t'i marrim dhe t'i besojmë nënkomisarët. Së dyti, duhet të marrim më të mirët. Sot kemi qindra ushtarë me diplomë universitare në ushtri. Kjo për arsye të ndryshme.

Fakti që i kemi në patrullë të përgjithshme nuk është ndonjë rast i lumtur për mua, sepse janë njerëz që kanë shpenzuar katër vjet dhe pastaj futen në një nivel për të cilin nuk janë. Kjo është çështje tjetër. Unë mendoj se kjo është thelbësore dhe i kërkoj zotit Ndreu që ta mbështesë këtë rast.

Pjerin Ndreu – Unë kam një problem. Për shembull, nëse do të marrim ekonomist, në konkurrim për ekonomist mund të vij një ekonomist që ka dhjetë vjet punë, sepse nuk e ndalon dot, mund të vij një që ka pesë, mund të vij edhe një që sapo ka dalë nga bankat e shkollës. Mendoj se nuk është normale që të dalin në punë të gjithë njësoj. Duhet të vëmë edhe një kriter përvojë në punën që ka. Nëse ai hyn në Akademi fillimisht si student, atëherë duhet të unifikohet me gradën që marrin vetë studentët e Akademisë 3-vjeçare në momentin që dalin nga Akademia. Çfarë marrin? Nënkomisar marrin? Dalin nënkomisar? Atëherë jemi në rregull dhe jam gabim unë. Tërhiqem.

Ermonela Felaj - Fitoi e drejta.

Vullnet Sinaj – Punonjësit e Policisë së Shtetit që kanë mbaruar shkollën e lartë dhe nuk e kanë gradën komisar, por janë inspektor, a kanë të drejtë të aplikojnë për të hyrë në Akademi?

Sandër Lleshaj – Të drejtën për të aplikuar do ta kenë të gjithë ata që do të plotësojnë kriteret e veçanta që do të vendosen nga Akademia. Ne do të synojmë të vendosim kritere selektive të forta: notë mesatare mbi 8, të vendosim nivelin e gjuhës angleze. Pra, do të ketë një karakter selektiv të madh për të siguruar një cilësi të re që na

munjon. Vetëm për procesin e kapitullit 24, në kuadrin e negociatave me Bashkimin Europian, duhet të lexojmë, të përkthejmë, të kuptojmë, të analizojmë dhe të transpozojmë qindra mijëra faqe dokumente. Këtë punë do ta bëjmë me njerëz, të cilët, për hir të së vërtetës, nuk janë të gjithë brenda strukturës. Na duhen shumë kapacitete. E përmenda edhe çështjen e gjuhës së huaj.

Mund të tingëllojë pak si jo e përshtatshme, por policia e sotme dhe e nesërme duhet që të ketë cilësi të re edhe në këtë fushë. Për shembull, kemi fluks të madh turistik. Në Shqipëri vijjnë pa fund turistë, ndeshen me policët tanë, duan të paguajnë një gjobë, duhet të pyesin për një adresë, por nuk komunikojnë dot. Nuk dua të futem në këto çështje sot, sepse nuk dua t'ju tu marr kohën dhe vëmendjen. Na duhet cilësi e re.

Për sa i përket pyetjes suaj, zoti Sinaj, të gjithë mund të konkurrojnë me kusht që të kapërcejnë barrierat cilësore të vendosura në hyrje.

Ermonela Felaj – Zoti Sinaj është dakord me një cilësi të re që rregullon përmbajtjen.

Ju ftoj të votojmë nenin 5 të projektligjit, që, në fakt, duhet të rinumërtohet, sepse propozon ndryshime në nenin 38, sipas vërejtjeve dhe diskutimeve që bëmë deri tani. Kush është dakord? Faleminderit! Kundër dhe abstenime nuk ka.

Kalojmë në nenin 6 të projektligjit që gjithsesi duhet të rinumërtohet.

Ky nen propozon ndryshime në nenin 40 të ligjit për Policinë e Shtetit, “Pranimi në funksione të veçanta”. Në pikën 4 të këtij neni të ligjit aktual, në rastin që pranohen persona nga jashtë Policisë së Shtetit, është vendosur një limit në raport me numrin organik të përgjithshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit. Limiti aktual është 1% e limitit të përgjithshëm organik të Policisë së Shtetit. Për nevojat që ministri parashtroi në fjalën e tij hyrëse, por edhe gjatë dhënies së përgjigjeve për pyetjet që drejtuan kolegët e Komisionit të Sigurisë, propozohet që limiti të rritet nga 1% në 3% e totalit organik të Policisë së Shtetit.

Cili është opinionimi i kolegëve? Ka pyetje apo vërejtje?

Vazhdojmë me votimin e këtij neni? Kush është dakord me këtë nen? Kundër dhe abstenime nuk ka. Votohet edhe ky nen.

Ndërkohë, neni tjetër, që propozohet nga Ministria e Brendshme, është neni 40\1, që bën fjalë për pranimin në funksione të veçanta, me titull “Pranimi nga radhët e Forcave të Armatosura”. Këtu parashtrohet kërkesa që për plotësimin e nevojave të veçanta mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së

Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të nenit 38 të këtij ligji. Vijnë ky nen me disa paragrafë me 6 paragrafë.

Përpara se të kalojmë në votim i ftoj kolegët që në rast se kanë diskutim, ta bëjnë. Meqenëse jam munduar të integroj qëndrimet që ka ky komision, po i paraprij me një propozim që të mos e marrë fjalën dy herë.

Meqenëse tanimë ne e kemi në ligj një nen, siç është neni 40, që lejon pranimin në funksione të veçanta dhe unë thashë që është mbështetja ose justifikimi më i mirë ligjor që ju keni për propozimin që sillni, u sugjeroj kolegëve që pas nenit 40 të vendosim nenin 40\1, por jo me titull “Pranimi nga radhët e Forcave të Armatosura”. Kjo për të qenë të qartë që ka një pranim në funksione të veçanta nga jo policët dhe jo ushtarakët, por ka edhe një pranim për ushtarakët. Pra, këto janë dy resurset nga ku marrim burime të reja për nevojat që ka Policia e Shtetit. Pra, marrim civilë, marrim edhe ushtarakë që lirohen nga Forcat e Armatosura. Limiti është 3% e limitit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Pra, brenda këtij numri janë të dyja.

Të diskutojmë në parim për këtë pikë, bëjmë pyetje dhe pastaj do të bëj edhe një ndërhyrje tjetër.

Ka ndonjë mendim nga kolegët?

Pjerin Ndreu – Unë mendoj se për të shmangur çdolloj keqkuptimi, por edhe për të shuar mendimin negativ që mund të ketë dikush në forcat e policisë, ne duhet ta përcaktojmë se ku. Unë mendoj që ta bëjmë nen të veçantë, por edhe mund ta fusim në një pikë tjetër brenda nenit 40. Neni 40 thotë që pranohen për funksione të veçanta. Unë mendoj se ne duhet t'i shtojmë një pikë ose të bëjmë nenin 40\1. Unë kam këtë ide, dikush ka një ide tjetër, prandaj duhet të bashkëpunojmë. Për rastet e pranimi nga Forcat e Armatosura, pranimi të bëhet në respekt të nenit 167 të Kushtetutës dhe me marrëveshje midis Ministrit të Mbrojtjes dhe atij të Brendshëm. Këtu duhet të shtojmë një pikë “a”: Pranimi të bëhet për funksione që kanë lidhje me Policinë Kufitare, Forcat Speciale dhe sektorët ndihmës që kërkojnë kualifikime të veçanta dhe që përshtaten me shërbimet e mësipërme.

Ekuivalentimi i gradave ushtarake me ato policore të bëhet para marrjes së funksionit. Është krejt normale që duhet të bëhet ekuivalentimi dhe pastaj të merret funksioni. Unë mendoj se kaq i fokuson edhe turbulencat e diskutimeve. Ata që vijnë e përgatiten për të dhënë kontribut në ata sektorë ku, në fakt, ne kemi nevojë dhe kur ka ngjashmëri, mund të përshtaten shpejt. Në këtë mënyrë nuk krijojmë turbullirë në Policinë e

Shtetit për ata që thonë se do të hyjnë në Policinë Kriminale apo në Qarkullimin Rrugor. Në fakt, nuk është normale që të integrohen në këto shërbime, që janë shërbime specifike të tjera, të cilat kërkojnë tjetër lloj tjetër kualifikimi, sikur ju mendoni se duhet të profilizohen. Ky kontingjent mund të shkojë te këta sektorë dhe nuk ka asgjë të keqe që t'i sistemojmë.

Ermonela Felaj – Zoti Ministër, keni nevojë ta përsërisim edhe një herë propozimin e zotit Ndreu, që edhe ju të merrni kohë për t'u përgjigjur?

Sandër Lleshaj – Jo, e kuptova. Referenca me Kushtetutën është e panevojshme për arsye se i gjithë ligji është në referencë të Kushtetutës. Kjo është e thënë specifikisht që ata janë pas lirit nga Forcat e Armatosura. Do të thotë që ata që vijnë në Policinë e Shtetit do të jenë të shndërruar në civilë. Përmendja e Kushtetutës, që u përmend edhe nga dikush tjetër, edhe në pikëpamje teknike nuk besoj se do të ishte e nevojshme.

Ermonela Felaj – Një ligj më i ulët nuk referon te një ligj më i lartë.

Sandër Lleshaj - E dyta, të bëhemi akoma më specifikë për të përcaktuar një fushë më të ngushtë ku mund të angazhohen ushtarakët e Forcave të Armatosura. Nuk kam ndonjë gjë në princip. Meraku që të adresojmë shqetësimet e ndokujt brenda policisë që po vijnë këta e po na marrin postet nuk më duket shumë i përshtatshëm si argument. E di që mund të ketë shqetësime, por janë të paarsyeshme për arsye se, siç ju thashë, këtu bëhet fjalë për nevoja të veçanta. Ju gjykoni vetë.

Pjerin Ndreu – Unë thashë se mbi bazën e specifikës së formimit të tyre ata mund të integrohen në tre sektorë. Në qoftë se do që të krijosh një impakt shumë pozitiv, mund t'i dërgosh të përcaktuar në sektorët ku ata, për shkak të shkollimit, formimit e të karrierës mund të integrohen shpejt.

Për Policinë Kufitare ne e kemi pasur praktikë që e kemi marrë nga Akademia Tokësore dhe nuk shpikim ndonjë gjë të re. Është një praktikë e kahershme dhe zakon yni që e kemi pasur. Edhe për Forcat Speciale, në fakt, shumicën atje e kemi marrë. Edhe specialistët e Xhenios aty i kemi marrë. Nuk i kemi diskutuar. Për shkak të asaj ne do ta fokusojmë ashtu sikurse adresojmë ekonomistët të krimi ekonomiko-financiar. Është e njëjta logjikë. Ne do t'i adresojmë aty ku ata mund të integrohen dhe kanë impakt. Nëse ne e lëmë të hapur, një drejtor i përgjithshëm, që e ka për detyrë apo një drejtor qarku mund t'i propozoj dhe bëjë shefa krimesh që nesër dhe ne ligjërisht nuk e pengojmë dot. Kur të fillojë në sistemin e karrierës dhe gradave, që të plotësojë kushtet, atëherë po mund të

ngjitet, por për momentin mund të fillojë karrierën në këta sektorë specifikë dhe është krejt normale.

Ermonela Felaj – Po, zoti Braho. Pastaj zoti Sinaj dhe më pas zoti Qefaliaj.

Spartak Braho – Unë ju thashë edhe dje në takimin informal që bëmë që ne diskutojmë për integrimin e njerëzve që punojnë në dy struktura të sigurisë kombëtare, siç janë Forcat e Armatosura dhe Policia e Shtetit. Pra, jemi brenda strukturave të Sigurisë Kombëtare. Madje, më duket se kemi lejuar më sipër që mund të rekrutohen edhe nga shërbimet e tjera të sigurisë kombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vijnë nga Shërbimi Informativ?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha marrëdhëniet e punës do të ndërpriten. Mund të vij një specialist nga Shërbimi Informativ?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vij.

Kështu që, të gjithë e pranojmë faktin që të gjithë mund të rekrutohen pasi të lënë detyrat. Ai nuk është as oficer ushtrie, as punonjës i SHIK-ut dhe as i ndonjë shërbimi tjetër, që vjen me gjithë atë ngarkesë profesionale që ka dhe futet në Policinë e Shtetit. Të gjithë duhet të lirohen, të dorëzojnë detyrat dhe më pas të rekrutohen në Forcat e Policisë.

Nuk është shumë etike të thuash “Pranimi nga radhët e Forcave të Armatosura” ose ashtu siç u propozua këtu nga kryetarja që të integrojmë dispozitën 40/1 ose aty ku thotë Pjerini ose aty ku mendoni ju që ta integrojmë te neni 40. Në tërësi unë jam dakord me të gjithë përmbajtjen e mëposhtme të ligjit. Jam kundër mendimit që të jetë nen i veçantë i titulluar “Pranimi nga radhët e Forcave të Armatosura”, nuk është real.

Ermonela Felaj – Ju lutem!

Jam dakord, por dua të fokusojmë edhe një herë problemin që ngre zoti Ndreu dhe, nëse mundemi të eksplorojmë .. të përbashkët, do të ishte mirë. Shqetësimi që ngriti kolegu ka të bëjë me faktin se duke mos u përshkruar në ligj .. të veçanta për rekrutimin e ushtarakëve në Policinë e Shtetit, sepse këto përshkruhen në fjalën e ministrit, por jo në ligj. Nëse arrijmë të parashikojmë qoftë edhe në mënyrë të përgjithshme këto nevoja unë mendoj se mund të garantojmë nivelin e duhur të ligjshmërisë për përthithjen e komponentit ushtarak në struktura që ne e dimë se janë të projektuara edhe te civilët, pra punonjësit e policisë kanë statusin e nëpunësit civil, merren dhe ndërveprojnë me civilët. Problemi është i

thjeshtë që këta do të bëjnë një kualifikim të përsheptuar në Akademinë e Policisë që normalisht nuk ka nevojë të bëjnë 3 vjet shkollë sepse e kanë shkollën e lartë dhen janë pjesë e njerëzve që janë nga siguria. Ata do të përqendrohen te rendi dhe te siguria publike që është një degë më e vogël e sigurisë kombëtare. Sidoqoftë, njerëzit që punojnë në këtë fushë kanë një përgatitje tjetër sepse janë civilë dhe ndërveprojnë me civilët dhe e njohin legjislacionin që ka lidhje me këtë pjesë. Meraku ky është , ata do të rrijnë për një kohë të shkurtër në Akademinë e Policisë për t'u trajnuar rreth 6 muaj dhe do të futen për të plotësuar nevoja të veçanta, por deri ku do të shtrihet kjo? Mendoj se ka një ndërhyrje.

Ismail Shehu – Zonja kryetare, për një sqarim!

Duke qenë se nenet 2 dhe 3 kanë rënë, në asnjë pjesë nuk përmenden organet e tjera të sigurisë kombëtare. Ndoshta duhet që komisioni ta adresojë ose të gjejë një zgjidhje.

Ermonela Felaj – Nuk ishte ky shqetësimi që kemi, por nëse mund të na ndihmojë këshilltari.

Ç'mendon zoti Sinaj?

Vullnet Sinaj – Për punën e ushtarakëve që diskutohet të hyjnë në polici dhe a do të përshtaten apo jo, historia ka treguar se gjithmonë kanë shkuar ushtarakë në polici dhe ata janë përshtatur shumë mirë edhe në pozicione drejtuese edhe në detyrat që kanë kryer. Të mos harrojmë asnjëherë se u nisëm nga fjala e ministrit të Brendshëm, i cili tha për nevojat emergjente që ka për të zëvendësuar postet dhe ushtarakët mund t'i zëvendësojnë këto poste në mënyrën më të shpejtë. Nuk e di se sa urgjente është . A mund t'u bëhet një kurs kualifikimi 1-2-mujor këtyre ushtarakëve paraprakisht? Nuk ka asnjë gjë dhe nëse ne marrim studentë që kanë mbaruar Masterin dhe u japim titullin nënkomisar për 1 vit,

atëherë si nuk u bëka polic ky oficer që ka shërbyer 5-10 vjet në ushtri? Ky nuk është problem, është problem i zgjidhur.

Pjerin Ndreu – Një minutë se nuk jemi kuptuar!

Nuk bëhet fjalë, se oficer policie quhet ai edhe aty ku është . Ata janë sektorë të policisë. U bë një përkufizim ndarjeje edhe në nenet që sapo miratua. Thamë: Policia Kriminale, Policia e Kufirit dhe Policia e Rendit dhe e Emigracionit. Janë qartësisht të ndara funksionet policore që nga A-ja deri te Zh-ja. Këtu nuk shtrohet problemi në bëhen apo nuk bëhen policë, por mendohet që për shkak të formimit që kanë të shkojnë aty ku duhet. Ndoshta mbas 10-15 vjetësh mund të bëhen drejtues. Në qoftë se duan të bëjnë karrierë, nuk i ndalon njeri se në një nga kta sektorë mund të bëhen. Mund të jenë oficer kufiri dhe të bëhesh drejtor. Këtu nuk ka asnjë gjë të keqe. Mund të jesh oficer rendi dhe nuk do jesh

edhe oficer krimesh dhe nuk e ka ndalur njeri sistemin e karrierës. Është tjetër gjë karriera, tjetër gjë profesioni dhe mundësia për të kontribuar më shumë. Është krejt e natyrshme dhe normale, që ne ta specifikojmë... për ta keqpëdorur këtë.

Ermonela Felaj – Më falni!

A mund t'ju ndihmoj me një ndërhyrje paraprake dhe ndoshta e gjejmë gjuhën? Kuptohet pse janë meraket. Më mirë le ta bisedojmë shtruar që t'i ezaurojmë të gjitha dhe të bëjmë atë që duhet. Pranimi për ushtarakët e shërbimit aktiv që do të lirohen nga FA-ja për t'u futur në Policinë e Shtetit, natyrisht që bëhet mbi bazën e një marrëveshjeje. Aty do të përcaktohen edhe kuotat edhe struktura ku do të pranohen. Po nëse e shtojmë në marrëveshje që aty do të përcaktohet kuotat, strukturat dhe funksionet ku do të shkojnë, sepse po marrim ushtarakë aktivë që do të lirohen nga FA-ja dhe ka rëndësi që të mos cenohet edhe integriteti i FA-së. Pra, Ministria e Mbrojtjes do të ketë pjesën e vet të kujdesit. Ju keni nevojat tuaja që do t'i diskutoni me Ministrinë e Mbrojtjes. Meraku im është që do të kemi vështirësi në gjetjen e një termi të përgjithshëm të nevojave të veçanta., sepse këto nevoja do të diskutohen mes jush dhe ministrit të Mbrojtjes i cili do të bëjë kujdesin e vet dhe ju do të përpiqeni (siç e mendoj unë realizimin e marrëveshjes) që të realizoni nevojat tuaja. Nëse bën këtë, a na e zgjidh kjo problemin? Ky është sugjerimi që kam.

Sandër Lleshaj – Zonja kryetare,

Nëse i referohemi nenit 40 siç është sot ai ofron një rrugë për të marrë nga .. speciale dhe nuk i specifikon se ku do të shkojnë. Pra, një ekonomisti i thotë të bëhet polic në Policinë e Shtetit dhe nuk i thotë se ku do të shkojë, pra nuk e ka kufizuar si ponë. Unë them se po e kufizuar do të ketë probleme në implementim nesër.

Jam dakord me propozimin tuaj që në marrëveshje të përcaktohet edhe vendi se ku do të shkojë sepse këta nuk do të lëvizin lirisht.

Xhemal Qefalia - Zonja kryetare,

Kisha edhe unë diçka. Gjëja ku jemi stopuar për mendimin tim është nonsens pasi është shumë e thjeshtë. Ne e kemi vënë kufizimin 3%. Duke vënë këtë prag, është përcaktuar numri (gati 200 veta se 100 janë atje). Te ky 3% nuk janë të gjithë nga FA-ja, sepse do të ketë nga IT-ja, nga financa etj. Pra, shkon gati në 2%. Përveç kësaj kemi vënë kufizimin tjetër për të hequr edhe merakun tjetër që ka kolegu dhe punonjësit e policisë. Kemi thënë se këta që do të vijnë do të jenë me grada "Nënkomisar" pra nuk do të kërcënojnë këta që janë me grada karriere. Unë mendoj se këto dy gjëra nuk përbëjnë sens për ta ndryshuar dhe për t'i specifikuar se po i specifikuar kështu nuk kemi bërë asgjë.

Ermonela Felaj – Çfarë detyre mund të kryejë një punonjës me gradën “Nënkomisar”?

Të mos harrojmë që këta ushtarakë që do të lirohen nga FA-ja për të shkuar në Policinë e Shtetit, nuk po kalojnë për 1 apo për 2 muaj, por do të kalojnë përgjithmonë, kështu që nuk mund të mbahen edhe je, edhe s’je brenda policisë. Ta ruajmë edhe këtë logjikë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima - Zonja kryetare,

Te pika 3 e ke: “Në çdo rast, pranimi sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet pas nxjerrjes në lirim të ushtarakëve...”.

Pjerin Ndreu – A ta bëj një sqarim?

A ka mundësi të jemi më të përgjegjshëm dhe të mos flasim me terma sepse këtu nuk jemi në mallin e babës të cilin duam ta ndajmë si duam ne?

Ne nuk kemi xhelozë për ndonjë. Mbani qëndrim dhe mos ta prishim fare komisionin. Ne kemi ardhur në këtë komision për të diskutuar një projektligj për Policinë e Shtetit dhe jo për FA-në e Republikës së Shqipërisë.

Kush mendon se ne mund ta bëjmë çorap Policinë e Shtetit që të futen njerëzit ku të duan dhe si të duan, kjo nuk do të lejohet. Ata që vijnë në Policinë e Shtetit do të shkojnë të profilizuar që të ngjajnë me profesionin që kanë. Nëse doni t’i merrni dhe t’i çoni si të doni në Policinë e Shtetit ashtu siç është bërë dikur, atëherë kjo do të thotë t’i vësh minat policisë dhe ta hedhësh në erë. Të mos flasim për përqindjen, se është një bonus që ia kemi dhënë ne që do të specifikohet se ku . Ka një traditë dhe disa sektorë ku ata mund të japin kontribut të drejtpërdrejtë dhe mund të përfitojnë edhe shumë punonjës me gradën “Nënkomisar”. Shumë punonjës të krimit ekonomik dhe financiar për çfarë i marrim? I specifikojmë ekonomistët për krimin ekonomik dhe financiar dhe nuk ka asgjë të keqe pse duhet të specifikohet. Të mos bëjmë insinuata këtu sikur ky apo ai. Policët e Shtetit kanë të drejtë. Si kujtoni ju?

Ata kanë një shkollim dhe një karrierë të gjatë aty. Çfarë i kujtoni ju policët? Ata rropaten çdo ditë për të kapur kriminelët dhe duhet të konkurrojnë me këdo. Unë kam respekt për ushtarakët për profesionin e tuaj. Merre një oficer policie dhe çoje komandant në FA dhe shikoje se çfarë sensibiliteti ka. Ne po u hapim rrugën që të hyjnë, të shkollohen dhe të integrohen aty ku ata mund të japin kontribut, por jo kudo në Policinë e Shtetit, se është e pamundur. Janë sektorë delikatë. Lufta kundër krimint s’mund të bëhet nga kushdo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Kolegë, që mos të përsërisim njëri-tjetrin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Të mos e ngecim diskutimin! Ndërkohë, kërkoj që edhe ju të mund të reflektoni nëse ka ndonjë mënyrë për ta riformuluar këtë nen apo nuk ka.

Xhemal Qefalia - Zonja kryetare,

Kjo është e zgjidhur dhe unë po habitem pse po harxhojmë energji.

Ermonela Felaj - Ju lutem!

Mos flisni pa mikrofon, kolege!

Ju lutem!

Sander Lleshaj – A mund të përgjigjem se kjo është fare e thjeshtë?

Është thënë se cilat janë nevojat e veçanta: Ato janë nevoja të cilat nuk prodhohen nga Akademia e Sigurisë. pra asnjë ushtarak nuk mund të çohet në një funksion, i cili prodhohet nga Akademia e Sigurisë. Është fare e thjeshtë dhe elementare dhe nuk ka nevojë të shtojmë asnjë fjalë.

Nëse Akademia e Sigurisë prodhon policë kriminalë, ne nuk mund të marrim nga ushtria për të bërë policë kriminalë apo policë rendi. Këtu bëhet fjalë për funksione që nuk prodhohen nga Akademia e Sigurisë. Nuk ka nevojë për asnjë ndërhyrje. Po harxhojmë kohën kot. Si të doni.

Ermonela Felaj - Nëse është kështu mund ta formulojmë në këtë mënyrë:

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem më dëgjoni me vëmendje, sepse duhet të biem në një konsensus dhe nuk mund të kundërshtojmë vazhdimisht!

“Për ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura, pranimi realizohet me pëlqimin e ushtarakut dhe mbi bazë marrëveshjeje dypalëshe, ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, ku përcaktohen kuotat, strukturat dhe funksionet e veçanta ku do të pranohen, të cilat do të jenë ato që nuk ofrohen nga Akademia e Sigurisë.

Sander Lleshaj – Ajo që nuk janë nga Akademia e Sigurisë është thënë më lart. I bie ta themi 2 herë.

Ermonela Felaj – Ta themi këtu që të jetë i kënaqur edhe zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Atëherë, të biem dakord që kjo të integrohet te neni 40 jo te neni 40/1, që të ndiqet logjika e pikës së parë dhe të mos lemë shteg për asnjë lloj diskutimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të shtojmë një pikë te neni 40 që kjo të integrohet te ky nen.

Ermonela Felaj – Dakord.

Besoj se jemi të qartë me formulimin e kësaj pike. Vendosja e saj nuk ka të bëjë me përmbajtjen, pavarësisht se duhet të respektojmë edhe disa rregulla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se e arritëm mirëkuptimin për përmbajtjen e saj.

Sandër Lleshaj – Përkufizojini më lart funksionet e veçanta dhe thoni ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja kryetare,

Te përkufizimet e ligjit për Policinë e Shtetit të përkufizojmë se çfarë quhen “funksionet e veçanta”. Aty të themi që funksionet e veçanta janë ato funksione të cilat nuk prodhohen nga Akademia. Automatikisht kështu, u mbyllet dera të gjitha shqetësimeve që ka zoti Ndreu, sepse e shoh që ai ka shqetësime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjerin Ndreu – Unë po ju them se nuk është vetëm shqetësimi im, por këtë shqetësim e ka e gjithë Policia e Shtetit. Kemi me qindra sms të policëve të Shtetit që janë të shqetësuar për këtë punë. Nuk duhet të bëjmë gjëra që janë në dëm të Policisë së Shtetit, por duhet të bëjmë gjëra që janë në favor të Policisë së Shtetit. Ne e hapëm rrugën, nuk është se nuk e hapëm. Nëse nuk do ta kishim hapur rrugën, atëherë do të na thoshin që nuk jemi në terezi. Ne e hapëm rrugën, por rruga duhet të hapet aty ku mund të japin kontribut.

Ermonela Felaj – Dakord. Ministri sapo bëri një propozim të ri, i cili ndoshta është një propozim i mirë. Pika 2 e nenit që ishim duke diskutuar (40/1 që do të hyjë te neni 40 për pranimin në funksione të veçanta), se deri këtu jemi tani, të thuhet që në marrëveshjeje ndërministrore të përcaktohen kuotat, strukturat dhe funksionet e veçanta ku do të pranohen dhe, sipas propozimit që bëri ministri, te përkufizimet e ligjit për Policinë e Shtetit të përkufizojmë se çfarë quhen “funksionet e veçanta”. Aty të themi që funksionet e veçanta janë të gjitha ato funksione, të cilat nuk prodhohen nga Akademia e Sigurisë. T’i fusim te neni 6 si pika 32. Jemi dakord, që të jemi korrekt dhe të mos bëjmë përshkrime në ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi dakord?

Po, zoti Shehu.

Ismail Shehu - Jemi dakord. Kemi diçka në aspektin e teknikës për këtë pikë. Të përcaktohen jo vetëm funksionet e veçanta ku do shkojnë në Policinë e Shtetit, por edhe strukturat nga të cilat do të merren këta ushtarakë, sepse te marrëveshja do të përcaktohen jo vetëm funksionet e veçanta ku do të shkojnë, por edhe strukturat nga të cilat do të merren, sepse nuk mund të merren nga çdo strukturë e Forcave të Armatosura. Pra, kjo duhet të përcaktohet, te riformulimi duhet të kihet pak kujdes që të tregojë të dy këta elemente, në mënyrë që edhe ne të dimë se nga do të ikin, por edhe se ku do t'i çojmë.

Ermonela Felaj - Këtë mundësi e keni te marrëveshja, se ligji “Për Policinë e Shtetit” nuk mund të merret me pjesën që i takon Ministrisë së Mbrojtjes.

Po i kthehemi pikave që të saktësojmë çdo moment. Në pikën e parë thuhet: “Për plotësimin e nevojave të veçanta mund të pranojmë në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të nenit 38 të këtij ligji”.

Tërheq vëmendjen që pika 2 e nenit 38 përcakton kriteret për Akademinë, ndërkohë që kriteret për Policinë e Shtetit janë në nenin 40/1 të ligjit aktual. Nuk janë saktësisht njëlloj kriteret e nenit 38/2 me kriteret e 40/1, për sa kohë ne po i fusim në Policinë e Shtetit, unë mendoj se duhet të plotësohen këto kritere si fillim të 40/1, a mund t'i shikojmë dhe të saktësojmë se cilin do të mbajmë? Do të mbajmë 38/2-shin apo 40/1 –shin?

Sandër Lleshaj - A mund të shtoj diçka. Neni 40/1-shi flet për funksionet e veçanta, flet për juristë, ekonomistë, informaticienë që merren dhe futen direkt, marrin gradat e funksionit ku shkojnë. Pra, nëse sot kemi një funksion për IT-në, që e ka granden kryekomisar, ai vjen nga fusha civile ku punon si informaticien dhe bëhet kryekomisar direkt. Kjo nuk është e aplikueshme në këtë rast, sepse ne nuk duam të bëjmë këtë gjë.

Ermonela Felaj - I marrim kriteret me radhë?

Thamë që këtë do ta lëmë te funksionet e veçanta. “Të jetë shtetas shqiptar”, është një kriter që është në rregull për ju. “Të mos jetë i përjashtuar nga policia”, këtu duhet të reflektohen edhe institucionet e sigurisë, ose të jetë laruar nga shërbimi civil”. “Të ketë zotësi të plotë për të vepruar”, është në rregull. “Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën”. “Të ketë përfunduar arsimin e lartë përkatës”. “Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në fushën përkatëse”. Më thoni nëse ky element ju duhet apo jo?

Pastaj vjen, mosdënimit dhe dëshmia e aftësisë. Këto janë kriteret.

Sandër Lleshaj - Këto kriterë janë bërë për një kategori të caktuar specialistësh të lartë, që do të vijnë dhe do të kenë eksperiencë pune. Ne këtu mund të kemi nevojë që të marrim edhe një nga Forcat e Armatosura, që nuk është oficer, por mund të jetë me gradat e nënoficerit, në nivelin e inspektorit, të forcat speciale apo diku tjetër. Kjo e kufizon. Ne duam të marrim grada të ulëta në thelb. Prandaj është vënë në referencë vetëm ajo e Akademisë.

Ermonela Felaj - Po i lexoj edhe kriteret e nenit 38.

“ Të jetë shtetas shqiptar”. Të mos jetë përjashtuar nga policia, apo të jetë larguar nga shërbimi civil”. “ Të ketë zotëri të plotë për të vepruar”. “Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën”. “Të ketë mbaruar arsimin e mesëm”. “ Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur”. Në fakt, juve ju duhet arsimi i lartë.

Sandër Lleshaj - Jo, domosdoshmërisht i lartë.

Ermonela Felaj - “Të mos jetë dënuar me vendim gjykatë”. “Të ketë dëshminë e aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B”. Ajo që është plus, është që të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë. Ky është ai që shikoj unë si ndryshim të kriteret që ka neni 40/1-shi dhe 38/2-shi, por meqenëse ato janë kriterë për akademinë dhe këto janë kriterë për pranimin në funksione të veçanta, gjykova se cilat kriterë jua përmbushin juve më mirë nevojat.

Sandër Lleshaj - Kriteret e akademisë janë më të gjera se sa policia. Kriteret e akademisë na e zgjidhin problemin dhe nuk na krijojnë ngërçin me eksperiencën 5 vjet.

Ermonela Felaj - Dakord. Nuk besoj se kemi ndonjë mendim tjetër për këtë pikë. Mund ta lëmë kështu.

Pika 2. Përveç atyre që diskutuam se çfarë do të përcaktohet të marrëveshja. Kam një propozim, të thuhet: “Për ushtarakët e shërbimit” aktiv, pranimi i realizohet mbi bazë pëlqimi dhe marrëveshje dypalëshe.

Pse ka rëndësi pëlqimi, se e kemi bërë këtë diskutim? Ka shumë rëndësi, sepse ato janë struktura të qëndrueshme që ne me ligj u kemi garantuar qëndrueshmërinë në detyrë, u kemi garantuar statusin dhe të gjithë afektet që rrjedhin. Pse e vëmë? Është e njëjta gjë siç bëhet për gjyqtarët dhe prokurorët në Kushtetute, ku thuhet: “Nuk lëvizin pa pëlqimin e tyre”. Shtojmë fjalën “pëlqimin” në përmbajtje dhe ndërkohë për të hequr çdolloj merakut që kanë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes. Sugjerim e kam, më thoni po ose jo. Thjesht po mendoja se ia vlen ta bëni këtë gjë. A mund të vëmë një pikë ët tilla, ku të themi:

“Pranimi i ushtarakëve të shërbimit aktiv në Policinë e Shtetit, do të realizohet duke respektuar parimet bazë të organizimit dhe të funksionimit të Forcave të Armatosura dhe drejtimit dhe komandimit të tyre”.

Sandër Lleshaj – Është shumë deklarative dhe nuk na jep asgjë konkrete në këtë aspekt. Ku është qëllimi i kësaj për ta shtuar?

Ermonela Felaj – Nuk e mbarova. Më toni : a ia vlen ta shtojmë apo jo? Ne po marrim ushtarakë aktivë, po i lirojmë nga FA-të, po të gjithë këtë proces, do ta bëjmë duke respektuar disa parime, parimin demokratik të kontrollit dhe të drejtimit civil të FA-ve, ruajtjen e operacionalitetit dhe të garancisë së FA-ve, se vetë ju më thatë, se edhe ne do të mendojmë se cilët ushtarakë duhet të kalojnë statusin e ushtarakut dhe garancitë themelore të ushtarakut, që është shumë e rëndësishme që një njeriu që vjen nga njëra strukturë në tjetrën t’ia garantojmë te paga të gjithë vjetërsinë dhe gradën, si edhe kuptimi i drejtë i rolit të ushtarakëve aktivë përkundrejt atyre jo aktivë. A ka kuptim ta vëmë, a na shton vlerë? Unë mendoj se po. Nëse ju nuk e mendoni kështu, nuk e vëmë.

Sandër Lleshaj – Meraku ynë ishte për ruajtjen e viteve të punës e të tjerë. Vjetërsia njihet, sepse është një ligj kuadër nr.10142 që Policia, Forcat e Armatosura, Shërbimi Informativ e të tjerë trajtohen njëllë, pra u njihen vitet e punës. Ajo që na shqetëson, është një moment i dytë, që nuk do të jetë në ligj është ajo e konvertimit të gradave dhe është për t’u zgjidhur. Por mua në formën e hartuar është e qartë dhe nuk na prish punë. Ajo që kemi merak, te pika e parë dhe te pika e dytë, ndoshta mund të rregullohet edhe te marrëveshja, do të donim që kalimi të bëhej për ushtarakët e shërbimit të përkohshëm, jo të karrierës. Shërbimi i përkohshëm është i ndarë. Këtë qëndrim ia kemi dërguar Komisionit edhe në mënyrë zyrtare.

Ermonela Felaj - Më çove në një pyetje që patëm rastin ta ndanim paraprakisht me ministrin. A mund ta diskutojmë këtë pjesë? A do t’i plotësonte nevojat tuaja të veçanta marrja e ushtarakëve të shërbimit të përkohshëm?

Sandër Lleshaj - Ne mund të vendosim sa të duam këtu kritere dhe mund ta shkruajmë në të gjithë marrëveshjen që do ta bëjë ministri me ministrin në ligj. Në thelb, përderisa është shkruar klauzola që ministri i Mbrojtjes me ministrin e Brendshëm bëjnë një marrëveshje, do të thotë që ministri i Mbrojtjes për të gjitha ato funksione që i konsideron të panevojshme për t’i dhënë, nuk i jep. Nuk shtojmë asgjë, vetëm se e komplikojmë ligjin. Ju bëni si të doni.

Ermonela Felaj - Kolegë, ushtarakë të shërbimit të përkohshëm janë: oficerët me gradë nëntoger, toger, kapiten nënoficerët me gradë, nëntetar, tetar, ushtarët dhe detarët. Këta thotë Ministria e Mbrojtjes janë kategoria dhe ne jemi dakord. Cili është qëndrimi i Ministrisë së Brendshme?

Sandër Lleshaj - Këtë kategori Ministria e Mbrojtjes e përcakton në marrëveshjen që do të bëjë, ajo nuk mund të dalë jashtë interesave të saj. Kjo është e vetëkuptueshme përderisa e kemi lënë klauzolën në marrëveshje. Ne po bëjmë marrëveshjen, nëse do të vëmë detaje.

Ermonela Felaj- Dakord.

Zonja Gjebrea ka një pyetje.

Elona Gjebrea - Kërkoj ndjesë, sepse këtë pyetje e kisha që në fillim, por meqenëse tani jemi në situatën që po flasim për kalime nga strukturat e forcave dhe policia për nevojat që ramë dakord, kam një pyetje për zotin Ministër: neni 49 i ligjit “ Për Policinë” flet për rikthimin në polici, po e citoj: “ Një person mund të rikthehet në polici vetëm pasi ai ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me strukturat e Policisë së Shtetit brenda dy vjetëve të fundit dhe është liruar nga policia për shkurtim të funksionit të kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë”.

Zoti Ministër, a keni menduar një strategji apo ndryshim të këtij neni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Sandër Lleshaj - Për t’u harmonizuar me diskutimin që bëri zoti Ndreu dhe zoti Qefalia, ideja dhe ajo që paraqiti zoti ministër është ide e jona, por edhe e Ministrisë së Brendshme është që të flasim gjithmonë për nivelin e ulët, që ata njerëz mund të japin realisht një kontribut. Prandaj kërkesa jonë ka qenë e tillë, pasi ato grada respektivisht përkojnë me atë lloj kontributi që kërkohet nga ky ligj, që është shtylla kurrizore e ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Nëse bëhet fjalë për ato funksione kur duhet certifikatë, normal që nuk do të shkosh në atë funksion, nëse nuk e merr atë. Po mos të jetë ky si kush përjashtimi nga Policia e Shtetit. Kështu i bie që të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, duhet të aplikojnë për pajisjen me certifikatë sigurie.

Spartak Braho - Lexoi edhe një herë kriteret!

Ermonela Felaj - Po! Neni 46: “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë. Punonjësi i policisë ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga policia”. Kur lirohet janë rastet që kanë të bëjnë me shëndetin, moshën e të tjera.

“Punonjësi i policisë përjashtohet në këto raste: kur dënohet, kur merret një masë disiplinore përjashtimi nga policia, kur ndërpret marrëdhëniet e punës në rastet që ka pika 2, germa “ç”, “d”, dhe e pikës 4, germa” b”.

Spartak Braho - Po pika e fundit?

Ermonela Felaj - Kaq janë.

Këto janë rastet kur dënohet dhe merret masë disiplinore.

Sandër Lleshaj - A të bëj një sqarim? Nuk desha të ndërhyj, por meqenëse ndërhyri zoti Braho, në nenin 38, te kushtet e pranimit në Akademinë e sigurisë ka një pikë 2, germa” f”, që thotë: “ Të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë”. Nëse ne kemi vendosur si kusht hyrje vërtetimin e besueshmërisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...nëse humbet gjatë rrugës besueshmëria, atëherë je në kushtet e konfliktit me kushtin e hyrjes. Kjo është ajo që thotë zoti Braho. Gjykimin e keni ju për këtë pikë.

Ermonela Felaj – Zoti Ndreu, ka një ndërhyrje, por ne e diskutuam edhe dje këtë pikë. Po i rikthehemi.

Pjerin Ndreu – Vlerësimi i besueshmërisë është tjetër gjë, është një dokument që dikur e quanim” vërtetim personaliteti “ që bëhej nga strukturat e policisë bazë dhe ka të bëjë me disa të dhëna ose çfarë ka policia lokale atje për të gjithë rrethin familjar të tij, për personin.

Problemi i DSIK-së zgjidhet me vetingun, një ndër pikat që i nënshtrohet vetingut është raporti i DSIK-së. Pra, është e zgjidhur aty, pse duhet ta dublojmë? Atëherë, hiqe vetingun komplet, lëre vetëm DSIK-në dhe gëzuar! Pra, kjo nuk shkon. Kemi vetingun dhe nuk kemi pse e vendosim këtë fare. E kemi aty, e kemi miratuar ligjin.

Ermonela Felaj - Atëherë jemi dakord që ky propozim të bjerë? Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Vazhdojmë me nenin 9, i cili bën një saktësim te neni 53 lidhur me marrjen e gradave. “Gradat e inspektorit të dytë dhe inspektorit të parë për punonjës të policisë që plotësojnë afatin e qëndrimit në gradë sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, jepen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit mbi bazën e vjetërsisë në punë, funksionit,

trajnimeve dhe kualifikimeve”. Pra, është shtuar fjala “funksionit”. Besoj se kemi dakordësi për këtë.

Pjerin Ndreu – Jam kundër. E para, në dhënien e gradave nuk merret për bazë në asnjë vend funksioni. Funksioni vjen pas gradës. Merret grada, pastaj funksioni. Nuk merret grada për shkak të funksionit. Termi “funksion” aty është i panevojshëm. Në çdo vend në sistemin e gradave merret grada, pas gradës lind e drejta të kërkohet funksioni. Për mua është e tepërt dhe duhet të hiqet.

Ermonela Felaj - Ky është një debat i vjetër, si “veza pulën apo pula vezën”.

Ju lutem, një minutë të dëgjojmë ministrin!

Si do të jepet grada e inspektorit të parë dhe të dytë? Mbi bazën e vjetërsisë, trajnimeve dhe kualifikimeve thotë ligji aktual, ndërsa ju keni shtuar fjalën “funksionit”. A nuk është grada që përcakton edhe funksionin?

(Diskutime pa mikrofon)

Sandër Lleshaj - Pse është shtuar fjala “funksion”? Për arsye se sot vlerësimi i performancës dhe marrja e gardës bëhet bazuar kryesisht në një testim që kryhet në Akademi. Pra, është një testim dhe oficerëve të policisë nuk u çmohet përvoja profesionale. Po jap një shembull, kemi dy komisarë që konkurrojnë për kryekomisar, njëri ka kryer detyra më të vështira, ka një eksperiencë pune më të madhe sesa tjetri. Njëri mund të ketë qenë drejtues komisarati, tjetri ka qenë punonjës zyre. Në përgjithësi në praktikën e gradave në çdo vend çmohet jo vetëm sesa je në gjendje për të marrë pikë në një test, por edhe çfarë ke bërë. Të kreditohet eksperiencia profesionale. Ti ke qenë shef komisarati, ti ke qenë asistent i drejtorit. Keni të njëjtën gradë. Ky që ka qenë shef komisarati do të ketë një pikë plus, ndoshta. Pra, thjesht merret në konsideratë. Këtu nuk i jepet për shkak të funksionit, por i merren në konsideratë funksionet e kryera më parë në vlerësim.

Pjerin Ndreu - Ta ndajmë këtë punë. Është tjetër punë të thuash: “në bazë të funksioneve dhe vlerësimeve që ka marrë në ato funksione” dhe është tjetër gjë të thuhet: “në bazë të funksionit”. Në bazë të funksionit janë dy terma që dallojnë esencialisht nga njëra-tjetra. Pra, për shkak të funksioneve që ka kryer më parë dhe vlerësimeve që ka marrë në ushtrimin e drejtimit në këto funksione, por jo për shkak të funksionit, sepse i bie që të marrë funksionin dhe gradën. Bie ndesh me parimin e marrjes së gradave. Kjo e ka ngatërruar karrierën, i nderuar Ministër, ti e di shumë mirë. Kjo ka ngatërruar karrierën në Shqipëri. Është marrë funksioni dhe më pas është dhënë grada. Për ta qartësuar: “për shkak të

funksiioneve që ka kryer përpara se të vijë te konkurrimi për grada”, pra duhet ta cilësojmë. Në qoftë se tingëllon më qartë...

Ermonela Felaj - Zoti Ministër...

Më fal!

Ky vlerësim nuk është në ligj për çdo lloj grade, kjo është për gradën inspektor i dytë dhe inspektor i parë. Pra, janë grada të ulëta.

Kaq e domosdoshme është ta vëmë funksionin?

Te neni 55, ju kujtoj se ka kriteret të tjera për fitimin e gradës nënkomisar e deri te drejtues i parë. Nuk janë këto kriteret që kemi te 53-shi. Pra, bëhet fjalë për gradën inspektor i parë dhe inspektor i dytë.

(Diskutime pa mikrofon)

Meqenëse kjo nuk e prish thelbin e propozimeve që kishim nevojë, besoj se ndërhyrja e zotit Ndreu do të gjejë mbështetje nga komisioni. Duhet të gjejë mbështetje edhe në respekt të viteve që ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një propozim ligjor bëhet nga një grup pune dhe nuk është një propozim personal.

Atëherë, ky propozim bie.

Kalojmë te pika 1 e nenit 54, që propozon një ndryshim në fitimin e gradës nënkomisar deri në drejtues të parë, ku shtohet se fitimi i këtyre gradave të bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe përfundimi me sukses të programit përkatës të arsimimit dhe trajnimit. Besoj se këtu nuk ka ndonjë gjë që nuk shkon.

Miratohet edhe kjo pikë.

Kush është dakord me nenin 10 të projektit, që normalisht duhet të rinumërohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E gjitha bëhet me qëllim që stafi i komisionit ta zbardhë sipas diskutimeve tona. Mirë do të ishte t’i kalonim shpejt, por nuk e bëjmë dot, se është në seancë. Më vjen keq kolegë, por kemi disa detyrime që nuk mund t’u shmangemi!

Neni 11. Në shkronjën b të pikës 1 të nenit 55 propozohet një ndryshim sipas të cilit punonjësi duhet të përmbushë kriteret për pozicionin e punës dhe të ketë përfunduar arsimin e lartë.

Jeni dakord me këtë propozim? Dakord.

Faleminderit!

Te neni 12 kemi bërë vetëm një ndërhyrje. Shprehja “intervista me gojë”, të zëvendësohet me “intervistë” ose “intervistë verbale”... Me intervistë.

Jeni dakord me këtë?

Po kështu, te pika 3 dhe pika 4 bëhen disa përmirësime. Unë nuk kam vërejtje të depozituara nga anëtarët e komisionit.

Jeni dakord me këto dy pika?

Kush është dakord me nenin 12 të projektligjit, që normalisht do të duhet të rinumërtohet?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 i projektligjit.

Ka vërejtje dhe kundërshtime për këtë nen? Nuk ka.

Miratohet neni 13 i projektit, që...

Vazhdojmë me nenin 14 të projektit.

Edhe për këtë nen nuk shoh të ketë vërejtje dhe diskutime.

Miratohet neni 14.

Kalojmë te neni 15.

Ka vërejtje për nenin 15? Nuk ka.

Miratohet edhe ky nen.

Neni 16. Te neni 16, i cili lidhet me masat disiplinore, ne si anëtarë të këtij komisioni kemi diskutuar dhe e kemi gjetur të pavend që punonjësit të policisë, në një rast disiplinimi, t’i mbahet 1/3-ta e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj.

Nuk e di nëse ka një konsideratë të re nga ana e Ministrisë së Brendshme, apo kjo nuk është thelbësore?

Sandër Lleshaj – Në këtë çështje jam në rezonancë të plotë me ndjeshmëritë tuaja, të nderuar deputetë.

Ermonela Felaj – Dakord.

Faleminderit për tolerancën!

Sandër Lleshaj – Në fakt, është i vetmi propozim për të cilin nuk ka pasur kontestime nga strukturat e policisë. Për të tjerat ka pasur diskutime, por për këtë... Ndjeshmëria në këtë rast është e policisë, për ta pasur këtë instrument sanksioni. Unë nuk e kam këtë ndjeshmëri domosdoshmërisht për ta... Kështu që bashkohem me ju, nëse jeni kundër sanksioneve.

Ermonela Felaj – Jemi kundër këtij lloj sanksioni.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Meqenëse ky lloj sanksioni përsëritet edhe në pikën 3 të nenit 16 të projektit, ku thuhet: “Një vit nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore, shtyrje e afatit të gradimit deri në dy vjet ose mbajtja e pagës”, a mund të lëmë atë që kishim në ligjin aktual, ku thuhet: “I shtyhet afati i gradimit dy vjet ose ulet në gradë.

Sandër Lleshaj – Këtu ka një problem esencial, që ka të bëjë me gradën. Gradat nuk ulen. Gradat janë gjëra të fituara, si diploma e shkollës. Ai që ka bërë master nuk dënohet duke bërë *bachelor*. Pra, për uljen e gradës unë jam kundër në princip. Nuk e gjej gjëkundi në sistemet e karrierës. Kush merr klasën e 7, nuk dënohet duke e çuar në klasën e parë. Mund të ketë dënime të tjera, por grada është e personit, është e fituar dhe nuk është e dhënë. Ne mund të heqim gjerat që japim, por jo gjërat e fituara.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Themi se nuk bashkohet policia me ushtrinë, por ja që ka gjëra ku bashkohen.

U hoq penaliteti i pagës në të gjitha pikat ku është propozuar. Meqenëse u hoq edhe ulja e gradës, germa “b” e pikës 2 e nenit ku propozohet ndryshimi, që është neni 96 i ligjit aktual, mbetet: “1 vit nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore shtyrje e afatit të gradimit deri në dy vjet” dhe e mbyllim këtu.

Vazhdojmë me aktet nënligjore.

Kam vetëm një kujtesë për stafin, por edhe për personin që do të angazhohet për rakordimin e zbardhjes në fund, që referenca për nxjerrjen e akteve nënligjore të shkojë sipas rinumërimit që do të kenë nenet në projektligj.

Atëherë, kush është dakord me nenin 17?

Spartak Braho - Më duket se nuk ka sens që Këshillit të Ministrave i lihet që brenda 30 ditëve të nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e nenit 7 dhe po 3 muaj i lihet ministrit të Brendshëm për nenin 7. Duhet ta nxjerrë ai një herë dhe më pas ta nxjerrë ky. Kështu që duhet ta shtyjme pak afatin e ministrit, se nuk mund të dalin 3 muaj kur ai është i varur nga Këshilli i Ministrave.

Ermonela Felaj - Po, zoti Ministër.

Sandër Lleshaj – Them ta lidhim detyrimin e ministrit me daljen e vendimit të qeverisë dhe të themi “Kaq kohë pas daljes së vendimit të qeverisë”.

Ermonela Felaj – Sa është koha? 3 muaj?

Sandër Lleshaj – Jo, një muaj pas vendimit të qeverisë. Mjafton për ta...

Ermonela Felaj – 30 ditë do të ketë qeveria që të nxjerrë aktin. Një muaj pasi qeveria ka nxjerrë aktin, do të veprojë ministria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Qenka në rregull.

Ermonela Felaj – Do ta lëmë siç e keni propozuar?

(Diskutime pa mikrofon)

Spartak Braho – Pa e miratuar në parim, unë nuk qesh, sepse jam me dy gra....

Ermonela Felaj – Në tërësi.

Spartak Braho – Këto janë vërejtje për efekt të teknikës legislative. Thuhet diku se punonjësi i policisë është personi i emëruar në strukturat e policisë, por duhet thënë “e Policisë së Shtetit”. Në të gjitha rastet duhet të thuhet “e Policisë së Shtetit”, se ne kemi shumë polici.

Kaq kisha.

Ermonela Felaj – E drejtë.

Kush është dakord me nenin 17?

Miratohet siç është propozuar nga ministria.

Përpara se të kalojmë te neni 18, që është hyrja në fuqi, dua t’ia jap fjalën zotit Ndreu për një propozim.

Pjerin Ndreu – Unë mendoj se duhet të gjejmë mekanizmin që të zgjidhim një problem të ndryshimet për ligjin për policinë. Duhet të zgjidhim nenin 49/1. Ne e kemi ngritur një herë këtë çështje. Na u premtua se do ta sillnin si ndryshim, por nuk e sollën.

Ermonela Felaj – Rikthimin në polici.

Pjerin Ndreu – Rikthimi në polici. Se mirë që do të marrim 3-përqindëshin, por kemi një kontingjent, sikur edhe e kemi biseduar, ku përfshihen persona në referomë, që kanë ikur me kërkesën e tyre, kanë fituar gjyqet... Në fakt, është bllokuar rimarrja e këtyre personave, me një nen që është antikushtetues, që e kufizon tjetrin dhe, nëse ti ikën 2 vjet nga Policia e Shtetit, nuk rikthehesh më. Kjo bie ndesh edhe me një nen për vetingun, që thotë: “Pasi komisioni certifikon një oficer policie që nuk është në punë, por është në reformë dhe i nënshtrohet vetingut, drejtoria e përgjithshme ka detyrimin ta emërojë në detyrë”. Pra, ndërsa ia jep detyrimin ligji për vetingun, ia ndalon ligji organik i Policisë së Shtetit. Edhe në logjikën e rekrutimeve, nuk mund të bllokojmë rimarrjen e disa kapaciteteve të policisë, që janë rrugëve. Normalisht, jo të gjithë, pasi i nënshtrohen vetingut... Duhet të heqim kufizimin.

Nëse nuk do ta bëjmë këtu, do të kërkojmë mirëkuptimin tuaj, zoti Ministër, për të bërë një amendament në seancë. Ne si komision e kemi gati amendamentin për ta hequr këtë kufizim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Kjo kërkon të dimë edhe opinionin e ministrit, prandaj e bëme. Le të na thotë ministri... Këtë gjë ne e kemi diskutuar në kohën kur u soll ligji për Policinë e Shtetit, si dhe kur u soll ligji për vetingun në polici.

Propozimi është të hiqet afati dyvjeçar, që...

Si është ligji sot? Në qoftë se një punonjës policie ka qëndruar jashtë strukturave të policisë për më tepër se dy...

(Diskutime pa mikrofon)

Një minutë! Po e lexoj tani. Rikthimi në polici: “Një person mund të rikthehet në polici vetëm nëse ai ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me strukturat e Policisë së Shtetit brenda dy vjetëve të fundit dhe është liruar nga policia për shkurtim të funksionit në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë”. Pra, nëse je shkëputur nga policia për më shumë se dy vjet, nuk rikthehesh, si dhe duhet të jesh larguar edhe për shkurtim, se të dyja këto kushte janë kumulative, nuk janë njëri dhe tjetri. Ajo çfarë po propozon kolegu...

Më falni! Ligji nuk do të ndryshohet çdo ditë. Ne po ndryshojmë sot ligjin për Policinë e Shtetit. Ka një mendim dhe ai do të dijë opinionin e Ministrisë së Brendshme për këtë pikë. A mundemi të bëjmë ndonjë ndryshim këtu? Po ose jo. Gjithsesi, amendamenti do të depozitohet në seancë sipas Rregullores.

Xhemal Qefalia – Kam diçka për procedurë.

Ermonela Felaj – Ka edhe një gjë tjetër, që ti nuk e di dhe ne nuk e kemi diskutuar akoma, që është neni 37. Prandaj nuk e miratova nenin e fundit.

Xhemal Qefalia – Ti na i thuaj ato gjërat, që t’i dimë edhe ne, mos i mbaj për vete.

Ermonela Felaj – Jua kam thënë, por...

Xhemal Qefalia - Të lutem shumë tani, jemi në fund të diskutimit! Mbarojmë draftin që ka sjellë qeveria dhe ministri, kalohet miratimi, meqë e kaluam nen për nen, bëhet kalimi këtu, pastaj qëndrojmë te këto... Në qoftë se duhet amendament, ne si komision kemi rënë dakord që është e nevojshme të bëhet një amendament i tillë për aq kohë sa ligji për vetingun e parashikon këtë.

Çfarë thotë vetingu? Individët që janë larguar nga Policia e Shtetit, për arsye të ndryshme, kanë të drejtë të kalojnë në veting dhe, nëse kalojnë vetingun, të rikthehen në

polici. Këtë ne e bëjmë me draft tjetër. Ne jemi duke diskutuar për këtë, zonja kryetare. Ta mbarojmë një herë këtë dhe pastaj ndalemi tek të tjerat.

Ermonela Felaj – Mirë, Xhemal, por meqenëse të lejuam të flisje se çfarë do të ndodhë me punonjësit e qarkullimit rrugor, që ishte një çështje jashtë ligjit, kjo është një çështje brenda ligjit dhe mund ta marrim opinionin e ministrit, se nuk na pengon asgjë dhe pastaj ta mbyllim.

Sandër Lleshaj – Sigurisht, nuk jam i përgatitur, por do të flas në mënyrë parimore për këtë gjë. Në thelb, fryma e këtij ligji që propozojmë është që policia të hapet, pra të mos jetë një strukturë hermetike. Të hapet për ato prurje që sjellin cilësi dhe plotësojnë nevojat e Policisë së Shtetit. Sigurisht, në qoftë se ju do të gjeni një formulim, i cili mundëson që, kapacitete të munguara, që janë jashtë policisë, mund të futen përmes një procesi të rregullt ligjor e me radhë, unë nuk kam asnjë gjë kundër në parim.

Fryma e përgjithshme e ligjit që ju kam sjellë këtu, është rinovimi, rinimi i Policisë së Shtetit përmes prurjeve të reja nga niveli bazë. Kjo është ajo që unë kam propozuar sot. E thashë, kjo nuk e përjashton në princip nevojën për të plotësuar kapacitete të tjera, edhe me punonjës policie që janë në kushte pajtueshmërie me ligjin dhe me shërbimin në Policinë e Shtetit, por kjo do një zgjidhje tjetër ligjore, që duhet ta bëni ju.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Paraprakisht, jeni pozitiv ndaj këtij ndryshimi. Besoj se kjo mund të na nxisë më shumë që të shikojmë një formulë të duhur se si mund ta ndryshojmë këtë nen.

Ndërkohë, pa shkuar te neni i fundit, kur folëm për ndryshimet te neni 38, që janë kriteret për pranimin në Akademinë e Sigurisë, për pikën 3, ku thuhej” “Për nevoja të policisë pranohen në Akademinë e Sigurisë shtetas që kanë mbaruar ciklin e dytë të studimeve”, thamë që e mira është që këtë pikë ta fusim siç është te neni 37 i ligjit, ku flitet për Akademinë e Sigurisë.

Propozimi im është të futet si pikë 3 e nenit 37 dhe pikat në vijim thjesht të rinumërtohen. Ashtu siç është...

Jeni dakord? Faleminderit!

Kalojmë te miratimi i nenit të fundit, që është hyrja në fuqi.

Kush është dakord me hyrjen në fuqi të ligjit brenda 15 ditëve?

Faleminderit, kolegë!

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Duke besuar që diskutimi i ditës së sotme ka ezauruar në maksimum të gjitha shqetësimet dhe pikëpyetjet, se ka sqaruar opinion publik se për qëllimin e këtyre ndryshimeve, do t'i ftoj kolegët të votojnë pro në tërësi, sipas të gjitha vërejtjeve dhe diskutimeve që u bënë sot.

Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit edhe përfaqësuesve që ju shoqëruan ditën e sotme!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA